



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Miratohet

K R Y E T A R

Arben SHEHU

Raport Auditimi Performance

“ZHVILLIMI I TURIZMIT MALOR”



Yllka PULASHI

DREJTORE E DEPARTAMENTIT

Publik: Ky dokument u gjenerua nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, specifikisht neni 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3 E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti lutemi të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.



RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE KRYER NË MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT, AGJENCINË KOMBËTARE TË TURIZMIT, SI DHE FEDERATËN SHQIPTARE TË ALPINIZMIT DHE TURIZMIT MALOR

"Zhvillimi i Turizmit Malor"

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr.199/4 prot., datë 15.04.2021.

Faza e studimore e auditimit nisi në datë 04.02.2021 me shkresën "Njoftim për fillimin e auditimit" nr.199 prot., dhe nr.199/1 prot., datë 04.02.2021 dhe përfundoi me hartimin e programit të cituar më lart.

Faza e terrenit të auditimit nisi më datë 15.04.2021 dhe përfundoi më 31.05.2021.

Projekt Raporti i Auditimit mori formë përfundimtare dhe me shkresat nr.199/5 dhe nr.199/6 prot., datë 08.07.2021, i'u përcoll subjekteve të audituara.

Në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimit priti observacionet nga subjektet nën auditim. Nga të gjitha subjektet nën auditim, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit u paraqitën observacione me shkresën nr.199/7 prot., datë 12.08.2021, trajtuar në mënyrë të përmbledhur në Kapitullin "Anekse" nr.1.

Nga Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor nuk u paraqitën observacione.

Dosja audituese kaloi në filtrin e Kryeaudituesit dhe Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Performancës, Drejtorisë së Kontrollit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, Drejtorit të Përgjithshëm dhe më pas i'u përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.



PËRMBAJTJA		Faqe
1.	PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT	5
1.1	Konteksti i Problemit Social	5
1.2	Rëndësia e auditimit të performancës	7
2.	SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM	8
2.1	Hyrje në subjektet nën auditim	8
2.2	Politikat e subjektit	13
2.3	Rëndësia e produkteve të subjektit	13
2.4	Pesha në buxhet	13
2.5	Risqet e aktivitetit të subjektit	14
2.6	Feedback-u i subjektit përgjatë gjithë auditimit	17
3.	QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT	18
3.1	Fokusimi dhe përkufizimi i problemit	18
3.2	Objektivi i auditimit	19
3.3	Piramida e pyetjeve audituese	19
3.4	Kriteret	20
3.5	Qasja/metodologjia e auditimit	21
4.	SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE	21
4.1	A kanë rezultuar efektive masat e marra nga institucionet përgjegjëse publike për zhvillimin e turizmit malor, përgjatë periudhës 2019-2020?	22
4.1.1	A ka qenë efektive MTM dhe AKT në mbështetjen ligjore, financiare dhe organizative për zhvillimin e turizmit malor?	23
4.1.1.1	A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?	23
4.1.1.2	A janë realizuar objektivat strategjikë për turizmin malor nga MTM dhe AKT?	26
4.1.1.3	A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM, AKT dhe KRZHT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?	32
4.1.1.4	A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstitucional, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?	56
4.1.2	A ka ndikuar veprimtaria e FSHALT në zhvillimin e turizmit malor?	58
4.1.2.1	A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga Federata Shqiptare e Turizmit dhe Alpinizmit Malor dhe a janë përdorur siç duhet ato?	58
4.1.2.2	A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?	61
5.	PËRMBLEDHJA	63
6.	SHTOJCAT/ANEKSE	74
7.	GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	98



Lista e shkurttimeve

AKT	Agjencia Kombëtare e Turizmit
CLIMATERIC	Turizmi Klimaterik
CONFERENCE	Turizmi i konferencës
CULTURAL	Turizmi Kulturor
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPZHT	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit
DTSHT	Degët Teritoriale të Shërbimit të Turizmit
EUROSAI	European Organization of Supreme Audit Institutions (Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit)
FSHALT	Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
INSTAT	Instituti i Statistikave
INTOSAI	The International Organisation of Supreme Audit Institutions (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit)
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions (Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit)
KKSPT	Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KRZHT	Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit
KSVT	Komisioni i Standartizimit të Veprimtarive Turistike
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
RSH	Republika e Shqipërisë
SAND	Turizmi i Rërës
SEA	Turizmi i Detit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SUN	Turizmi i Diellit
UNWTO	Organizata Botërore e Turizmit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WTTC	Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit
INSTAT	Instituti i Statistikave
PKST	Plani Kombëtar Sektorial
PINS 2030	Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar 2030
SKT 2019-2023	Strategjia Kombëtare e Turizmit 2019-2023
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim United Nations Development Programme

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Shqipëria është një vend i vogël, por me potenciale turistike natyrore dhe një ekonomi në zhvillim, synimet e së cilës orientohen nga modele ekonomike të reja dhe bashkëkohore. Tendenca për të ndjekur këto trende kërkon që në thelb të këtyre iniciativave të evidentohet përfshirja e sektorëve që e bëjnë atë më produktive dhe konkurruese, drejt një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe kapacitete të konsiderueshme financiare dhe njerëzore, burime të cilat, shpesh herë hasin edhe në vështirësi për t'u përmbushur maksimalisht. Një nga këta sektorë është edhe ai i turizmit, i cili ka një rol kryesor në ekonominë shqiptare, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe duke krijuar një mjedis tërheqës për investimet.

Turizmi është një prej industrive me zhvillim më të shpejtë në shekullin e 21-të, për sa i përket kontributit global të PBB-së, të ardhurave nga shkëmbimi valutor dhe krijimit të vendeve të punës, ku mjafton të përmendim disa të dhëna për vitin 2019 në nivel ndërkombëtar, si përsëmbull në PBB, ndikimi direkt dhe indirekt i Turizmit llogaritet rreth 8.9 trilionë dollarë ose 10.3% e PBB-së globale, 330 milion vende pune, ose 1 në 10 vende pune në të gjithë botën, eksportet e turistëve 1.7 trilionë dollarë amerikanë (6.8% e eksporteve totale, 28.3% e eksporteve globale të shërbimeve), si dhe investimet kapitale 948 miliard dollarë amerikanë ose 4.3% e investimeve totale.²

Në Shqipëri gjatë 20 viteve të fundit turizmi Shqiptar ka njohur rritje dhe kjo ka ardhur si rezultat i hapjes së vendit tonë ndaj vendeve të zhvilluara, investimeve, politikave qeveritare. Në sfidat afatmesme dhe afatgjata të ekonomisë, nga qeveritë shqiptare, turizmi është vlerësuar një sektor potencial për të arritur një rritje ekonomike më të lartë, me efekte pozitive në rritjen e punësimit dhe të të ardhurave reale, rritjen e mirëqenies sociale, krijimin e një mjedisi mundësues për sipërmarrje të vogla dhe të mesme, si dhe nxitjen e interesit nga investitorët e huaj.³ Potencialet e këtij sektori qëndrojnë tek gjenerimi i të ardhurave nga një sërë aktivitetesh të tjera të lidhura me të si: transporti, strehimi, ushqimi, shërbimet, sporti, pijet, argëtimet kulturore, konventat, konferencat dhe panairët tregtare. Përveç kësaj, aktivitetet që janë kritike për suksesin e turizmit përfshijnë edhe shërbimet financiare, telekomunikacionin, shërbimet shëndetësore dhe të tjera, të tilla si: energjinë, ujin, sigurinë, rendin dhe ligjin. Të gjitha këto aktivitete të gjera vijnë së bashku në prodhimin e produkteve turistike, si inputi kryesor për zhvillimin e turizmit. Sipas raportit të publikuar nga INSTAT⁴, përgjatë vitit 2018, aktivitetet e lidhura direkt me turizmin gjeneruan rreth 45 miliardë lekë vlerë të shtuar gjatë vitit 2018, duke kontribuar me rreth 2.8 % në PBB, nga të cilat 8.9 miliardë lekë në akomodim, 30.7 miliardë lekë në ushqim dhe pije dhe 5.6 miliardë lekë në agjenci udhëtimi, operator turistik, dhënia me qira e makinave dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit.

Figura nr.1 Vlera në lekë e gjeneruar sipas aktiviteteve të turizmit-viti 2018



Burimi: INSTAT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2019 sipas të dhënave të publikuara nga Këshilli Botëror i Udhëtimeve dhe Turizmit, aktivitetet e lidhura direkt me turizmin gjeneruan rreth 43 miliardë lekë vlerë të shtuar duke

²<https://wtcc.org/Research/Economic-Impact>

³http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/pages_files/Draft_Strategjia_Komb%C3%ABtare_p%C3%ABr_Turizmin_2014-2020.pdf

⁴<https://www.INSTAT.gov.al>

kontribuar me rreth 2,7 % në PBB.

Gjatë vitit 2018 vendin tonë e vizituan rreth 5,9 milion shtetas të huaj, si dhe gjatë vitit 2019 erdhën rreth 6.4 milion shtetas të huaj, ku rreth 50% e tyre, sipas informacionit të siguruar në pikat kufitare janë shprehur se kanë ardhur për pushime. Për vitin 2018 në sektorin e turizmit kanë qenë të punësuar drejtpërdrejt dhe jo drejtpërdrejtë 294 mijë të punësuar ose rreth 7.9% e totalit të të punësuarve, si dhe në vitin 2019 kanë qenë të punësuar rreth 300 mijë ose rreth 8.1% e totalit të të punësuarëve, nga të cilët direkt të punësuar në sektorin e turizmit, për dy vitet 2018 dhe 2019, varion nga 91 – 100 mijë. Nësë vërejmë numrin e turistëve në vendin tonë përgjatë viteve 2018-2019 vihet re se numri i turistëve është rritur, por nga ana tjetër vërejmë edhe një fakt jo shumë pozitiv siç është **sezonaliteti**, evidentuar kjo me numrin e lartë të vizitorëve gjatë tremujorit të tretë të vitit, duke lënë mbrapa muajt Prill-Dhjetor.⁵ Kjo tregon se në vendin tonë, ende produkti turistik që zë peshën kryesore në ofertën në turizëm është ai bregdetar duke lënë **pas turizmin malor**. Në këtë mënyrë lind nevoja e rëndësishme e diversifikimit dhe promovimit të produkteve turistike që ofron vendi ynë, me qëllim që të gjitha llojet e turizmit të zhvillohen njëkohësisht sipas potencialeve dhe pasurive që Shqipëria ofron.

Sipërmarrjet e akomodimit në funksion të turizmit janë rritur gjithashtu në trende konstante ku në vitin 2018, në gjithë vendin funksionuan rreth 1,326 struktura akomoduese (hotele, motele, kampe, bujtina, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afatshkurtra), dhe janë vënë në dispozicion rreth 34 mijë dhoma dhe rreth 79 mijë shtretër, kurse në vitin 2019 funksionuan rreth 1.405 struktura akomoduese dhe janë vënë në dispozicion rreth 38 mijë dhoma dhe rreth 88 mijë shtretër, pra numri i strukturave akomoduese është rritur me 6 %, krahasuar me vitin 2018, numri i dhomave është rritur me 10,2 %, dhe numri i shtretërve është rritur me 11,8 %, krahasuar me vitin 2018, ç'ka tregon se ky sektor ka ardhur në rritje deri në vitin 2019, përjashtuar vitin 2020, për shkak të pandemisë Covid-19, e cila pati efektet e veta në mbarëvajtjen e këtij sektori.


E gjendur në një pozicion të favorshëm në tregun rajonal të Ballkanit, Shqipëria ofron disa lloje produktesh turistike, i cili kategorizohet në 3 grupe, ku secili prej tyre, ndahet nëngrupe dhe gjithsej janë 10 produkte turistike që ofrohen, konkretisht:

-Bregdetar, i cili përfshin turizmin bregdetar dhe turizmin detar (maritime).

-Natyror, i cili përfshin turizmin rural, **malor** dhe ekoturizmin.

-Tematik, ku përfshihen një sërë formash specifike të turizmit, si agroturizmi, turizmi i eventeve dhe biznesit, turizmi kulturor, turizmi eno-gastronomik dhe turizmi shëndetësor.

Figura nr.2 Produktet turistike që ofrohen në Shqipëri



Burimi: Strategjia e Turizmit 2019-2023, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Lidhur me zhvillimin e turizmit malor, natyra Shqiptare është e mbushur me një larmishmëri pejsazesh malore që fillojnë që nga lartësi të vogla dhe deri në lartësi të mëdha, dhe ato zenë një pjesë të konsiderueshme në sipërfaqen e vendit. Por këto zona përveç bukurive natyrore mbartin edhe tradita dhe vlera të trashëguara vit pas viti. Këto elementë e bëjnë turizmin malor më atraktiv,

⁵ www.INSTAT.gov.al



me mundësi të jashtëzakonshme turistike. Në Shqipëri ka shumë zona ku produkti turistik malor mund të zhvillohet dhe mund të jetë i qëndrueshëm përgjatë gjithë vitit, ku po përmendim disa prej tyre, si përsëmbull pika malore e Voskopojës e cila ndodhet në Qarkun e Korcës, Dardha, Alpet Shqiptare në Razëm e Theth, Mali i Tomorrit në Qarkun Berat, Llogaraja në Vlorë, Korabi dhe Radomira në Dibër, Gjinari në Elbasan, etj. Aktualisht në shumë prej këtyre zonave ofrohet thjesht akomodim dhe ushqim, pasi pishinat e mbyllura ato të turizmit të shëndetit, banjat turke, sauna, ambientet sportive, ato të kalimit të kohës së lirë si skitë, bowling, etj., mungojnë, duke e bërë produkt turistik jo të kompletuar dhe jo tepër tërheqës. Megjithatë turizmi shqiptar, pavarësisht zhvillimit dhe shpesh herë duke i'u përgjigjur në mënyrë rastësore kërkesës së tregut, pra duke i'u përshtatur në një farë mënyre këtij tregu, është shoqëruar edhe me një sërë problemesh, të cilat janë ende edhe sot të pa zgjidhura.

Shumë probleme si mungesa e: Kapaciteteve financiare dhe njerëzore, infrastrukturës publike në zonat e thella të vendit, bashkëpunimit ndërinstitucional, pengesat në procesin e kategorizimit dhe të klasifikimit të strukturave akomoduese, mosfunksionimi i plotë të strukturave përgjegjëse për turizmin, mungesa e një databaze të plotë dhe të saktë për turizmin, në gjykimin e grupit të auditimit, kanë patur ndikim negativ në cilësinë dhe zhvillimin e turizmit në tërësi dhe atij malor në veçanti.

Kjo situatë ka vështirësuar edhe krahasimin me vendet fqinje, ku mjafton të përmendim Kosovën, e cila ka mbi dy qendra skish të pajisur me infrastrukturë të plotë, si në hoteleri ashtu dhe në impiante. Problem tjetër që ka shoqëruar këtë sektor përgjatë 10-vjeçarit të fundit është edhe marketingu. Aktivitetet e marketingut të realizuara nga AKT për promovimin e Shqipërisë, si destinacion turistik jashtë vendit, janë planifikuar në mungesën e një strategjie dhe programi të marketingut. Është pikërisht strategjia e marketingut e cila përcakton tregjet kryesore drejt të cilave duhet të fokusohet promovimi dhe evidenton aktivitetet promovuese të duhura dhe të përshtatshme për përdorim, për të arritur këto tregje dhe segmente të përshtatshëm.

Duke vazhduar në vitin 2020, për shkak të pasojave të tërmetit që përfshiu dy qytete të rëndësishme të turizmit (Durrësi dhe Lezha), por edhe të situatës së krijuar për shkak të pandemis Covid-19, që preku gjithë vendin, shoqëruar me kufizimin e lëvizjes së njerëzve dhe kapitaleve, ky sektor u "paralizua" pothuajse plotësisht dhe hyri në krizë ekonomike. Megjithatë, edhe gjatë kësaj krize, Qeveria i kushtoi më tepër rëndësi turizmit bregdetar, ku mjafton vetëm konsultimi i rregullores së sigurisë, hartuar për menaxhimin e pandemisë Covid-19, në të cilën përcaktohen më tepër rregulla për plazhet⁶.

Sa më sipër nëpërmjet këtij auditimi, KLSH do të japë opinionin e saj mbi realizimin e synimeve strategjike, arritjen e objektivave, proceseve dhe mjeteve që duhet të angazhohen për realizimin e tyre.

1.2 RËNDËSIA E AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Auditimi është një pjesë thelbësore e procesit të llogaridhënies për shpenzimin e parave publike, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Nëpërmjet auditimit të performancës bëhet një ekzaminim i pavarur për të kuptuar nëse angazhimet qeveritare, operacionet, programet, aktivitetet apo institucionet e saj janë duke vepruar në përputhje me parimet e economicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim, në aktivitetin e tyre. Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon midis të tjerave veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë publikë, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre ka rezultuar me efektivitet, efijencë dhe economicitet, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës së tyre. Veç këtyre nëpërmjet auditimit, KLSH bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe dhe ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, procedurat, legalizimet, kryerjen në kohë e me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj.⁷

⁶ Urdhër i përbashkët MTM-MSHMS nr.353, datë 29.5.2020 "Për miratimin e "Protokollit të masave Anti-Covid-19 përgjatë sezonit turistik".

⁷ Neni 6 i Ligjit nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".



Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH, bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI 2017-2023. Sipas kësaj Strategjie, KLSH ka për objektiv rritjen e cilësisë së auditimit dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, nëpërmjet audituesve të përgatitur dhe të mirë-trajnuar. Tematika e auditimeve të performancës nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.78, datë 30.06.2020⁸.

Në këtë kuadër u evidentua dhe nevoja e auditimit të efektivitetit të masave të marra për zhvillimin e turizmit malor. Ky sektor është një ndër furnizuesit kryesorë të ekonomisë me të ardhura të shprehur në termat e prurjeve valutore, rritjen e zërit të konsumit, përmirësimin e normave të punësimit si dhe nxitje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, tërësia e të cilave ofron më shumë mirëqenie për popullsinë. Nëse i referohemi turizmit⁹ si koncept ekonomik, mund të ndikojë tek konsumatori në disa drejtime. Fillimisht në kostot e drejtpërdrejta që paguan në këmbim të shërbimit që merr, së dyti në kostot e tërthorta nga shpenzimet e buxhetit të shtetit për këtë sektor, si dhe në mënyrën e ofrimit të këtij shërbimi me sa më shumë cilësi dhe standarde.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin që Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij kushtetues, ka për kompetencë auditimin me qëllim mbrojtjen e interesave publike, rritjen e cilësisë së shërbimit publik të ofruar, pa cenuar kostot financiare të ofrimit të tij, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH, zhvilloi Auditimin e Performancës pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor. Nëpërmjet këtij auditimi, synuam të japim rekomandimet e duhura për zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

2.2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 HYRJE NË SUBJEKTET NËN AUDITIM

Turizmi si prioritet i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, nuk është një aktivitet i vetëm që ndikon në punësim, sipërmarrje dhe rritje të të ardhurave, por zinxhir i disa aktiviteteve që përfshijnë: transportin, ushqimi, shërbimet, sportin, pijet, argëtimet kulturore, konventat, konferencat, panaiet tregtare, etj. Pra turizmi është i organizuar në sektorin publik dhe jopublik dhe në këto kushte duhet që, të gjithë aktorët të japin kontributin e tyre, për zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Në sektorin e turizmit në tërësi dhe nënsektorin e turizmit malor në veçanti, institucionet publike si: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Turizmit, sigurojnë përcaktimin e vizionit, objektiveve, hartimin e strategjive dhe kuadrit rregullator, si dhe zbatimin e tyre, duke krijuar dhe ofruar një turizëm me zhvillim të qëndrueshëm, si dhe që plotëson kërkesat e konsumatorit. Për sa i përket sektorit privat, kryesisht bizneset, por jo vetëm (turistët, komuniteti i zonës), kanë detyrimin që të njihen dhe të zbatojnë kuadrin ligjor përkatës, të bashkëpunojnë me institucionet publike dhe të ofrojnë një shërbim cilësor të turizmit, si dhe të kujdesen për produktin turistik, me qëllim mirëadministrimin e tij.

Për të vlerësuar efektivitetin e masave të marra për zhvillimin e turizmit malor, jo vetëm në hallka të shkëputura, por si sistem të integruar, gjatë fazës studimore dhe të terrenit të auditimit, pjesë e auditimit ishin institucione që lidhen me këtë sektor, për të cilat kemi bërë një përshkrim të organizimit dhe funksionimit të tyre, si më poshtë vijon:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Pranë MTM funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit¹⁰ (1-Drejtori i Përgjithshëm), e cila ndahet në:

1. Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit (1+6 punonjës), e cila përbëhet nga Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit (1+6 punonjës) dhe Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve të Zhvillimit Turistik (3 punonjës);

2. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit (5 punonjës);

⁸ Manuali i Auditimit të Performancës.


⁹ <http://www.tourismeconomics.com/economic-impact/tourism-economic-impact>.

¹⁰ Urdhëri i Kryeministrit nr.165, datë 5.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit".

3. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Turizmit (1+16), e cila ndahet në Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit (12 punonjës për 12 Qarqe), Sektori i Programeve të Zhvillimit të Turizmit 3C (Conference – i Konferencës, Cultural – i Kulturës, Climateric – i Klimës, 2 punonjës) dhe Sektori i Programeve të Zhvillimit të Turizmit, 3S (SEA – i Detit, SAND – i Rërës, SUN – i Diellit, 2 punonjës).

Pra në total, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit (DPZHT), ka 30 punonjës.

Skema 1: Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Turizmit pranë MTM-së



Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së


Referuar kuadrin rregullator përkatës, MTM për pjesën e turizmit, kryen këto funksione, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit janë më të rëndësishme, si më poshtë vijon:

- a) harton dhe paraqet për miratim, pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, Planin Kombëtar të Turizmit dhe përgjigjet për zbatimin e tyre;
- b) harton dhe paraqet për miratim, pranë Këshillit të Ministrave, strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe planin e veprimit;
- c) krijon dhe administron Regjistrin Qendror të Turizmit dhe Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike;
- ç) mbështet dhe bashkëpunon me grupet e interesit në procesin e studimit të tregut, lidhur me burimet dhe produktet turistike, zhvillimin e tyre;
- dh) mbështet financiarisht projektet që ndihmojnë zhvillimin e fushës së turizmit;
- d) mbështet, mbron e zhvillon burimet turistike dhe promovon produktet turistike;
- e) nxit, mbështet e promovon edukimin dhe formimin profesional të vazhdueshëm turistik, nëpërmjet institucioneve dhe programeve të akredituara;
- ë) nxit, mbështet dhe bashkëpunon me institucione publike dhe private në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave në fushën e turizmit;
- f) harton dhe zbaton politikat për sistemet e certifikimit dhe klasifikimit;
- g) bashkëpunon me autoritetet kompetente për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e vizitorëve vendas apo të huaj;
- h) përcakton kriteret për funksionimin e zyrave të informacionit turistik;
- i) bashkërendon punën me institucionet përgjegjëse për pajisjen e infrastrukturës rrugore dhe inxhinierike me sinjalistikën turistike;
- j) luan rol koordinues lidhur me zbatimin e politikave të zhvillimit të produktit turistik dhe menaxhimit të destinacionit;

- Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), është e organizuar në¹¹:
 1. Drejtorinë e Përgjithshme (1 punonjës);
 - 1.1. Drejtorinë e Projekteve dhe Zonat me Prioritet Zhvillimin e Turizmit (6 punonjës), e cila ndahet në Sektorin e Projekteve dhe Sektorin e Qerasë dhe Zonave me Prioritet Zhvillimin e Turizmit;
 - 1.2. Drejtorinë e Marketingut dhe Promocionit (10 punonjës), e cila ndahet në Sektorin e Marketingut dhe Sektorin e Promocionit;
 - 1.3. Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (7 punonjës), e cila ndahet në Sektorin Juridik dhe Prokurimeve dhe Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Pra në total, Agjencia Kombëtare e Turizmit, ka 24 punonjës.

Skema 2. Struktura e AKT



Burimi: AKT, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

Referuar kuadrit rregullator përkatës¹², AKT për pjesën e turizmit, kryen këto funksione kryesore:

- a) Zbaton Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit dhe Strategjinë Kombëtare të Marketingut për sektorin e turizmit.
- b) Zbaton politikat e marketingut në fushën e turizmit, duke promovuar turizmin shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- c) Ofron informacion, si dhe krijon infrastrukturën e nevojshme për dhënien e informacionit për vizitorët, udhëtarët dhe turistët në lidhje me kapacitetin turistik kombëtar, shërbimet turistike që ofrohen, për produktet dhe destinacionet turistike.
- d) Në kuadër të promovimit të modeleve të shërbimeve të turizmit në vend, krijon dhe zhvillon një markë cilësie me qëllim bërjen të njohur të produkteve e të shërbimeve turistike të ofruara.
- e) Bashkëpunon me institucione të tjera për të zhvilluar aktivitetin e saj brenda dhe jashtë vendit.
- f) Ndërmerr dhe nxit projekte për turizmin, sipas fushës së vet të veprimtarisë, duke marrë miratimin paraprak të ministrit.
- g) Promovon, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, produktet turistike dhe destinacionet turistike shqiptare.
- h) Mbledh të ardhurat që realizohen në bazë të marrëveshjeve të qirasë për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit dhe të marrëveshjeve ekzistuese të qirasë të lidhura me subjektet “person i stimuluar”.

- Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor (FSHALT) është person juridik, që krijohet në formën e Shoqatës, e cila perfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave, shoqërive dhe klubeve sportive në Republikën e Shqipërisë. FSHALT vepron në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.79/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”, Ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, Statutit të saj dhe Rregullores së Brendshme. FSHALT është e vetmja organizatë e njohur ligjërisht, për të zhvilluar, administruar dhe organizuar të gjitha llojet e disiplinave që përfshin sporti i Alpinizmit në RSH.

¹¹ Urdhëri i Kryeministrit Nr.175, datë 09.12.2016, i ndryshuar.

¹² VKM nr.298, datë 20.4.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”.



Të ardhurat e Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor, kryesisht sigurohen nga:
-Fondi i buxhetit të shtetit i akorduar në formë "Granti", nga Ministria përgjegjëse për sportin;
-Detyrimet financiare të klubeve dhe shoqatave sportive të cilat janë anëtare të FSHALT;
-Nga sponsorizimet, donacionet dhe dhurimet.

Struktura dhe organizimi i FSHALT janë në përputhje me parimet e Kartës Olimpike dhe Unionit Botëror të Shoqatave Alpinistike (UIAA).

Sa më sipër **organet drejtuese** të FSHALT janë:

1. Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga të gjithë anëtarët e FSHALT;
2. Presidenti, i cili drejton Asamblenë e Përgjithshme dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv;
3. Komiteti Ekzekutiv, i cili përbëhet nga një numër jo më pak se 7 persona.

Organi Administrativ është:

1. Sekretari i Përgjithshëm.

Në total, numri i punonjësve të cilët paguhen nga FSHALT është vetëm 1, si vijon:


1.Sekretari i Përgjithshëm (1);

Referuar kuadrit rregullator përkatës¹³, FSHALT për pjesën e turizmit, kryesisht kryen këto funksione:

- 1.Organizon aktivitete kombëtare si "Ngjitjet Dimërore" "Ngjitjet Verore", "Kacavjerjet Shkëmbore", "Kacavjerjet në Murin Alpin" në formën e Kampionatit Kombëtar;
- 2.Organizon në RSH veprimtari sportive zyrtare ndërkombëtare me miratimin paraprak të ministrit përgjegjës për sportin dhe jep leje për organizimin e tyre nga antarët e saj;
- 3.Zhvillon, promovon, kontrollon dhe rregullon aktivitetin sportiv të shoqatave, shoqërive, klubeve anëtare.

¹³ Statuti i miratuar me Vendimin nr.3108, datë 15.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Skema nr.3 Proçesi i krijimit dhe zhvillimit të produktit turistik malor



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

2.2 POLITIKAT E SUBJEKTIT

Drejtimit kryesore të politikës shtetërore në fushën e turizmit, që bazohen te parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, janë, si më poshtë:

- Njohjen e turizmit si sektor prioritar të ekonomisë;
- Mbështetjen e veprimtarive turistike dhe krijimin e kushteve të favorshme ligjore, ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tyre;
- Përcaktimin e drejtimeve prioritare për zhvillimin e turizmit në Shqipëri;
- Krijimin e imazhit të Republikës së Shqipërisë si destinacion turistik;
- Krijimin e kushteve për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të turistëve e të ofruesve të shërbimeve të turizmit;
- Garantimin e zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit;
- Mbështetjen dhe bashkëpunimin e organizatave/shoqatave të turizmit në mënyrën e përcaktuar nga ligji;
- Zhvillimin dhe mbështetjen e turizmit pritës, pjesë e të cilit është edhe turizmi malor.

2.3 RËNDËSIA E PRODUKTEVE TË SUBJEKTIT

Në Strategjinë për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, theksi vihet në shndërrimin e sektorit të turizmit, në një ndër shtyllat më të forta konkurrese të vendit, në rajon e më gjerë, si dhe “kthimin” e Shqipërisë në një destinacion të vlerës më të mirënjohur, atë të mikpritjes dhe krijimin e destinacioneve të reja turistike gjithëvjetore.

Sa më sipër, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit, të ndara apo të dyja bashkarisht, janë përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e kuadrit rregullator si dhe zbatimin e tij, hartimin dhe miratimin e strategjisë dhe planeve për zhvillimin e turizmit, marketingun dhe promovimin e produktit turistik, zhvillimin e burimeve njerëzore, etj.

Nisur nga sa parashtruar më lartë, në gjykimin e grupit të auditimit, marrja e masave konkrete nga MTM dhe AKT, është kryesore pasi nëpërmjet tyre ofrohen produkte me rëndësi, si më poshtë vijon:

- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit turistik;
- Krijimin e imazhit të favorshëm të Shqipërisë si destinacion turistik;
- Mirëmenaxhimin e burimeve natyrore turistike;
- Rritjen e punësimit në sektorin e turizmit të punonjësve gjithmonë e më të kualifikuar;
- Rritjen e kontributit të turizmit në të ardhurat e përgjithshme të vendit dhe shpërndarjen e barabartë të përfitimeve ekonomike nga turizmi;
- Përmirësimin e kushteve të jetesës në destinacionet turistike, përfshirë të ardhurat, infrastrukturën dhe strukturën sociale, kryesisht në zonat e thella malore;
- Nxitjen e investimeve strategjike private si dhe “tërheqjen” e markave të mirënjohura ndërkombëtare në hoteleri dhe turizëm;
- Përmirësimin e standardeve dhe cilësisë në strukturat akomoduese.

2.4 PËSHA NË BUXHET DHE PBB

Për vitin **2019**, shpenzimet e planifikuara të buxhetit të shtetit (korrente dhe kapitale) ishin në vlerën 308,078,194 mijë lekë¹⁴, nga të cilat:

- **2,732,490 mijë** lekë i janë alokuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ose **0.9%** e totalit të buxhetit të shtetit, për kryerjen e veprimtarisë në tërësi, e cila menaxhon 4 programe buxhetore: Planifikim dhe Menaxhim, Mbrojtja e Mjedisit, Administrimi i Pyjeve dhe **Zhvillimi i Turizmit**;
- **780,500 mijë**¹⁵ lekë janë alokuar për programin buxhetor “Zhvillimi i Turizmit” ose **28.5%** e totalit të buxhetit të MTM, pjesë e të cilit janë institucionet si vijon: Agjencia Kombëtare e

¹⁴ Ligj nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar me aktin normativ nr.11, datë 24.12.2019.

¹⁵ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.



Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit;

- **150,889 mijë lekë**¹⁶ ose **19%** e fondit të programit buxhetor "Zhvillimi i Turizmit", janë alokuar për Agjencinë Kombëtare të Turizmit.
- Pesha e buxhetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në PBB¹⁷, për vitin 2019 është **0.16%**, dhe pesha e programit "Zhvillimi i Turizmit" ndaj PBB është **0.045%**.

Për vitin **2020**, shpenzimet në total të buxhetit të shtetit (korrente dhe kapitale) arritën në vlerën **334,676,938 mijë lekë**¹⁸, nga të cilat:

- **2,558,309 mijë lekë** i janë alokuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ose **0.76%** e totalit të buxhetit të shtetit, e cila menaxhon 4 programe buxhetore: Planifikim dhe Menaxhim, Mbrojtja e Mjedisit, Administrimi i Pyjeve dhe **Zhvillimi i Turizmit**;
- **756,123 mijë lekë**¹⁹ janë alokuar për programin buxhetor "Zhvillimi i Turizmit" ose **29.5%** e totalit të buxhetit të MTM, pjesë e të cilit janë institucionet si vijon: Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit;
- **83,400 mijë lekë**²⁰ ose **11%** e fondit të programit buxhetor "Zhvillimi i Turizmit", janë alokuar për Agjencinë Kombëtare të Turizmit.
- Pesha e buxhetit në total të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në PBB, për vitin 2020 është **0.14%**, dhe pesha e programit të MTM-së "Zhvillimi i Turizmit" ndaj PBB është **0.04%**.

Tabela nr.1 Buxheti për turizmin 2019-2020 (mijë lekë)

Viti	2019				2020			
	Buxheti Total	Në %	Realizimi i Fondit të Turizmit	Në %	Buxheti Total	Në %	Realizimi i Fondit të Turizmit	Në %
Buxheti i MTM	2,732,490	0.9			2,558,309	0.76		
Nga të cilat "Programi i Turizmit"	780,500	28.5	582,948	75	756,123	29.5	645,705	85
Nga të cilat Buxheti i AKT	150,889	19	135,055	90	83,400	11	69,272	83

Burimi: MFE, MTM, AKT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Lidhur me Federatën Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor, Granti i alokuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit²¹ për vitin 2019 është në vlerën **700,000 lekë** dhe për vitin 2020 është në vlerën **700,000 lekë**²², pra në total për periudhën 2019-2020, Federatës i janë alokuar gjithsej 1,400,000 lekë.

2.5 RISQET E AKTIVITETIT TË SUBJEKTIT

Risqet e aktivitetit të subjektit janë ato me të cilat përballet MTM, AKT, FSHALT, për realizimin e përgjegjësive të tyre që krijohen nga aktiviteti në tërësi duke u fokusuar në politikat, programet, proceset dhe strategjitë që ndjekin këto institucione për zhvillimin e turizmit malor.

Spektori i turizmit, si një nga sektorët më tërheqës dhe që sjell të ardhura për buxhetin e shtetit shqiptar, mbart me vete disa problematika, ku më kryesoret janë hartimi dhe zbatimi i politikave, strategjive nga institucionet përgjegjëse për zhvillimin e turizmit. Risqet e aktivitetit të institucioneve u analizuan dhe paraqitur duke i evidentuar dhe klasifikuar sipas analizës SWOT: fuqitë, dobësitë, shanset, kërcënimet, si dhe është bërë kategorizimi i tyre. Gjithashtu është bërë kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional, si dhe klasifikimi brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Tabela nr.2 Analiza SWOT

Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
Hartimi dhe miratimi i strategjisë për zhvillimin e	Mungesa e standardizimit dhe klasifikimit për strukturat

¹⁶ Agjencia Kombëtare e Turizmit, Drejtoria e Financës.

¹⁷ <https://www.financa.gov.al/akti-normativ-nr-11-date-24-12-2019-i-buxhetit-te-vitit-2019/>

¹⁸ Ligj nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar me aktin normativ nr.34, datë 16.12.2020.

¹⁹ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

²⁰ Agjencia Kombëtare e Turizmit, Drejtoria e Financës.

²¹ Neni 8, i Ligjit nr.79/2017 "Për sportin", i ndryshuar.

²² Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor.



turizmit 2019-2023	akomoduese
Alternativa financimi të ndryshme për projektet në fushën e turizmit	Mangësi në plotësimin me burime njerëzore të strukturave si dhe mungesa e burimeve njerëzore me formimin profesional të fushës
Zhvillimi dhe marketimi i ofertave turistike në panairë të ndryshme	Mungesa e trajnimit të të punësuarve në sektorin e turizmit (publik dhe privat)
Plotësimi dhe përditësimi me akte ligjore dhe nënligjore, i kuadrit rregullator të turizmit	Mungesa e një databaze të plotë dhe të saktë me të dhënat e të gjitha burimeve turistike shqiptare dhe të turizmit malor (ende nuk dihet numri i turistëve që shfrytëzojnë destinacionet dimërore që ofron jo vetëm natyra, por edhe biznesi privat në Shqipëri)
Programet e akreditimit të udhërrëfyesit turistik	Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë së turizmit, si dhe zbatimi kuadrit ligjor të tij
Partneritetet me ndërkombëtarët (Këshilli Kombëtar i Turizmit)	Struktura institucionale që nuk funksionojnë plotësisht
Investimet në ngritjen e qendrave të vizitorëve në zonat e mbrojtura	Mangësi në masat e mara për sigurinë e turistit
	Mungesa e regjistrimit kombëtar të turizmit
	Mungesa e qendrave sportive dhe rekreative (pistë për ski, pishina dimërore) në zonat malore
	Mungesa e strategjisë së marketingut të produktit turistik
	Përqendrimi më i lartë i burimeve financiare në financimin e projekteve me focus turizmin bregdetar se sa atë malor
	Mungesa e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm (OJF, Universitete, etj)
	Mungesa e pajisjeve të nevojshme për ngjitjet alpinistike, në Federatën e Alpinizmit
	Mungesa e Udhëzimit të përbashkët (MTM-MFE) për mënyrën e grumbullimit dhe përdorimit të të ardhurave nga marrëveshjet e qerasë
	Mungesa e rregullores së miratuar për pikat e informimit turistik
Shanset (O)	Kërcënimet (T)
Mbështetja financiare nga buxheti i shtetit në disa forma (Buxheti i MTM, Fondi i FZHR)	Sezoni i shkurtër turistik
Pozicioni gjeografik i favorshëm i Shqipërisë	Numri i ulët i strukturave akomoduese
Kushtet klimaterike në Shqipëri	Mungesa e markave të njohura hoteliere
Kombinimi i turizmit malor, bregdetar dhe kulturor	Konkurrenca mjaft e madhe e sidomos me vendet fqinje
Burime të shumta natyrore	Problemet me pronësinë, të cilat shpesh herë kanë penguar investimet e huaja në fushën e turizmit
Ndryshimet ligjore fiskale, ulja e barrës së TVSH	Mungesa e kompanive “Low Cost” për udhëtimet ajrore
Plani Kombëtar Sektorial për Turizmin malor në zonat e Alpeve	Infrastrukturë e dobët në zonat malore, ose infrastruktura e lehtë (soft) për itineraret e biçikletave; itineraret e këmbësorëve për ngjitje, ecje sportive, eksploruese, për hipizëm etj
Futja e linjave (direkte) të reja ajrore për në Shqipëri, duke lehtësuar udhëtimin, si dhe rritjen e numrit të turistëve	Mangësi në masat e mara për sigurinë e turistit
Përmirësimi i aftësive/kapaciteteve njerëzore në industrinë e turizmit	Pandemia Covid-19
	Informaliteti i strukturave akomoduese
	Pamjaftueshmëria e mbështetjes financiare të FSHALT nga buxheti i shtetit
	Vonesa në sigurimin e fondeve (për projektet) në kohën e duhur
	Migrimi

Burimi: MTM, AKT dhe FSHALT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së



Tabela nr.3 Kategorizimi i Riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
MTM			
1	Mungesa e kompanive "Low Cost" për udhëtimet ajrore	Risk Strategjik	I Lartë
2	Mungesa e markave të njohura hoteliere		I Lartë
3	Konkurenca me vendet fqinje		I Lartë
4	Informaliteti i strukturave akomoduese		I Lartë
5	Mungesa e qendrave sportive dhe rekreative në zonat malore		I Lartë
6	Siguria e turistit		I Mesëm
7	Sezoni i shkurtër turistik		I Mesëm
8	Numri i ulët i strukturave akomoduese		I Mesëm
9	Problemet me pronësinë, të cilat shpesh herë kanë penguar investimet e huaja në fushën e turizmit		I Mesëm
10	Mungesa e arkëtimit e të ardhurave nga marrëveshjet ekzistuese të qirasë me personat e stimuluar	Risk Financiar	I Lartë
11	Mungesa e Udhëzimit të përbashkët (MTM-MFE) për mënyrën e grumbullimit dhe përdorimit të të ardhurave nga marrëveshjet e qerasë	Risk Rregullator	I Lartë
12	Mungesa e standardizimit dhe sistemit të klasifikimit për strukturat akomoduese	Risk Operacional	I Lartë
11	Mangësi në plotësimin me burime njerëzore të strukturave si dhe mungesa e burimeve njerëzore me formimin profesional të fushës		I Lartë
13	Struktura institucionale që nuk funksionojnë plotësisht		I Lartë
14	Mungesa e një databaze të plotë dhe të saktë me të dhënat e të gjitha burimeve turistike shqiptare dhe të turizmit malor (ende nuk dihet numri i turistëve që shfrytëzojnë destinacionet dimërore që ofron jo vetëm natyra, por edhe biznesi privat në Shqipëri)		I Lartë
15	Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë së turizmit, si dhe zbatimi kuadrit ligjor të tij		I Mesëm
16	Mungesa e trajnimit të të punësuarve në sektorin e turizmit (publik dhe privat)		I Mesëm
17	Mungesa e regjistrimit kombëtar të turizmit		I Mesëm
AKT			
1	Mungesa e strategjisë së marketingut të produktit turistik	Risk Strategjik	I Lartë
2	Vonesa në sigurimin e fondeve në kohën e duhur	Risk Financiar	I Lartë
3	Mungesa e Udhëzimit të përbashkët (MTM-MFE) për mënyrën e grumbullimit dhe përdorimit të të ardhurave nga marrëveshjet e qerasë	Risk Rregullator	I Lartë
4	Mungesa e rregullores së miratuar për pikat e informimit turistik		I Mesëm
5	Mangësi në plotësimin me burime njerëzore të strukturave si dhe mungesa e burimeve njerëzore me formimin profesional të fushës	Risk Operacional	I Lartë
6	Mbledhja e të ardhurave nga marrëveshjet ekzistuese të qirasë me personat e stimuluar		I Mesëm
7	Mungesa e trajnimit të burimeve njerëzore		I Mesëm
8	Mungesa e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm (Pushteti Vendor, OJF, Universitete, etj)		I Mesëm
FSHALT			
1	Pamjaftueshmëria e mbështetjes financiare të FSHALT nga buxheti i shtetit	Risk Financiar	I Lartë
2	Mungesa e pajisjeve të nevojshme për ngjitjet alpinistike, në Federatën e Alpinizmit	Risk Operacional	I Mesëm
3	Mungesa e kryerjes së aktiviteteve të përbashkëta me MTM, AKT		I Mesëm

Burimi: MTM, AKT dhe FSHALT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Klasifikimi i riskut:

a) *Brenda kontrollit menaxherial:*

- Mungesa e standardizimit dhe klasifikimit për strukturat akomoduese;
- Mangësi në plotësimin me burime njerëzore të strukturave si dhe mungesa e burimeve njerëzore me formimin profesional të fushës;



- Mungesa e trajnimit të të punësuarve në sektorin e turizmit (publik dhe privat);
- Mungesa e një databaze të plotë dhe të saktë me të dhënat e të gjitha burimeve turistike shqiptare dhe të turizmit malor (ende nuk dihet numri i turistëve që shfrytëzojnë destinacionet dimërore që ofron jo vetëm natyra, por edhe biznesi privat në Shqipëri);
- Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë së turizmit, si dhe zbatimi kuadrit ligjor të tij;
- Struktura institucionale që nuk funksionojnë plotësisht;
- Mangësi në masat e mara për sigurinë e turistit;
- Mungesa e regjistrimit kombëtar të turizmit;
- Mungesa e markave të njohura hoteliere;
- Mungesa e strategjisë së marketingut të produktit turistik;
- Përqendrimi më i lartë i burimeve financiare në financimin e projekteve me focus turizmin bregdetar se sa atë malor;
- Mungesa e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm (OJF, Universitete, etj);
- Mungesa e pajisjeve të nevojshme për ngjitjet alpinistike, në Federatën e Alpinizmit;
- Mungesa e hartimit dhe miratimit të disa akteve nënligjore.

b) *Jashtë kontrollit menaxherial:*

- Sezoni i shkurtër turistik;
- Numri i ulët i strukturave akomoduese;
- Mungesa e markave të njohura hoteliere;
- Konkurenca mjaft e madhe e sidomos me vendet fqinje
- Problemet me pronësinë, të cilat shpesh herë kanë penguar investimet e huaja në fushën e turizmit;
- Mungesa e kompanive "Low Cost" për udhëtimet ajrore;
- Infrastruktura e dobët në zonat malore, ose infrastruktura e lehtë (soft) për itineraret e biçikletave; itineraret e këmbësorëve për ngjitje, ecje sportive, eksploruese, për hipizëm etj;
- Mangësi në masat e mara për sigurinë e turistit;
- Pandemia Covid-19;
- Informaliteti i strukturave akomoduese;
- Pamjaftueshmëria e mbështetjes financiare të FSHALT nga buxheti i shtetit;
- Vonesa në sigurimin e fondeve (për projektet) në kohën e duhur;
- Mungesa e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm (OJF, Universitete, etj);
- Mungesa e hartimit dhe miratimit të disa akteve nënligjore;
- Migrimi nga zonat rurale drejt atyre urbane.

2.6 FEEDBACK-U I SUBJEKTIT PËRGJATË GJITHË AUDITIMIT

1. Gjatë fazës studimore subjektet e përfshira në auditim, MTM, AKT dhe FSHALT, i janë përgjigjur në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, si dhe intervistave për kërkesat për dokumentacion. Është plotësuar informacioni i kërkuar, kryesisht me dokumentacionin që lidhet me ligjin dhe aktet nënligjore, strategjitë, strukturën, përshkrimet e punës, buxhetin, raportet e aktivitetit, statistikën, megjithëse këto të fundit të kufizuara në raport me atë që ka kërkuar grupi i auditimit.

-Në fund të fazës studimore arriti në përfundimin se stafet përkatëse **treguan gatishmëri** në vënien në dispozicion të mjeteve të punës dhe informacionit të kërkuar.

2. Gjatë fazës së terrenit, për secilin institucion, bashkëpunimi me grupin e auditit ishte si vijon:

-Grumbullimi dhe vënia në dispozicion të evidencës mbështetëse dhe justifikuese të veprimtarisë së subjekteve nën auditim, sipas kërkesave të grupit auditues, **nuk ka qenë në nivelin e kënaqshëm** nga ana e **MTM**.

Të ndodhur në këto kushte, për t'i paraprirë mundësisë së zvarritjeve në dhënien e informacionit, i'u drejtuam zyrtarisht MTM me pyetjet e intervistës së fazës së terrenit, nëpërmjet shkresës nr. 3002 prot., datë 04.05.2021, ku afati përfundimtar i kthimit të përgjigjes nga ana e Ministrisë ishte



data 12.05.2021. Megjithëse afati i mësipërm nuk u respektua nga MTM, grupi i auditimit, më datë 17.05.2021 i'u drejtua nëpërmjet email-it Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, me qëllim marrjen e masave, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, por përsëri nuk pati feedback nga ky institucion. Si përfundim MTM nuk ktheu zyrtarisht përgjigje për intervistën e grupit të auditimit të KLSH dhe për këtë, **nga grupi auditues u mbajt akt-konstatimi nr.1, datë 19.05.2021.**

-Sa më sipër, komunikimi dhe mbështetja me dokumentacionin e nevojshëm nga MTM për grupin auditues, **ka qënë e mangët dhe jo e plotë.**

AKT i'u përgjigj brenda afateve ligjore gjenerimit të përgjigjeve zyrtare për çështjet e adresuara, së bashku me evidencën e nevojshme.

FSHALT i'u përgjigj brenda afateve ligjore gjenerimit të përgjigjeve zyrtare për çështjet e adresuara, së bashku me evidencën e nevojshme.

Prefektura Vlorë dhe Korçë, si përfaqësuese të **Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit (KRZHT)**, i'u përgjigjën brenda afateve ligjore gjenerimit të përgjigjeve zyrtare për çështjet e adresuara, së bashku me evidencën e nevojshme.

KRZHT Shkodër nuk i'u përgjigj kërkesës së grupit të auditimit.

3. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT

3.2 FOKUSIMI DHE PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Turizmi si prioritet i zhvillimit të qendrueshëm ekonomik dhe shoqëror, nuk është një aktivitet i vetëm që ndikon në punësim, sipërmarrje dhe rritje të të ardhurave reale, por zinxhir i disa aktiviteteve që përfshijnë: transporti, strehimi, ushqimi, shërbimet, sporti, pijet, argëtimet kulturore, konventat, konferencat dhe panairët tregtare. Sigurimi i kushteve të favorshme mbi përmbushjen e këtyre shërbimeve direkte dhe të tjerave të lidhura me ndikimin në turizëm, kanë hasur në vështirësi për një kohë shumë të gjatë, problematikë e cila vazhdon të mbajë sektorin e turizmit larg zhvillimeve efektive dhe potenciale.

Në Shqipëri gjatë 20 viteve të fundit turizmi Shqiptar ka njohur rritje dhe kjo ka ardhur si rezultat i hapjes së vendit tonë ndaj vendeve të zhvilluara, investimeve, politikave qeveritare. Në sfidat afatmesme dhe afatgjata të ekonomisë, nga qeveritë shqiptare, turizmi është vlerësuar një sektor potencial për të arritur një rritje ekonomike më të lartë, me efekte pozitive në rritjen e punësimit dhe të të ardhurave reale, rritjen e mirëqenies sociale, krijimin e një mjedisi mundësues për sipërmarrje të vogla dhe të mesme, si dhe nxitjen e interesit nga investitorët e huaj.²³

Potencialet e këtij sektori qëndrojnë tek gjenerimi i të ardhurave nga një sërë aktiviteteve të tjera të lidhura me të si: transporti, strehimi, ushqimi, shërbimet, sporti, pijet, argëtimet kulturore, konventat, konferencat dhe panairët tregtare. Përveç kësaj, aktivitetet që janë kritike për suksesin e turizmit përfshijnë edhe shërbimet financiare, telekomunikacionin, shërbimet shëndetësore dhe të tjera, të tilla si: energjinë, ujin, sigurinë, rendin dhe ligjin.

Grupi i auditimit përgjatë fazës studimore të auditimit, hodhi hipotezën se ky sektor vuan nga një mungesë efieçense dhe efektiviteti, për shkak të mungesës së kapaciteteve financiare dhe njerëzore, infrastrukturës publike në zonat e thella të vendit, bashkëpunimit ndër-institucional, pengesat në procesin e kategorizimit dhe të klasifikimit të strukturave akomoduese, mosfunksionimi i plotë të strukturave përgjegjëse për turizmin, mungesa e një databaze të plotë dhe të saktë për turizmin, në gjykimin e grupit të auditimit, kanë patur ndikim negativ në cilësinë dhe zhvillimin e turizmit në tërësi dhe atij malor në veçanti. Këtë hipotezë grupi i auditimit e vërtetoi përgjatë fazës së terrenit, ku në përfundim të saj, arriti në mesazhin e auditimit. Gjithashtu grupi i auditimit ka bindjen e arsyeshme se ky sektor ka një mungesë bashkëpunimi dhe komunikimi midis subjekteve në funksion të të cilave është përmirësimi i treguesve të turizmit si dhe historiku të zhvillimit në vite të shërbimit publik për turizmin. Këto mangësi kanë ndikuar në përdorimin pa ekonomicitet të fondeve publike, rritjen e kostove të shërbimit për konsumatorin, në ofrimin e produktit më një

²³http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/pages_files/Draft_Strategjia_Komb%C3%ABtare_p%C3%ABr_Turizmin_2014-2020.pdf



cilësi të ulët, duke e lënë turizmin malor mbrapa krahasuar me vendet e rajonit.

3.2 OBJEKTIVI I AUDITIMIT

Jo vetëm si konsumatorë, por edhe si taksapagues, qytetarët shqiptarë janë të interesuar të marrin shërbimet e duhura në kohë, me cilësi dhe me kosto optimale nga institucionet e administratës publike. Si një shërbim publik dhe privat, zhvillimi i turizmit në tërësi dhe atij malor në veçanti, si dhe ofrimi i këtij produkti me cilësi dhe standarde, ka ndikim në rritjen e mirëqënies ekonomiko-sociale të shtresave të ndryshme të shoqërisë.

Sa më sipër me qëllimin që turizmi malor të ketë ritme të qëndrueshme të zhvillimit dhe që të përmbushi pritshmëritë e konsumatorit, grupi i auditimit përcaktoi si objektiv:

“Auditimin e efektivitetit dhe eficiencës së masave të marra (duke u fokusuar në vlerësimin e kuadrit rregullator, strategjitë, burimeve njerëzore dhe financiare, bashkëpunimin ndërinstitucional) nga institucionet përgjegjëse për zhvillimin e turizmit malor, për periudhën 2019-2020”.

Grupi i auditimit, nëpërmjet analizës së veprimtarisë së këtyre institucioneve, u përpoq, të evidentonte arritjet, prirjet dhe problematikat që kanë ndikuar në zhvillimin e turizmit malor, si dhe arritjen në përfundime dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm.

3.3 PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE

Pyetja e nivelit të parë

1.A kanë rezultuar efektive masat e marra nga institucionet përgjegjëse publike për zhvillimin e turizmit malor, përgjatë periudhës 2019-2020?

Pyetjet e nivelit të dytë:

1.1. A ka qenë efektive MTM dhe AKT në mbështetjen ligjore, financiare dhe organizative për zhvillimin e turizmit malor?

1.2.A ka ndikuar veprimtaria e FSHALT në zhvillimin e turizmit malor?

Pyetjet e nivelit të tretë:

1.1.1.A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?

1.1.2.A janë realizuar objektivat strategjikë për turizmin malor nga MTM dhe AKT?

1.1.3. A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM-së, KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

1.1.4. A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstitucional, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

1.2.1.A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga Federata Shqiptare e Turizmit dhe Alpinizmit Malor dhe a janë përdorur siç duhet ato?

1.2.2.A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?

Piramida e pyetjeve

1.A kanë rezultuar efektive masat e marra nga institucionet përgjegjëse publike për zhvillimin e turizmit malor, përgjatë periudhës 2019-2020?

1.1 A ka qenë efektive MTM dhe AKT në mbështetjen ligjore, financiare dhe organizative për zhvillimin e turizmit malor?

1.2 A ka ndikuar veprimtaria e FSHALT në zhvillimin e turizmit malor?

1.1.1 A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?

1.1.2 A janë realizuar objektivat strategjikë për turizmin malor nga MTM dhe AKT?

1.1.3 A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM, KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

1.1.4 A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstytucional, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

1.2.1.A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga Federata Shqiptare e Turizmit dhe Alpinizmit Malor dhe a janë përdorur sic duhet ato?

1.2.2.A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?

Burimi: Punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

3.4 KRITERET

Tabela nr.4 Kriteret audituese

Pyetja kryesore	Pyetje të nivelit të parë	Pyetjet e nivelit të dytë	Kriteret audituese	Referenca e kriterëve
1.A kanë rezultuar efektive masat e marra nga institucionet përgjegjëse publike për zhvillimin e turizmit malor, përgjatë periudhës 2019-2020?	1.1.A ka qenë efektive MTM dhe AKT në mbështetjen ligjore, financiare dhe organizative për zhvillimin e turizmit malor?	1.1.1.A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?	-Ligji nr.93/2015 “për turizmin”, i ndryshuar; -VKM nr.730, datë 20.10.2016 “për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, e ndryshuar; -VKM nr.413, datë 19.6.2019 “për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2019–2023 dhe të planit të veprimit” -statistikat e turizmit në Kroaci, treguesit që përdoren nga Kroacia dhe burimet e informacionit; HTTPS://WWW.DZS.HR/HRV_ENG/PUBLICATION/2017/SI-1594.PDF ; -Rregullore e Bashkimit Europian nr.692/2011, në lidhje me statistikën evropiane mbi turizmin; -methodological manual for tourism statistics (manuali i BE-së për statistikën në fushën e turizmit).	-neni 75 i Ligjit; -neni 4, pika 4 dhe neni 5, pika 4 në VKM nr.730; -pika 6, fq., nr.17 në VKM nr.413; -treguesit që përdoren në Kroaci për statistikën (turist në hotele dhe restore në zonat malore, netët e qëndrimit të turistit nga vendi prej nga vjen, netët e qëndrimit të turistit sipas llojit të strukturës akomoduese, etj); artikulli 2, 3, 4, 6, 8, aneksi 1 dhe 2
		1.1.2.A janë realizuar objektivat strategjikë për turizmin malor nga MTM dhe AKT?	-Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit (SKT) 2019-2023; -Plani kombëtar sektorial i turizmit (PKST), rajoni i alpeve shqiptare – 2031; -Plani i integruar ndërsektorial për brezin bregdetar – 2031 (PINS); -Strategjia e turizmit në Shtetin e Kroacisë;	-kap., 2.4.2 fq.,15, pika 3.4 fq., 17, kap.,4 fq., 18, pika 4.1 dhe pika 4.2 fq., 20, dhe tabela nr.10 fq., 28 në SKT 2019-2023. -turizmi natyror fq., 20-21; fq.,69-71; fq.,80; 86; 87; 111; 115; 129; 136; kap.4.8 fq., 198; fq.,225; 234; 249; 264 në PKST ALPE. -kap.5.9.4-fq., 185 pi4-fq.,238; pik.6 dhe pi6- fq.,242 në PINS. -kap., 2.1, fq.,8-9 4.3, fq.31 5.2, fq.,43-45 5.3, fq., 53-59 6, fq., 62-65 plani i veprimit masa-8 fq.80 të strategjisë e turizmit në Kroaci;
		1.1.3. A janë plotësisht funksionale	-Ligji nr.93/2015 “për turizmin”, i ndryshuar; -VKM nr.730, datë 20.10.2016 “për miratimin e rregullores	-nenet 1, 4, 5, 8, 9, 10, 11, 14, 18, 20, 23, 25, 26, 28, 30, 31, 53, 60, 66, 67, 68



	strukturat e MTM KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?	<p>për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, e ndryshuar;</p> <p>-VKM nr.325, datë 31.05.2018 “për caktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”;</p> <p>-Urdhër nr.165, datë 09.12.2016 “për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, përshkrimet e punës;</p> <p>-Urdhër nr.8657, datë 28.10.2016 “për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”;</p> <p>-Urdhër nr.101, datë 6.1.2017 “për miratimin e rregullores për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e komisionit të standartizimit të veprimtarive turistike”;</p> <p>-Urdhër nr.267, datë 24.7.2019 “mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar;</p> <p>-Urdhër nr.8707, datë 31.10.2016 “për miratimin e formatit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistik dhe strukturat akomoduese”;</p> <p>-Urdhër i përbashkët MTM-MSHMS nr.353, datë 29.5.2020 “për miratimin e “protokollit të masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik”;</p> <p>-Udhëzim nr.8502, datë 24.10.2016 “për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit”;</p> <p>-Urdhër nr.175, datë 09.12.2016 “për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKT”, përshkrimet e punës;</p> <p>-strategjinë kombëtare të marketingut;</p> <p>-rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit;</p> <p>-masat e marra nga AKT për përfshirjen e shqipërisë në guidat ndërkombëtare të ecjes dhe çiklizmit dhe promovimi i tyre;</p> <p>-masat e marra për promovimin e shtigjeve për këmbësor dhe biçikleta;</p> <p>-studime tregu dhe produkti për turizmin malor;</p> <p>-raportet vjetore të aktivitetit;</p> <p>-programet vjetore;</p> <p>-projekte të financuara me fokus turizmin malor;</p> <p>-rregulloren e miratuar për pikat e informimit turistik.</p> <p>-databasa me të dhëna statistikore për turizmin;</p>	<p>të Ligjit.</p> <p>-VKM nr.298, datë 20.4.2016 “për organizimin dhe funksionimin e AKT”;</p> <p>-nenet 3, 4, 7, 14 të VKM 730.</p> <p>-struktura e DPZHT dhe vendet vakante;</p> <p>-nenet 2-7 të Urdhrit nr.8675.</p> <p>-nenet 3-7 të Urdhrit nr.101.</p> <p>-nenet 1, 2, 3, 4, 6 të Urdhrit nr.267.</p> <p>-anekset I, II, III të Urdhrit nr.8707.</p> <p>-pikat 1.2, 1.3, 3.4 të Udhëzimit nr.8502.</p> <p>-nenet 2, 4, 14, 15, 37 në rregulloren e brendshme të MTM.</p> <p>-nenet 8, 9, 10, 11, 13, 27 të rregullores së brendshme të AKT;</p> <p>-buxheti vjetor i AKT.</p>
	1.1.4.A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstitucional, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?	<p>-Ligji nr.93/2015 “për turizmin”, i ndryshuar;</p> <p>-VKM nr.298, datë 20.4.2016 “për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”;</p>	<p>-neni 7, 9 i Ligjit të turizmit-bashkëpunimet e MTM me institucione të tjera publike/private;</p> <p>-pikat 8.5, 8.7, 8.8 të VKM nr.298 bashkëpunimet e akt me institucione të tjera publike/private;</p>
1.2.A ka ndikuar veprimtaria e FSHALT në zhvillimin e turizmit malor?	<p>1.2.1.A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga FSHALT dhe a janë përdorur siç duhet ato?</p> <p>1.2.2.A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?</p>	<p>granti 2019-2020 i akorduar nga Ministria e Sportit për FSHALT; statuti i FSHALT; raporti i aktivitetit vjetor; rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të FSHALT.</p>	

Burimi: MTM, AKT, FSHALT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

3.5 QASJA/METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Grupi i auditimit për të vlerësuar kryerjen e detyrave funksionale të subjekteve nën auditim, përgatiti intervistat drejtuar Titullarëve të MTM, AKT dhe FSHALT. Gjithashtu u përgatit edhe pyetësorin për operatorët/agjencitë turistike të Qarkut Tiranë, Vlorë, Korçë dhe Shkodër, me qëllim vlerësimin e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, sa i ka shërbyer ky bashkëpunim zhvillimit/promovimit të turizmit malor, si dhe identifikimin e problematikave, me synim dhënien e rekomandimeve për eliminimin dhe përmirësimin e tyre. Për sa më sipër bazuar në dokumentacionin e grumbulluar dhe të analizuar, të dhënat e kërkuara dhe të plotësuara nga subjektet nën auditim, komunikimet me stafin, pasqyrimin në faqet zyrtare të



institucioneve, të këtij aktiviteti, si dhe në praktikat e mira të vendeve të BE-së në këtë fushë, qasja audituese u drejtua nga rezultati dhe do u përdorë qasja pragmatiste, një miks i qasjes sasiore dhe cilësore.

Nëpërmjet qasjes sasiore, u testuan të dhënat e parashikuara me ato të realizuara, si dhe ato të raportuara me ato të kontrolluara dhe monitoruara. Nëpërmjet qasjes cilësore u vlerësua zbatimi i detyrave funksionale nga strukturat përkatëse, duke përdorur intervista gjysëm të strukturuar (pra pyetje të hapura dhe të mbyllura).

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

A kanë rezultuar efektive masat e marra nga institucionet përgjegjëse publike për zhvillimin e turizmit malor, përgjatë periudhës 2019-2020?

Në përfundim të realizimit të programit të auditimit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit mbi veprimtarinë e MTM, AKT dhe FSHALT, u arrit në këtë **mesazh auditimi**²⁴:

Masat e marra nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Turizmit si dhe Federata Shqiptare e Alpinizmit, përgjatë periudhës 2019-2020, për zhvillimin e turizmit malor, **nuk kanë rezultuar mjaftueshëm efektive**, pasi edhe pse nëpërmjet tyre janë siguruar kushtet minimale për zhvillimin e tij, nga ana tjetër ato janë të pamjaftueshme për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor në periudhë afat-gjatë. Institucionet përgjegjëse për turizmin, vuajnë nga një **mungesë efieciencie dhe efektiviteti**, në ushtrimin e detyrave dhe realizimin e objektivave strategjike, me qëllim zhvillimin e turizmit malor në Shqipëri. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit malor, ka nevojë për kuadër rregullator të plotë dhe të zbatueshëm, rritje të nivelit të financimit, strategji marketingu dhe promovimi, menaxhim të destinacioneve të tij, infrastrukturë dhe aktivitete mbështetëse, komunikim dhe bashkëpunim të ngushtë me sektorin publik dhe privat.

1.1. A ka qenë efektive MTM dhe AKT në mbështetjen ligjore, financiare dhe organizative për zhvillimin e turizmit malor?

Për të vlerësuar nëse MTM dhe AKT, përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2020, kanë qenë efektive në mbështetjen ligjore, financiare dhe organizative për zhvillimin e turizmit malor, grupi i auditimit përdori kriteret audituese, të cilat burimin e tyre kishin nga dokumente strategjike, rregullatore dhe operacionale. Këto kriteret, në mënyrë të detajuar i kemi paraqitur më poshtë të strukturuar sipas nënpyetjeve të kësaj pyetje kryesore.

Sa më sipër, nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjektet nën auditim, grupi i auditimit, për efektivitetin e veprimtarisë së MTM dhe AKT-së, arriti në **konkluzionin e përgjithshëm**, se:

“Veprimtaria e MTM dhe AKT-së, përgjatë periudhës nën auditim 2019-2020, nuk ka qenë mjaftueshëm efektive në mbështetjen ligjore, financiare dhe organizative për zhvillimin e turizmit malor”, për shkak të:

- Mosplotësimi në kohë dhe zbatimit të pjesshëm të kuadrit rregullator;
- Funksionimit jo në nivelin e duhur dhe mungesës së krijimit të disa prej strukturave që parashikohen në Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar;
- Mosrealizimit të disa prej objektivave strategjik për zhvillimin dhe promovimin e turizmit malor;
- Bashkëpunimit ndërinstitucional për mbështetjen e veprimtarive sportive që zhvillohen në zonat malore;
- Përgatitjen e planit të masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore dhe krijimin e paketës

²⁴ Shkronja “I” në pikën 10 të nenit 31 në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017, i ndryshuar, të Kryetarit të KLSH-së dhe Manuali i Auditimit të Performancës, miratuar me Vendimin nr.78, datë 30.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.



turistike për aktivitetet dimërore;

-Hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare të Marketingut;

-Administrimin e statistikave të plota dhe të sakta në fushën e turizmit;

-Kategorizimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese;

-Përdorimit pa ekonomikitet të fondeve buhetore;

-Nivelit të ulët të mbështetjes financiare në krahasim me llojet e tjera të turizmit, si ai historiko-kulturor, etj.

1.1.1.A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?

Legjislacioni në industrinë e turizmit, si në të gjithë sektorët e tjerë, është një shtyllë themelore që shërben për të rregulluar dhe monitoruar organizimin dhe operimin e të gjitha fushave që lidhen me aktivitetet e turizmit. Pa legjislacionin e duhur dhe zbatimin e tij, sektori i turizmit nuk mund të organizohet, të funksionojë ose të ketë ndonjë ndikim pozitiv ekonomik për komunitetin. Gjatë viteve industria e turizmit ka rritur kontributin e saj në ekonominë e vendit si në terma monetare ashtu edhe në terma punësimi, duke u bërë kështu një sektor strategjik për Shqipërinë. Për këtë arsye ka patur rritje të fokusit nga qeveria, donatorë, institucione fiskale dhe kompani private në sektor. Që prej vitit 2015 ka një rritje të angazhimit për përgatitjen e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe rregullator i cili është parakusht për çdo investim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Angazhimi për një mbështetje më të fortë për turizmin filloi të materializohej nëpërmjet ligjit sektorial dhe ligjit për investimet strategjike të miratuar në vitin 2015, i cili synonte të sillte sektorin nën fokusin e rrymës së re të investimeve. Gjithashtu, VKM, urdhëra, udhëzime, rregullore, incentiva janë miratuar herë pas here për të plotësuar kuadrin dhe për të adresuar segmente të ndryshme të zinxhirit të turizmit me synim zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Miratimi i Ligjit nr.93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, zëvendësoi Ligjin e mëpaërshëm nr.9734, datë 14.05.2007 duke adresuar çështje dhe problematika të ndryshme. Disa nga këto problematika janë adresuar, ndërsa disa të tjera ende jo (për shembull kategorizimi i apartamenteve/vilave si struktura akomodimi, menaxhimi i destinacionit, akreditimin e programeve të kualifikimit për kapacitetet njerëzore të sektorit të turizmit, sistemi i statistikave, informaliteti²⁵). Megjithatë, ligji solli disa risi krahasuar me ligjin e mëparshëm nr.9734, datë 14.05.2007, për shembull përkufizimet në lidhje me konceptet, procedurat dhe institucionet përgjegjëse për turizmin, rolin dhe funksionet e institucioneve, certifikimi dhe licencimi i subjekteve në fushën e turizmit, kategorizimi dhe klasifikimi i strukturave akomoduese, nxitjen e investimeve për ndërtimin e hoteleve dhe resorteve me 4 dhe 5 yje në zonat më prioritet zhvillimin e turizmit, ulja e TVSH për strukturat akomoduese nga 20% në 6%, përjashtimi nga taksa e ndërtesës për strukturat e akomodimit me 4* dhe 5*etj).

Grupi i auditimit, me qëllim vlerësimin e plotësimit të bazës ligjore me aktet nënligjore, referuar Ligjit nr.93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, praktikave të mira me qëllim përafrimin me acquis-në e BE-së, VKM-ve të cilat parashikojnë hartimin dhe miratimin e urdhërave/udhëzimeve, shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë fazës studimore, faqen zyrtare të institucionit të MTM dhe AKT, ku rezultoi se:

Gjetje:

1) Referuar nenit 11 të Ligjit nr.93/2015 "Për turizmin", rezultoi se, edhe pse kanë kaluar rreth 5 vite nga miratimi i ligjit, Komiteti Këshillimor i Sipërmarrjeve Private Turistike (KKSPT) nuk është në funksion dhe ende nuk ka dalë Urdhri i Ministrit për miratimin e rregullores së funksionimit të saj;

2) Referuar nenit 32, pika 2 të Ligjit nr.93/2015 "Për turizmin", ende nuk është miratuar Urdhri i Ministrit të Turizmit për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjeve të Projekteve në Turizëm;

²⁵ Mbi formalizimin dhe konkurrueshmërinë në sektorin e turizmit-Këshilli Investimeve-Albania Investment Council



- 3) Referuar nenit 4 dhe nenit 9/n të Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”, ende nuk ka dalë urdhri për përcaktimin e kriterëve të funksionimit të zyrave e informuese turistike;
- 4) Referuar nenit 71 të Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”, si dhe nenit 10 pika 2 të Urdhrit nr.267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, në Ligjin e turizmit nuk ka asnjë masë administrative të parashikuar, për strukturat akomoduese, që nuk kanë certifikatën e kategorizimit, ç’ka në gjykimin e grupit të auditimit, mungesa e masës administrative për rastin e mësipër, mund të ndikojë negativisht në informalitetin e strukturave akomoduese në sektorin e turizmit;
- 5) Në Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin” dhe VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, duke marrë në konsideratë praktikën e mira të vendeve të rajonit²⁶, nuk parashikohen në procesin e kategorizimit dhe klasifikimit edhe dhomat/apartamentet/vilat, të cilat ofrojnë akomodim për turistët. Mungesa e parashikimit në kuadrin ligjor, të këtyre ambjenteve, që ofrojnë shërbimin e akomodimit, në gjykimin e grupit të auditimit sjell rritjen e numrit të tyre e për pasojë mund të ndikojë negativisht në informalitetin e sektorit të turizmit;
- “Një fenomen i tillë, është evidentuar si problematikë, edhe në përgjigjet e pyetësorit, që kanë dhënë agjencitë/operatorët turistik”, pasqyruar më hollësisht në Kapitullin “Anekse”;
- 6) Referuar SKT 2019-2023, Objektivi Specifik “Krijimi i kuadrit rregullator dhe institucional për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimi i burimeve njerëzore të angazhuara në sektor”, ende kuadri rregullator nuk është i plotë²⁷, por vetëm është miratuar Udhëzimi i përbashkët nr.517, datë 24.01.2017 “Për akreditimin e programeve të kualifikimit të Udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim”;
- 7) Referuar Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, dhe planit të veprimit, ende nuk janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore, me qëllim realizimin e objektivit strategjik “Mbështetje për zhvillimin e modelit të menaxhimit të destinacioneve”;
- 8) Referuar SKT 2019-2023, si dhe Progres-Raportit për vitin 2020, të BE-së, ku thuhet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave (pasqyrohet si problematikë, transmetimi i tyre në EUROSTAT) në përputhje me acquis-në e BE-së, ende nga MTM nuk është përgatitur sistemi i ri i statistikave në fushën e turizmit, hartimi i metodologjisë në përputhje me Rregulloren e BE-së për statistikën në fushën e turizmit (informacion i besueshëm dhe i krahasueshëm, të dhëna mbi turizmin e brendshëm, burimet e të dhënave dhe mënyrat për sigurimin e informacionit)²⁸;
- 9) Referuar pikës 4 të nenit 5 të VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar, rezulton se, nga Ministri i Turizmit nuk është miratuar Udhëzimi për manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit të strukturave akomoduese;
- 10) Referuar pikës 8.11 të VKM nr.298, datë 20.04.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, ende nuk është hartuar dhe miratuar Udhëzimi i përbashkët (MTM-MFE) për mënyrën e grumbullimit dhe përdorimit të të ardhurave nga marrëveshjet e qerasë, për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit, të lidhura me subjektet “person i stimuluar”, si dhe prej një periudhe më tepër se 10-vjeçare, këto të ardhura nuk janë mbledhur;
- 11) Përcaktimi ligjor i bërë në pikën 3 të Kreut V, të VKM nr.162, datë 2.3.2016 “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”, krijon mbivendosje të detyrave funksionale me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 8.12 të Kreut I të VKM nr.298, datë 20.04.2016 “Për organizimin dhe

²⁶ Ligji i Shtetit të Greqisë për Turizmin nr.4276/2014; Ligji i Turizmit në Shtetin e Malit të Zi-The Law on Tourism and Hospitality (official gazette of Montenegro 2/18, 04/18, 13/18 and 25/19).

²⁷ Udhëzimet e përbashkëta me MASR për akreditimin e kurseve të trajnimit profesional për sektorin e turizmit.

²⁸ Regulation (Eu) no 692/2011 of the European Parliament and of the Council of 6 July 2011 Concerning European Statistics on Tourism - Rregullore e Bashkimit Europian nr.692/2011, në lidhje me Statistikat Evropiane mbi Turizmin;



funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, pasi kompetenca e monitorimit të kontratave për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me subjektin investues, sipas VKM-së nr.162, i jepet MTM-së, ndërkohë sipas VKM-së nr.298, i jepet AKT-së;

12) Ende nga MTM, nuk është miratuar Udhëzimi për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve për turistët, megjithëse ka kaluar rreth 1 vit nga hartimi i tij, kjo në kuadër edhe të objektivave të SKT 2019-2023, mbi ndërtimin e shtigjeve rajonale dhe kombëtare si dhe Ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, në të cilin parashikohet gjenerimi i të ardhurave, nga turistët, që vizitojnë destinacione turistike;

Konkluzione:

1. Mungesa e hartimit dhe miratimit të disa prej akteve nënligjore (urdhëra dhe udhëzime) për funksionimin e strukturave (si Komisioni Këshillimor i Sipërmarrjeve Turistike, Komisioni i përzgjedhjes së projekteve që financohen nga buxheti i MTM-së, Zyrate të informacionit turistik), për zhvillimin e modelit të menaxhimit të destinacionit turistik, për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimin e burimeve njerëzore të angazhuara në sektor e turizmit, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikon negativisht në zbatueshmërinë e kuadrit ligjor, në funksionimin e strukturave përkatëse, në zhvillimin e qëndrueshëm të destinacioneve turistike, e për pasojë në cilësinë e veprimtarisë së MTM-së.

2. Mungesa e përgatitjes dhe vënies në funksion të një sistemi të ri të statistikave në fushën e turizmit, si dhe hartimit dhe miratimit të metodologjisë për grumbullimin dhe përpunimin e tyre, në përputhje me acquis-në e BE-së, sjell vështirësi në matjen e saktë të fluksit të turistëve (kryesisht të turistëve të huaj, por edhe vendas), në vlerësimin e prirjeve dhe preferencave të turistëve, të shpenzimeve të tyre dhe se si këto shpenzime ndikojnë në zonat e vizituara, që në gjykimin e grupit të auditimit, këto mangësi mund të ndikojë negativisht në studimin dhe vlerësimin, e ecurisë së turizmit në nivel të përgjithshëm kombëtar, si dhe përcaktimin e objektivave joreal për zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

3. Mospërfshirja e njërive të shërbimit si, dhomat/apartamentet/vilat, (që ofrojnë shërbimin e akomodimit), e përcaktimit të masës administrative në kuadrin rregullator të turizmit²⁹, për strukturat akomoduese, që nuk disponojnë certifikatën e kategorizimit të tyre, si dhe mungesa e miratimit të Udhëzimit për manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit të strukturave akomoduese, në gjykimin e grupit të auditimit, sjell rritjen e informalitetit, vështirësi për identifikimin dhe regjistrimin e këtyre strukturave akomoduese, vështirësi në grumbullimin e statistikave të sakta për këto struktura, dëmtimin e konkurrencës, e për pasojë ndikon negativisht hartimin e politikave që synojnë përmirësimin e situatës në sektorin e turizmit.

4. Mungesa e hartimit dhe miratimit të Udhëzimit të përbashkët (MTM-MFE) për mënyrën e grumbullimit dhe përdorimit të të ardhurave nga marrëveshjet e qerasë, për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit, të lidhura me subjektet “person i stimuluar”, si dhe mbivendosja e funksionit (midis MTM dhe AKT) të monitorimit të kontratave të lidhura me subjektin investues, për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon moskoordinim të institucioneve të linjës në hartimin e kuadrit rregullator, mungesë bashkëpunimi në nivel horizontal (ndërmjet dy ministrive), si dhe mund të krijojë efekte negative financiare në buxhetin e shtetit, për shkak të krijimit të detyrimeve financiare dhe pamundësisë së grumbullimit të tyre.

5. Mungesa e miratimit të Udhëzimit për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve për turistët, megjithëse ka kaluar rreth 1 vit nga hartimi i tij, kjo në kuadër edhe të objektivave të SKT 2019-2023, mbi ndërtimin e shtigjeve rajonale dhe kombëtare si dhe Ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, në gjykimin e grupit të auditimit, mund të ndikojë negativisht në cilësinë e punimeve për ndërtimin e shtigjeve, në vendosjen e sinjalistikës informuese përgjatë shtegut malor, si dhe

²⁹ Ligji i Turizmit dhe VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”.



vështirësinë e shfrytëzimit të tyre si destinacion turistik.

Rekomandime:

1.MTM të hartojë dhe miratojë aktet nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Këshillimor i Sipërmarrjeve të Turistike, Zyrave të informacionit turistik, Organizatave për menaxhimin e destinacionit turistik, për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimin e burimeve njerëzore të angazhuara në sektorin e turizmit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

2.MTM të hartojë dhe miratojë metodologjinë për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, si dhe të vendosë në funksion sistemin e ri të statistikave, në përputhje me acquis-në e BE-së, por edhe me praktikatat e mira të vendeve të rajonit³⁰.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

3.MTM të bëjë ndryshimet e nevojshme në Ligjin e turizmit, me qëllim përfshirjen e dhomave/apartamenteve/vilave, që ofrojnë shërbimin e akomodimit, në procesin e kategorizimit dhe klasifikimit të tyre, si dhe përcaktimin e masës administrative, për strukturat akomoduese të cilat nuk kanë certifikatën e kategorizimit. Gjithashtu të hartojë dhe miratojë Udhëzimin për manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit të strukturave akomoduese.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

4.MTM në bashkëpunim me MFE dhe AKT, të ngrejë një grup pune të përbashkët, me qëllim vlerësimin vlerës së detyrimit që kanë subjektet "person i stimuluar" për sipërfaqet e marra me qera, si dhe të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e tyre (duke lidhur marrëveshje të pagesës me këste/shërbimit të përbarimit). Pas kësaj, MTM në bashkëpunim me MFE të hartojë dhe miratojë udhëzimin për mënyrën e arkëtimit, me qëllim që mos të krijohen detyrime të prapambetura ndaj buxhetit të shtetit.

-Gjithashtu MTM të rishikojë përcaktimin ligjor të bërë në pikën 3 të Kreut V, të VKM nr.162, datë 2.3.2016³¹ me përcaktimin ligjor në pikën 8.12 të Kreut I të VKM nr.298, datë 20.04.2016³², ku të ndahet qartë (duke shmangur mbivendosjen) kompetenca e monitorimit të kontratave të lidhura me subjektin investues, për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

5.MTM të miratojë Udhëzimin për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve, si destinacione turistike.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

1.1.2.A janë realizuar objektivat strategjike për turizmin malor nga MTM dhe AKT?

Gjatë 20 viteve të fundit, zhvillimi i turizmit nuk i është përgjigjur pritshmërive të konsumatorit përsa i takon përdorimit të potencialeve të vendit dhe, ç'ka është më e rëndësishme, zhvillimit jo të qëndrueshëm të këtij sektori. Ndër vite, shumë probleme janë diskutuar me publikun e gjerë pa i'u dhënë zgjidhja e duhur planifikimit të turizmit, mungesës së kapaciteteve, problemeve lidhur me shërbimet, mungesave në infrastrukturë, mungesës së bashkërendimit mes nivelit qendror dhe pushtetit lokal, investimeve të pabashkërenduara të subjekteve privatë, rolit të munguar të Ministrisë përgjegjëse, etj. Gjithë këto probleme dhe në kushtet e një turizmi të ndërtuar për një kohë të gjatë në mënyrë individuale dhe pa vizion, ku faktikisht ka shumë potenciale ende të pashfrytëzuara, të cilat nëse programohen siç duhet, mund ta kthejnë këtë sektor në një ndër shtyllat më të forta konkuresive të vendit, në rajon e më gjerë. Pikërisht kjo situatë e mbartur vit pas

³⁰Statistikat e turizmit në Kroaci, treguesit që përdoren nga Kroacia dhe burimet e informacionit, https://www.dzs.hr/Hrv_Eng/publication/2017/SI-1594.pdf.

³¹Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit".

³² Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit"



viti, krijoi nevojën e përgatitjes dhe vënies në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023.

SKT 2019-2023, është një dokument, i cili ka ardhur nga identifikimi i avantazheve, disavantazheve, si dhe realizimit të objektivave të përcaktuar në strategjitë e mëparshme për këtë sektor, të cilat, i kemi renditur shkurtimisht, si më poshtë vijon:

1.Strategjia e turizmit 1993-2010

U miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave më 1 janar 1993 dhe u punua nga kompania e konsulencës e kontraktuar me kërkesë të qeverisë shqiptare.

2.Strategjia e turizmit 2002-2012

Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave të datës 3 Korrik 2003, u hartua nga kompania e kontraktuar nga GIZ³³, me kërkesë të qeverisë shqiptare dhe në bashkëpunim me ministrinë që mbulonte sektorin e turizmit.

3.Strategjia sektoriale e turizmit 2007-2013

Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, datë 11 qershor 2008, u hartua nga ministria si bashkim i strategjisë së vitit 2002 me konceptin strategjik për turizmin kulturor të përgatitur nga ekspertet e UNDP.

Disa nga objektivat, e pazbatuar në të tre strategjitë e turizmit më sipër janë:

- zhvillimi i paplanifikuar i ndërtimeve;
- mungesën e kontrollit mbi zhvillimet me mjedisin (ndërtime, mbetje, etj.)
- mungesën e krijimit të strukturave institucionale, menaxhimit të vëzhgimit të tregut, strategjisë së marketingut, burimeve njerëzore, bashkëpunimit sektor publik-privat, administratë qendrore horizontale dhe qendrore-lokale.

4.Nga viti 2013 deri në Qershor të vitit 2019, ky sektor nuk ka patur një strategji për zhvillimin e tij.

5. Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2019 – 2023

Miratuar me VKM nr.413, datë 19.06.2019, hartuar nga Ministria e Turizmit në bashkëpunim me GIZ.


SKT 2019-2023 ofron krijimin e një kornize institucionale me politika, prioritete, instrumente dhe qasje që bëjnë të mundur një sistem menaxhimi për trajtimin e tyre në mënyrë të integruar dhe të organizuar, duke krijuar kështu një parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit.

Gjithashtu, kjo strategji siguron një sistem menaxhimi që bën të mundur që, nën drejtimin e Ministrisë, gjithë aktorët të luajnë rolin e tyre në mënyrë të bashkërenduar dhe sinergjike, duke i përdorur me efektivitet, eficiencën dhe ekonomikitet, burimet për zhvillimin e turizmit. Në skemën e mëposhtme pasqyrohen qëllimet strategjike në katër fusha kryesore, pesë objektiva të politikës dhe 15 objektiva specifik, të cilat synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe shndërrimin e Shqipërisë, në një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik.

³³ Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit-Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar.



Skema nr.5 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 Vizioni



Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër, me qëllim vlerësimin e realizimit të objektivave strategjike nga MTM dhe AKT, shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë fazës studimore dhe të terrenit, faqen zyrtare të institucionit të MTM dhe AKT, ku rezultoi se:



Gjetje:

- 1) Referuar SKT 2019-2023, Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar 2030 (PINS 2030), nga MTM nuk janë identifikuar, shënjuar dhe dixhitalizuar 5 shtigje të reja rajonale dhe 2 shtigje ndërkufitare të ecjes;
- 2) Referuar SKT 2019-2023, nga MTM nuk janë ndërtuar tre shtigjet rajonale dhe dy shtigje kombëtare të çiklizmit;
- 3) Referuar SKT 2019-2023, si dhe Planit Kombëtar Sektorial Alpe 2030, nga MTM nuk ka studim dhe masa të marra për identifikimin, vlerësimin, ndërtimin e pistave të skijimit, me qëllim zhvillimin e këtij sporti, si dhe sporteve të tjera në zonat malore;
- 4) Referuar SKT 2019-2023, ende nuk janë identifikuar vendndodhjet për zhvillimin e alpinizmit, si dhe për realizimin e këtij objekti, nuk është parashikuar asnjë institucion/organizatë publike/private, ku në këtë rast përmendim Federatën Shqiptare të Alpinizmit, e cila mund të ftohej për bashkëpunim;
- 5) Referuar SKT 2019-2023, nga AKT nuk janë marrë masa për përfshirjen e Shqipërisë në guidat ndërkombëtare të ecjes dhe çiklizmit;
- 6) Referuar SKT 2019-2023, ende deri më sot, MTM nuk ka një studim për vlerësimin e kërkesës së tregut mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit (dixhitalizimi i shtigjeve malore) dhe alternativat që mund të adaptohen në turizmin vendas;
- 7) Referuar SKT 2019-2023, MTM nuk ka ofruar mbështetje për veprimtaritë sportive që zhvillohen në natyrë, kryesisht në zonat malore (hedhje me parashutë, çiklizmi malor, ngjitet alpinistike), si dhe aktualisht ajo nuk disponon një inventar të zonave, në të cilat ushtrohet/mund të ushtrohet sporti i hedhjes me parashutë apo çiklizmi malor;
- 8) Referuar SKT 2019-2023 nga AKT në bashkëpunim me MTM, nuk është hartuar dhe miratuar Strategjia Kombëtare e Marketingut për sektorin e turizmit;
- 9) Referuar SKT 2019-2023, nga MTM nuk janë ngritur qendrat e vizitorëve për çdo Park Kombëtar, konkretisht nuk janë ngritur në PK Mali i Tomorrit, Bredhi i Drenovës, Bredhi i Hotovës-Dangëlli, Valbonë, Lurë, Butrint, Zall Gjocaj, si dhe qendrat e vizitorëve në Prespë nuk janë funksionale;
- 10) Referuar SKT 2019-2023 si dhe PKST Alpe, nga MTM në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, nuk është përgatitur plani i masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore;
- 11) Referuar PKST Alpe, MTM nuk disponon informacion për zonat e thella malore, në të cilat nuk arrihet të mbulohet me shërbim të telefonisë celulare/internet, ku theksojmë se nga vizitat në terren në zona të ndryshme të Parkut Kombëtar të Llogarasë, Prespë, në zonën e Bogës, si dhe komunikimit të grupit të auditimit me Specialistët e Zonave të Mbrojtura Vlorë dhe Korçë, mungesa e mbulimit me shërbim të telefonisë celulare/internet, është një nga problemet kryesore, të humbjes së turistëve (kryesisht atyre të huaj) gjatë vizitave turistike në shtigje malore;
- 12) Referuar PKST Alpe, ende nga MTM në bashkëpunim me MFE, nuk është marrë asnjë masë për krijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore, me qëllim rritjen e sezonit turistik, ose e thënë ndryshme shmangien e sezonalitetit;

➤ **Fenomeni i sezonalitetit**, është evidentuar edhe në përgjigjet e pyetësorit, që kanë dhënë agjencitë/operatorët turistik, pasqyruar si më poshtë:

-Operatorëve dhe agjencive turistike, i'u drejtuan pyetjet mbi numrin e turistëve që kanë blerë një paketë turistike nëpërmjet tyre, e ndarë sipas 3 periudhave (Janar-Maj, Qershor-Shtator dhe Tetor-Dhjetor), për të parë ecurinë përgjatë një viti, si dhe sa nga këto paketa kanë qenë për turizmin malor, për të parë edhe peshën që ka ky lloj turizmi në krahasim me turizmin në tërësi.

-Nga përgjigjet e dhëna rezultoi se për periudhën **Janar-Maj** 2019 janë blerë **467** paketa turistike, për periudhën **Qershor-Shtator** 2019 janë blerë **734** paketa turistike, ose **267** paketa turistike **më tepër**, në krahasim me periudhën e mëparshme, si dhe për periudhën **Tetor-Dhjetor** 2019, janë blerë **413** paketa turistike, ose **321** paketa **më pak** në krahasim me periudhën Qershor-Shtator.

-Mbi shfrytëzimin e turizmit malor rezultoi se, për periudhën **Janar-Maj** nga **467** paketa turistike, vetëm **46** prej tyre ose **10%**, kanë qënë për turizmin malor, për periudhën **Qershor-Shtator** nga **734** paketa turistike, **149** prej tyre ose **20%** kanë qënë për turizmin malor, si dhe për periudhën **Tetor-Dhjetor** nga **413** paketa, vetëm **86** prej tyre ose **21%** kanë qënë për turizmin malor, pra në total nga **1614** paketa turistike, vetëm **281** prej tyre ose **17%** kanë qënë për **turizmin malor**.


Pasqyra nr.1 Paketat turistike përgjatë vitit 2019, sipas 3 periudhave

Periudha	Pyetja	Paketa turistike të përgjithshme	Pyetja	Paketa turistike për zonat malore
Janar – Maj 2019	Sa ka qënë numri i turistëve që kanë blerë një paketë turistike nga zyra juaj?	467	Sa prej tyre kanë blerë paketa turistike për zonat malore?	46
Qershor – Shtator 2019		734		149
Tetor – Dhjetor 2019		413		86
Total		1614		281

Burimi: Pyetësori drejtuar agjencive dhe operatorëve turistik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

➤ Kjo situatë, për sa i përket sezonalitetit në sektorin e turizmit është ilustruar edhe grafikisht, ku vihet re se, **në periudhën Qershor-Shtator 2019**, pra që përkon edhe me sezonin turistik veror, **ka një numër më të lartë** paketash turistike të blera, në krahasim me dy periudhat e tjera.

Grafiku nr.1 Ecuria e turizmit në 3 periudha të ndryshme gjatë vitit 2019



Burimi: Pyetësori me operatorët dhe agjencitë turistike, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

13) Referuar PKST Alpe, ende nga MTM nuk është marrë masë, për të ngritur platformën online të bashkëpunimit, për shoqëruesit/udhërrëfyesit e udhëtimeve, me qëllim koordinimin, bashkëpunimin, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar, gjatë shoqërimeve të grupeve të turistëve;

14) Edhe pse kanë kaluar rreth 2 vite nga miratimi i SKT 2019-2023, ende nga MTM, nuk është përgatitur programi i trajnimit dhe nuk është marrë asnjë masë për trajnimin e burimeve njerëzore që janë të angazhuara në sektorin e turizmit, megjithëse në planin e veprimit është parashikuar periudha 2019-2020, për realizimin e tij;

-“Një fenomen i tillë, është evidentuar si problematikë, edhe në përgjigjet e pyetësorit, që kanë dhënë agjencitë/operatorët turistik”, pasqyruar më hollësisht në Kapitullin “Anekse”;

15) Referuar SKT 2019-2023, nga MTM, nuk është krijuar struktura menaxhuese për zbatimin e Planit Kombëtar Sektorial Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare;

16) Referuar SKT 2019-2023, nga MTM dhe AKT ende nuk është ngritur portali shqiptar i turizmit “e-turizëm”, i lidhur me aplikacione që ofrojnë informacion mbi destinacionet e atraksionet turistike, megjithëse për realizimin e tij, është parashikuar viti 2020;

17) Referuar SKT 2019-2023, nga MTM dhe AKT, nuk janë marrë masa për përmirësimin e zyrave/pikave të informacionit turistik, si dhe nuk është hartuar dhe miratuar rregullorja për pikat e informacionit turistik, por theksojmë se AKT ka vënë në dispozicion të 27 Bashkive, 60 infopoint (tabela informacioni për destinacione turistike). Gjithashtu nga 60 tabelat informuese, të cilat janë



bërë kalim kapital nga AKT drejt Bashkive, 21 prej tyre ose 35%, janë të dëmtuara/kanë humbur, pra nuk i shërbejnë qëllimit të tyre;

18) Edhe pse kanë kaluar 2 vite nga miratimi i SKT 2019-2023, nga MTM dhe AKT, ende nuk janë ngritur strukturat promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë;

19) Referuar SKT 2019-2023, Objektivi Specifik "Regjistrimi i 80% të strukturave akomoduese të vogla familjare", si dhe Progres-Raportit për vitin 2019 dhe 2020, të BE-së, në kapitullin 20, ku ende informaliteti, pasqyrohet si problematikë në sektorin e turizmit, nga MTM nuk ka një analizë/studim se sa është numri i strukturave akomoduese, që nuk janë të regjistruara/që operojnë në mënyrë informale, megjithëse është parashikuar viti 2019 për kryerjen e studimit; Gjithashtu nga MTM nuk është përgatitur asnjë plan/program veprimi, për realizimin e këtij objektivi, me qëllim përcaktimin e masave konkrete, afateve, institucionet me të cilat do të bashkëpunojë, etj.

Konkluzione:

1. Mungesa e studimeve dhe marrjes së masave nga MTM dhe AKT, për identifikimin dhe/ose ndërtimin, shënjinin, dixhitalizimin e shtigjeve malore të ecjes dhe të çiklizmit dhe përfshirjen e tyre në guidat ndërkombëtare, për identifikimin, ndërtimin e pistave të skijimit dhe zonave për zhvillimin e alpinizmit, për krijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore, si dhe sigurimin e mbulimit me shërbim të telefonisë celulare/internet të zonave të thella malore (ku zhvillohet turizmi malor), në gjykimin e grupit të auditimit, tregon pamjaftueshmëri të aktivitetit institucional, në mbështetjen dhe zhvillimin e burimeve turistike malore, si dhe mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm të këtij lloji turizmi.

2. Mungesa e ngritjes së qendrave të vizitorëve në çdo Park Kombëtar, kryesisht në zonat malore si Mali i Tomorrit, Bredhi i Drenovës, Valbonë, etj, e ngritjes së zyrave/pikave të informacionit turistik, dëmtimit/humbjes së rreth 21 infopointeve (tabela informacioni për destinacione turistike) në disa Bashki, si dhe mungesa e ngritjes së portalit shqiptar të turizmit "e-turizëm", për ofrimin e informacionit mbi destinacionet e atraksionet turistike dhe krijimit të strukturës menaxhuese për zbatimin e Planit Kombëtar Sektorial Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon pamjaftueshmëri në realizimin e objektivave strategjik, sjell mungesë informacioni për destinacionet turistike, si dhe mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e turizmit malor në këto zona.

3. Mungesa e përgatitjes së planit të masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore, e realizimit të objektivit strategjik, për regjistrimin e 80% të strukturave akomoduese të vogla familjare (kryesisht në zonat malore), duke ndikuar negativisht në uljen e informalitetit në sektorin e turizmit, si dhe mungesa e një programi pune me qëllim përcaktimin e masave konkrete, afateve, institucionet me të cilat do të bashkëpunojë MTM, për reduktimin e fenomenit të informalitetit, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikon negativisht në cilësinë e shërbimit të ofruar, cenimin e sigurisë së turistit, uljen e numrit të turistëve në zonat malore, e për rrjedhojë zhvillimin me ritme të ulta të turizmit malor.

4. Mungesa e përgatitjes së programit dhe trajnimit të burimeve njerëzore, që janë të angazhuara në sektorin e turizmit, si dhe mungesa e ngritjes së platformës për komunikimin online midis udhërrëfyesve turistik, në gjykimin e grupit të auditimit, sjell moskoordinimin dhe mosbashkëpunimin ndërmjet këtyre aktorëve (turist-ofrues të shërbimit), burime njerëzore jo të kualifikuara, si dhe ndikon negativisht në cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj turistit.

5. Mungesa e hartimit dhe miratimit të Strategjisë Kombëtare të Marketingut, si dhe ngritjes të strukturave promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë, në gjykimin e grupit të auditimit, sjell hartimin e politikave jo të duhura për zhvillimin dhe promovimin e produkteve turistike në tërësi dhe atyre malore në veçanti, kryerjen e aktiviteteve promovuese mbi eksperiencën të mëparshme dhe jo mbi kërkesat reale të tregut, si dhe ndikon negativisht në marketingun e turizmit shqiptar.



Rekomandime:

1.MTM të marrë masat e nevojshme, për identifikimin, shënjimin dhe dixhitalizimin e 7 shtigjeve malore të ecjes dhe 4 shtigje të çiklizimit, si dhe përfshirjen e tyre në guidat ndërkombëtare të ecjes.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

2.MTM të bëjë një studim, me qëllim vlerësimin e mundësive dhe më pas ndërtimin e pistave të skijimit dhe të zonave të zhvillimit të alpinizmit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

3.MTM, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të sporteve malore, dhe rrjedhimisht tërheqjen e turistëve në këto zona, të ftojë çdo vit Federatën e Alpinizmit, Aeronautikës, dhe të sporteve të tjera që zhvillohen në zonat malore, me qëllim aplikimin në projektet që financohen prej saj, të cilat fokusohen në turizmin malor.

Në vijimësi

4.MTM në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postarem dhe palë të tjera interesit, të bëjë një vlerësim të mbulimit me shërbim të telefonisë celulare/internet, të zonave të thella malore, si dhe të marrë masat e nevojshme, rast pas rasti, që në ato zona, të cilat nuk mbulohen me shërbim të telefonisë celulare/internet, ky problem të eliminohet.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

5.MTM të marrë masat e nevojshme për ngritjen e qendrave të vizitorëve në çdo Park Kombëtar, ngritjen e zyrave të informacionit turistik, ngritjen e strukturës menaxhuese të PKST Alpe, si dhe në bashkëpunim me AKT dhe Bashkitë, të zëvendësojë/riparojë infopoint-et e dëmtuara. Gjithashtu në bashkëpunim me AKT, të marrë masat e nevojshme për ngritjen dhe vënien në funksion të portalit shqiptar të turizmit "e-turizëm", për ofrimin e informacionit mbi destinacionet e atraksionet turistike.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

6.MTM në bashkëpunim me MSHMS, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e planit të masave për sigurinë e turistëve në zonat malore, duke krijuar Skuadrat e Kërkim-Shpëtimit, si dhe përgatitjen e rregullore së ndërhyrjes në mënyrë që çdo pjesëtar i këtyre skuadrave të jetë i qartë për funksionin që do të kryejë, duke shmangur kështu kaosin dhe duke shkurtuar kohën e dhënies së ndihmës të aksidentuarit. Gjithashtu të vlerësohet mundësia, që këto skuadra të kenë edhe mjekë të urgjencës, të cilët të trajnohen për ndërhyrjen në terren dhe mjekimin e të aksidentuarit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

7.MTM në bashkëpunim me MFE, të përgatisë një program pune, me qëllim realizimin e objektivit strategjik "Regjistrimin e 80% të strukturave akomoduese të vogla familjare", duke ndërmarrë masa konkrete, fushatë të koordinuar midis DPT-së dhe MTM-së, përcaktuar afate, si dhe burimet njerëzore dhe financiare që do të angazhohen.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

8.MTM në bashkëpunim MFE, Ministrinë e Arsimit, dhe palët e tjera të interesit, të përgatisë programin e trajnimit të burimeve njerëzore, që janë të angazhuara në sektorin e turizmit. Këto trajnime të ofrohen në dy periudha të vitit para dhe pas sezonit turistik, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Në vijimësi

9.MTM të marrë masat e nevojshme për ngritjen e platformës online të bashkëpunimit, për udhërrëfyesit turistik, me qëllim koordinimin, bashkëpunimin, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar prej tyre, gjatë shoqërimeve të grupeve të turistëve.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022



10. MTM në bashkëpunim me AKT të hartojë dhe miratojë Strategjinë Kombëtare të Marketingut, si dhe ngritjen e strukturave promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2022

1.1.3. A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM, AKT dhe KRZHT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

Siç e kemi cituar më sipër, pranë MTM-së, funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit (**1 punonjës**), e cila ndahet në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit, (**DKFPT-7 punonjës**), Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit (**DPSZHT-5 punonjës**), si dhe Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Turizmit (**DPZHT-17 punonjës**). Pra siç shihet, nga numri i punonjësve, peshën kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Turizmit, e ka Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Turizmit, ku nga 30 punonjës gjithësej, kjo Drejtori ka 17 punonjës, ose **57%**. Pikërisht kjo Drejtori, përfshin disa struktura të cilat janë me rëndësi (për nga funksionet që kryejnë) si: Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit (12 punonjës për 12 Qarqe), që ndër të tjera kanë rolin e koordinatorit të punës (institucionet e nivelit qendror me ato vendore) në terren për zbatimin e politikave të zhvillimit të produktit turistik dhe të menaxhimit të destinacionit turistik, si dhe bashkëpunimin me pushtetin vendor, sipërmarrjet turistike; Sektori i Programeve të Zhvillimit të Turizmit 3C (Conference, Cultural, Climateric, 2 punonjës) dhe Sektori i Programeve të Zhvillimit të Turizmit, 3S (SEA SAND, SUN, 2 punonjës), nga të cilët Sektori i të Zhvillimit të Turizmit 3C (Conference, Cultural, Climateric), ka rolin kryesor në funksion të planifikimit, zhvillimit të produktit turistik dhe programeve të zhvillimit të turizmit kulturor-historik, **malor** dhe bregdetar.

Sa më sipër grupi i auditimit, referuar dokumentacionit paraprak të vënë në dispozicion (përshkrimeve të punës, formimin profesional të punonjësve) bëri një vlerësim të burimeve njerëzore të angazhuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Turizmit, e cila për periudhën 2019-2020, nuk ka pasur ndryshime në rritje apo pakësim të numrit të punonjësve³⁴, ku rezultoi se:

Gjetje:

1) Për rreth 2 vite, disa prej pozicioneve më kryesore, si ai i Drejtorit të Përgjithshëm të Turizmit, Drejtorit të Drejtorisë së Projekteve, Përgjegjësit të sektorit të projekteve për marketimin e turizmit, Kryetarit të Degës Territoriale, janë vakante, gjithësej 5 pozicione pune, ose 17% e strukturës, për plotësimin e të cilave, MTM nuk ka marrë asnjë masë;

2) Përshkrimet për pozicionet e punës (konkretisht për arsimin e kërkuar) në Drejtorinë e Përgjithshme të Turizmit, nuk janë sipas përcaktimeve ligjore të bëra në Udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike nr.01, datë 31.05.2017 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil", pra kërkesat e arsimit për pozicionet e punës, si dhe në gjykimin e grupit auditues, nuk janë në përputhje me funksionet dhe natyrën e punës që kryhet në këto pozicione (për shëmbull në pozicionin e Drejtorit të Programeve të Zhvillimit të Turizmit, mund të punësohet një person, i cili është i diplomuar për shkenca sociale, në pozicionin e Drejtorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit, mund të punësohet një person, i cili është i diplomuar edhe për shkenca inxhinierike, po kështu edhe për pozicionin e specialistit në këtë drejtori, ose për të njëjtin pozicion pune (Kryetar i Degës Territoriale) ka përshkrime të ndryshme, ku njëher kërkohet master shkencor në shkenca ekonomike/shoqërore dhe në një rast tjetër master shkencor në shkenca ekonomike/shoqërore/juridike/komunikimi). Kjo mospërputhje e funksionit që kryhet me llojin e arsimit, rezulton në:

- **Pozicionin e Drejtorit të Programeve të Zhvillimit të Turizmit;**

- **Pozicionin e specialistit në këtë drejtori;**

- **Pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit;**

³⁴ Urdhëri i Kryeministrit nr.165, datë 5.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit".



- **Pozicionin e specialistit në këtë drejtori;**
- **Pozicionin e Kryetarit të Degës Territoriale të Turizmit.**

Sa më sipër në gjykimin e grupit të auditimit, rezulton se 11 punonjës (efektiv) ose 44%, kanë llojin e arsimit (Administrim Biznesi, Administrim Publik, Shkenca Politike, Qeverisja dhe Politikat Publike, Marrëdhënie Ndërkombëtare), që mund të përputhet me llojin e funksioneve që kryejnë në pozicionet, që janë punësuar, si dhe 14 prej tyre nuk e kanë llojin e arsimit.

3) Sa i përket trajnimeve, për periudhën 2019-2020, rezulton një numër i ulët ditësh trajnimi, por edhe punonjësish, ku për dy vite janë trajnuar vetëm 5 punonjës (vetëm të një prej tre drejtorive) ose 20 % e strukturës (efektive), si dhe janë kryer 14 ditë trajnime gjithsej, ose 7 ditë trajnim në vit.

4) Referuar nenit 30 të Ligjit nr.93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit", ende nuk janë përgatitur planet e zhvillimit dhe të veprimit për të gjitha zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, ku nga këto zona citojmë: Mali i Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshatë-Krastë; Vargmali i Moravës; Alpet; dhe Parku Kombëtar i Llogarasë, të cilat i kemi përfshirë në vizitat në terren;

5) Referuar SKT 2019-2023, nga MTM ende nuk është ngritur grupi tematik, i cili ka si detyrë monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit;

6) Referuar nenit 4 të Ligjit të Turizmit, edhe pse kanë kaluar 5 vite nga miratimi i ligjit, ende nuk është publikuar dhe as nuk është finalizuar regjistri qendror i turizmit, i cili duhet të listojë në mënyrë të konsoliduar veprimtaritë në fushën e turizmit. Theksojmë se ky regjistër popullohet me të dhënat, të cilat i referohen vetëm sipërmarrësve të regjistruar në QKB, por jo edhe bizneset (bujtina, apartamente dhe vila tw vogla), të cilat faktikisht ofrojnë shërbime akomodimi gjatë gjithë vitit ose përgjatë gjithë sezonit turistik;

7) Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, ende nuk është hartuar dhe miratuar Plani Kombëtar i Turizmit;

8) Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, MTM nuk ka një bazë të dhënash të ankesave të konsumatorëve ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike;

9) Referuar nenit 18 dhe 45 të Ligjit të Turizmit, si dhe VKM nr.730, datë 20.20.2016, rezulton se: -Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk e ka bërë ende kategorizimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese megjithëse nga MTM, është shtytur 3 herë afati për aplikimin për kategorizim (hotel, bujtinë, motel, hostel, resort), dhe nga MTM në bashkëpunim me Inspektoratin që mbulon fushën e turizmit, nuk është marrë asnjë masë për ndëshkimin e tyre;

-Gjithashtu rezulton se vetëm 10 hotele janë klasifikuar me yje, ndërkohë që sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, janë rreth 1,400 struktura akomoduese, të cilat ende nuk janë klasifikuar;

-Portali elektronik për të lehtësuar këtë regjistrim dhe klasifikim nuk është ende aktiv;

10) Referuar nenit 53 dhe nenit 66 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8707, datë 31.10.2016 "Për miratimin e formatit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe strukturat akomoduese", rezulton se përgjatë periudhës 2019-2020, agjencitë, operatorët dhe strukturat akomoduese nuk kanë raportuar çdo muaj statistikën e turizmit, pranë MTM-së, dhe nga kjo e fundit nuk është marrë asnjë masë³⁵, për moszbatimin e ligjit nga subjektet private;

11) Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit, nenit 7 të Ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", si dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit", rezulton se, Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit nuk funksionojnë sipas referencave ligjore të bëra më sipër, pra ato nuk janë të pozicionuara pranë Qarqeve, në mënyrë që të shërbejnë si ndërmjetës të bashkëpunimit dhe koordinimit, midis MTM dhe institucioneve të pushtetit vendor dhe subjekteve private, për zhvillimin e turizmit;

³⁵ Neni 71, pika 1, shkronja d, në Ligjin nr.93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar.



12) Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”, rezulton se nga kjo strukturë:

- Nuk janë kryer këshillime, të sipërmarrjeve turistike, me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, përgjatë periudhës 2019-2020;
- Nuk ka databasë për ankesat ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike, si dhe për burimet turistike, sipas formatit të përcaktuar në aneksin nr.1 dhe aneksin nr.2/a/b/c/d të Urdhrit;
- Nuk janë organizuar seminare, konferenca, takime të Degëve Territoriale me sipërmarrjet turistike, për periudhën 2019-2020;

Mangësitë mbi funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit, janë evidentuar edhe në përgjigjet e pyetësorit, që kanë dhënë agjencitë/operatorët turistik, pasqyruar më hollësisht në Kapitullin “Anekse”;

Financimi i Turizmit Malor në MTM

Nga informacioni paraprak i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nga MTM, rezulton se përgjatë periudhës 2019-2020, janë financuar faktikisht në masën 50%, gjithësej 16 projekte ose 56,685,135 lekë, nga të cilat 7 për vitin 2019 në vlerën 26,752,925 lekë dhe 9 për vitin 2020 në vlerën 29,932,210 lekë.

Tabela nr.6 Projektet e financuara nga MTM për periudhën 2019-2020

Nr	Titulli i projektit 2019	Plan	Fakt	Në % ndaj totalit
1	Një udhëtim me Edward Lear në Shqipëri	5,000,000	5,000,000	19%
2	Promovimi Kulturës dhe Traditës Shqiptare	4,500,000	4,500,000	17%
3	Festivali Traditës	6,328,000	6,328,000	24%
4	Shtegu i biçikletave dhe këmbësorëve Theth-Valbonë	6,999,751	2,099,925	8%
5	Promovimi agroturizmit	4,700,000	4,700,000	18%
6	Albania the Beautiful	3,125,000	3,125,000	12%
7	Promovimi Turizmit Deti Adriatik dhe Jon	1,000,000	1,000,000	4%
Total		31,652,751	26,752,925	
Nr	Titulli i projektit 2020	Plan	Fakt	Në % ndaj totalit
1	Albania the Beautiful	3,000,000	3,000,000	10%
2	Shqiptarët e mrekullueshëm II	1,000,000	1,000,000	3%
3	Kultura, Mjeshhtëria dhe Turizmi një Partneritet Vital	4,050,000	4,030,000	13%
4	Tirana 100	3,200,000	3,197,210	10%
5	Krijimi i një data baze për hotelerinë në Shqipëri	3,900,000	3,900,000	13%
6	Modele për zhvillimin e aktiviteteve të turizmit detar	4,000,000	4,000,000	13%
7	Evidentimi dhe promovimi i shtigjeve të hiking në Shqipëri	3,300,000	3,300,000	11%
8	Promovimi Zonave të Mbrojtura ³⁶	4,250,000	4,250,000	14%
9	Reklamimi i kalave dhe njohja e audiencës me historinë e tyre	3,300,000	3,255,000	11%
Total		30,000,000	29,932,210	

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga 7 projekte të financuara për vitin 2019, në gjykimin e grupit të auditimit, si dhe përshkrimin e projektit, **vetëm 1 prej tyre** ka qenë i fokusuar në turizmin malor, për të cilin nga MTM janë financuar **2,099,925 lekë ose 8%** e fondit gjithësej për projektet e vitit 2019. Për vitin 2020, nga 9 projekte të financuara, në gjykimin e grupit të auditimit, **vetëm 2 prej tyre**, kanë qenë të fokusuar në turizmin malor ose të natyrës, për të cilat nga MTM janë financuar **9,649,925 lekë, ose 25%** e fondit gjithësej për projektet e vitit 2020. Në mënyrë të përmbledhur, rezulton se për periudhën 2019-2020, janë financuar **3 projekte në vlerën 9,649,925 lekë, ose 17% e fondeve**.

Për të vlerësuar prioritetin e dhënë llojit të turizmit (natyror dhe malor, histori-kulturë, det), nëpërmjet financimit të projekteve, grupi i auditimit, bëri një ndarje në 4 grupe të projekteve të mësipërme:

- Kulturë dhe Histori – 6 projekte në vlerën 22,310,210 lekë ose 39%;
- Natyror dhe Malor – 3 projekte në vlerën 9,649,925 lekë ose 17%;
- Detar – 2 projekte në vlerën 5,000,000 lekë ose 9%;

³⁶ Fondi total i shpenzuar për këtë projekt “Promovimi i zonave të mbrojtura” është në vlerën **4,250,000 lekë** për 12 zona të mbrojtura, ose **354,167 lekë për një zonë të mbrojtur**. Nga 12 zona të parashikuara, në gjykimin e grupit të auditimit, relievit dhe pozicionit gjeografik, 6 prej tyre i përkasin turizmit malor, pra **2,12,5000 lekë** të shpenzuara për këto zona.



- Të tjera – 5 projekte në vlerën 19,725,000 lekë ose 35%.
- Pra siç shihet, peshën kryesore e kanë projektet e financuara në turizmin kulturor dhe historik, duke vijuar në atë natyror dhe malor, më pas në turizmin detar.
- Në tabelën më poshtë kemi pasqyruar koston totale (1,829,840 mijë lekë) të financimit të realizimit të objektivave specifik, përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, koston e objektivit politik “**Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike**” (219,450 mijë lekë), i cili ndahet në **3 objektiva specifik**:
 - **I.Zhvillimi i Programit të Turizmit Bregdetar e Detar** – 20,700 mijë lekë;
 - **II.Zhvillimi i Programit të Turizmit Tematik** – 43,050 mijë lekë;
 - **III.Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror** – 155,700 mijë lekë, i cili ndahet në turizmin malor dhe natyror, ku për **turizmin malor janë planifikuar 9 produkte** në vlerën **42,300 mijë lekë**.

Tabela nr.7 Kosto financiare e SKT 2019-2023, si dhe e 3 programeve të turizmit

		Kosto (000 lekë)	
SKT 2019-2023		1,829,840	<i>Në % ndaj totalit të SKT</i>
Objektivi Politik (1)	Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike 3 Programe Zhvillimi (I + II + III)	219,450	12%
<i>I cili ndahet në</i>		<i>Në % ndaj totalit të 3 programeve</i>	
Objektivat Specifik (3)	I.Zhvillimi i Programit të Turizmit Bregdetar e Detar (3 produkte)	20,700	9%
			<i>Në % ndaj totalit të 3 programeve</i>
	II.Zhvillimi i Programit të Turizmit Tematik (13 produkte)	43,050	20%
			<i>Në % ndaj totalit të 3 programeve</i>
	III.Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror (12 produkte)	155,700	71%
<i>dhe për turizmin malor, pjesë e turizmit natyror (8 produkte)</i>	Ndërtimi i tre shtigjeve rajonale dhe dy shtigjeve kombëtare të ciklizmit	6,000	<i>Në % ndaj Programit Natyror</i>
	Identifikimi dhe zhvillimi i katër vendndodhjeve për zhvillimin e alpinizmit	2,000	27%
	Identifikimi, shënjimi, dixhitalizimi i pesë shtigjeve të reja rajonale dhe dy shtigjeve ndërkufitare të ecjes	7,000	
	Studim për identifikimin e vendndodhjeve për zhvillimin e skive dhe sporteve të tjera dimërore	10,000	<i>Në % ndaj 3 Programeve</i>
	Krijimi i strukturës menaxhuese dhe zbatimi i PKST Alpe	8,000	
	Aktivitete për promovimin e turizmit të aventurës	1,000	
	Plan masash për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore në bashkëpunim me ministrinë e shëndetësisë	300	19%
	Qendra moderne të vizitorëve me funksion informues, orientues dhe edukues në parqet kombëtare	8,000	
			<i>Në % ndaj Strategjisë</i>
	Total Turizmi Malor	42,300	2%

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se, pesha që zë objektivi i politikës (**pra ai i konsolidimit dhe zhvillimit të produkteve turistike**) ndaj 5 objektivave politik, është **219,450 mijë lekë** ose **12%**.

Peshën kryesore në koston totale të SKT 2019-2023, e ka:

- Objektivi “**Promovimi i Potencialeve Turistike**”, në vlerën **704,200 mijë lekë** ose 38%;
- Për të vijuar me objektivin “**Përmirësimi i Shërbimeve Turistike**” në vlerën **545,060 mijë lekë** ose 30%;
- Objektivi “**Nxitje e Investimeve Publike dhe Private**” në vlerën **252,490 mijë lekë** ose 14%;
- Objektivi i fundit “**Mbështetje për Menaxhimin e Destinacioneve**” në vlerën **108,640 mijë lekë** ose 6%.

▪ Nëse do t’i referoheshim tabelës së mësipërme, **mbi peshën** që zë kosto e financimit të **turizmit malor** ndaj **totalit të koston së financimit të SKT 2019-2023**, rezulton një vlerë tepër e ulët, **2% e totalit**.

▪ Pra sa më sipër, grupi i auditimit krijon bindjen e arsyeshme, se MTM, i ka kushtuar më tepër rëndësi “**Promovimit të turizmit**”, pavarsisht se ai ka dekada që bëhet si brenda dhe jashtë vendit, si dhe tashmë Shqipëria njihet nga shumë turistë të huaj (Maqedonia e Veriut-12%, Greqia - 9%, Italia - 8% , Mali i Zi - 6% , Mbretëria e Bashkuar - 3%, Pjesa tjetër nga vënde të ndryshme të



Botës - 62%³⁷) dhe më pas “**Përmirësimi të shërbimeve turistike**”. Ndërkohë, sipas gjykimit të grupit të auditimit, peshën kryesore duhet ta kishte objektivi, “**Përmirësimi i Shërbimeve Turistike**”, i cili në thelb ka zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore të angazhuara në sektorin e turizmit, dhe më pas “**Konsolidimi dhe Zhvillimi i Produkteve Turistike**”, dhe në këtë mënyrë shfrytëzohen potencialet natyrore të vendit, krijohen produkte turistike autentike dhe gjithëvjeto, ulet sezonaliteti, duke e kthyer Shqipërinë në destinacion mikpritës dhe tërheqës.

Agjencia Kombëtare e Turizmit

Agjencia Kombëtare e Turizmit është institucioni kryesor, që ka si detyrë promovimin e turizmit shqiptar brenda dhe jashtë vendit, kryesisht nëpërmjet:

-ofrimit të informacionit për produktet dhe destinacionet turistike, për veprimtari e të dhëna të tjera në lidhje me vlera të natyrës, historisë dhe trashëgimisë së kombit shqiptar apo me veprimtari shoqërore e kulturore;

-Zhvillimit të aktiviteteve të lidhura me turizmin apo të çdo aktiviteti tjetër kulturor a me karakter historik ose sportiv, analizave, studimeve, prezanti-meve, statistikave;

-Hartimit të materialeve me karakter promocional, informues apo statistikor, dhe prodhimin apo botimin e tyre;

-Bashkëpunimit me zyrat rajonale të turizmit, komitetet rajonale për zhvillimin e turizmit, pushtetin vendor, operatorët dhe agjencitë turistike, si dhe organizma të tjerë që operojnë në fushën e turizmit, përfaqësitë diplomatike shqiptare jashtë vendit, me përfaqësitë diplomatike të huaja brenda vendit apo me organizata të ndryshme vendase dhe të huaja apo edhe konsulentë.

Pra kryerja e këtyre detyrave dhe realizimi i objektivave institucional, ka si qëllim krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar.

-Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AKT për vitin 2019 (buxheti, panairët, aktivitetet me media/gazetar të huaj që vijnë për të vizituar Shqipërinë, duke u fokusuar tek turizmi), rezulton se buxheti i AKT-së, është alokuar dhe realizuar si vijon:

Tabela nr.8 Buxheti i AKT 2019

Nr	Emertimi	Plani vjetor	Fakti	Pesha në % ndaj totalit	% e realizimit
1	Pagat	15,600,000	15,200,440	10%	97%
2	Sigurimet	3,200,000	2,587,990	2%	81%
3	Shpenzime operative	90,000,000	75,297,303	60%	84%
4	Investime 230	42,000,000	41,880,000	28%	99.7%
5	Investime 231	89,467	89,467	0.1%	100%
	Totali	150,889,467	135,055,200		89.5%

Burimi: AKT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Siç shihet nga tabela e mësipërme, peshën kryesore të buxhetit të AKT për vitin 2019, e zënë shpenzimet operative (60 % e totalit), më pas investimet në llogarinë ekonomike (230), e cila përfaqëson kryerjen e studimit për përgatitjen e “Strategjisë së brandit dhe të marketingut të turizmit shqiptar”, si dhe analitikisht shpenzimet operative për qëllime të vitit 2019, pasqyrohen si vijon:

³⁷ Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit, të dhënat për origjinën e turistëve që kanë vizituar Shqipërinë në vitin 2019.



Tabela nr.9 Shpenzimet operative të AKT 2019

Klasifikimi nga grupi i auditimit	Nr	Emertimi i shpenzimeve	Plan	Fakt	Pesha ndaj totalit	Realizimi
I. Të përgjithshme	1	Kancelari	250,000	235,165		
	2	Furnizime me material te tjera zyre dhe të përgjithshme	300,000	263,840		
	3	Shpenzime per prodhim dokumenta specifik	60,000	47,800		
	4	Materiale Pastrimi	60,000	-		
	5	Energji elektrike	200,000	185,159		
	6	Sherbime telefoni	50,000	10,165		
	7	Sherbime uje	70,000	58,050		
	8	Sherbime postare	180,000	168,400		
	9	Sherbime bankare	200,000	202,645		
	10	Karburant dhe lubrifikant	600,000	564,570		
	11	Pjese kembimi	200,000	151,680		
	12	Siguracione taksa	50,000	48,779		
	13	Taksa vendore	130,000	129,095		
	14	Udhetim e dieta brenda vendit	200,000	192,320		
	15	Udhetim e dieta jashte vendit	5,300,000	5,117,491		
	16	Bileta avioni	3,000,000	2,761,390		
	17	Te tjera (Vulat e projekteve)		11,000		
			10,850,000	10,147,549	12%	94%
II. Botime dhe Promocion	1	Ndertimi i faqes zyrtare web (www.akt.gov.al)	500,000	427,199		
	2	Mirembajtja e faqes ëeb albania.al	500,000	479,999		
	3	Materiale Promocionale	16,000,000	-		
	4	Fushate e integruar e marketingut per promovimin e turizmit shqiptar nepermjet optimizimit	10,000,000	9,360,000		
	5	Monitorimi i Mediave te Shkruara dhe Vizive (pagese e vitit 2015)		140,460		
			27,000,000	10,407,658	30%	39%
III. Aktivitete të ndryshme (udhëtime familjarizuese-FAM TRIP dhe udhëtime me gazetar, media - PRESS TRIP), me media/gazetar të huaj	1	Transport me qera FAM dhe PRESS TRIP	970,000	968,904		
	2	Delegacioni francez per kongresin "Les Entreproses du Voyage 2020"	180,000	178,496		
	3	Press trip me media finlandeze	450,000	447,881		
	4	Fam trip me media Turke pjesemarrës ne panairin e tiranës 2019	800,000	789,380		
	5	Kala fest 2019	600,000	553,366		
	6	Press -trip me gazetare franceze (akomodim)	60,000	51,970		
	7	Press trip me media Sllovaqe "Fijet Sllovaqe"	150,000	192,642		
	8	Press trip me gazetare hollandeze	40,000	34,835		
	9	Fam trip me tour operatore gjerman	50,000	49,669		
	10	Hapje sezoni turistik dhe festa e tradites per qytete te ndryshme	700,000	-		
			4,000,000	3,267,143	4%	82%
IV. Panairot	1	MATKA (FINLANDE)16-20 JANAR	2,250,000	2,245,943		
	2	(FITUR) SPANJE 23-27 JANAR	1,400,000	1,341,864		
	3	(MILANO) 10-12 SHKURT	3,000,000	2,945,153		
	4	(IZRAEL) 12-13 SHKURT	1,100,000	1,083,600		
	5	(BERLIN) 6-10 MARS	13,200,000	13,144,009		
	6	MITT (MOSKE) 12-14 MARS	3,800,000	3,736,431		
	7	UITT(KIEV) 27-29 MARS	1,500,000	1,485,743		
	8	NDERKOMBETAR I TIRANËS 6-7 PRILL	3,500,000	3,452,880		
	9	ITB (AZIA) 15-17MAJ	2,050,000	2,011,362		
	10	ËTM LONDER 5-7NENTOR	14,800,000	14,943,430		
	11	TT VARSHAVE 22-24 NENTOR	1,600,000	1,577,110		
	12	TRAVEL FAIR PRISHTINA 16-17PRILL	-	-		
	13	ITB (PEKIN)15-17 MAJ	-	-		
	14	IFTM (PARIS)1-4 TETOR	-	-		
	15	TTG RIMINI 9-11 TETOR	-	-		
			48,200,000	47,967,525	54%	100%
			90,050,000	75,297,303		84%

Burimi: AKT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga tabela e mësipërme rezultojn se, **peshën kryesore** të shpenzimeve operative të planifikuara e zënë **panairot (54%)**, më pas shpenzime për botime dhe promocion (30%), të përgjithshme (12%) dhe aktivitete të ndryshme me media, gazetar të huaj, që në thelb, kanë si qëllim promovimin (4%). Nga grupet e mësipërme, të klasifikuara nga grupi auditues, rezultojn se performancën më të mirë të realizimit të fondeve e kanë panairot (100%), shpenzimet e përgjithshme (94%), aktivitetet e ndryshme me media, gazetar të huaj (82%), si dhe botimet dhe promocion (30%).

-Rezultojn se % më të ulët të realizimit e ka grupi i shpenzimeve për botimet dhe promocion, për arsye se fondi i planifikuar për hartimin, prodhimin dhe botimin e materialeve me karakter promocional, informues apo statistikor, nuk është ekzekutuar për këtë vit, **çka do të thotë se një nga funksionet e rëndësishme të AKT³⁸, përgjatë vitit 2019 nuk është realizuar.**

-Për vitin 2020, rezultojn se buxheti i AKT-së, është alokuar dhe realizuar si vijon:

Tabela nr.10 Buxheti i AKT 2020

Nr	Emertimi	Plani vjetor	Fakti	Pesha në % ndaj totalit	% e realizimit
1	Pagat	26,000,000	15,974,725	31%	61%
2	Sigurimet	4,400,000	2,536,715	5%	58%
3	Shpenzime operative	53,000,000	50,760,625	64%	96%
	Totali	83,400,000	69,272,065		83.1%

³⁸ VKM nr.298, datë 20.04.2016



Burimi: AKT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Pra siç shihet nga tabela e mësipërme, peshën kryesore të buxhetit të AKT për vitin 2020, e zënë shpenzimet operative (64 % e totalit), si dhe analitikisht shpenzimet operative për qëllime të vitit 2020, pasqyrohen si vijon:

Tabela nr.11 Shpenzimet operative të AKT 2020

Klasifikimi nga grupi i auditimit	Nr	Emertimi i shpenzimeve	Plan	Fakt	Pesha ndaj totalit	Realizimi
I. Të përgjithshme	1	Kancelari	120,000	118,120		
	2	Furnizime me material te tjera zyre dhe të përgjithshme	120,000	110,640		
	3	Shpenzime per prodhim dokumenta specifik	120,000	72,900		
	4	Mirëmbajtje materiale zyre dhe të përgjithshme	120,000	119,100		
	5	Materiale Pastrimi	120,000	11532		
	6	Energji elektrike	240,000	191,374		
	7	Sherbime uje	97,186	32,915		
	8	Sherbime postare	192,000	15,850		
	9	Shërbime bankare	240,000	48,362		
	10	Karburant dhe lubrifikant	650,400	650,000		
	11	Pjese kembimi	111,130	111,130		
	12	Shpenzime të tjera transporti	94,245	94,245		
	13	Siguracione taksa	18,250	18,250		
	14	Taksa vendore	513,000	330,365		
	15	Udhetim e dieta brenda vendit	200,000	137,500		
	16	Udhetim e dieta jashte vendit	2,280,417	2,280,417		
	17	Bileta avioni	1,176,959	739,590		
	18	Shërbime të abonimit, printimit, publikimit	120,000	117,600		
	19	Shpenzime gjyqësore	4,370,304	4,370,304		
	20	Materiale për dezinfektim	120,000	61,870		
	21	Mirëmbajtje objekti	120,000	120,000		
	22	Të tjera	138,000	49,464		
			11,281,891	9,801,528	20%	87%
II. Botime dhe Promocion	1	Mirembajtja e faqes web albania.al	322,027	240,000		
	2	Materiale Promocionale	13,424,627	13,412,040		
	3	Fushatë promovuese	18,025,560	18,025,560		
			31,772,214	31,677,600	56%	100%
III. Aktivitete të ndryshme me media/gazetar të huaj	2	Kongresi me Francezët	168,168	168,168		
			168,168	168,168	0.3%	100%
IV. Panaiet	1	Hollandë 15-19 Janar	1,794,447	1,794,447		
	2	Spanjë 22-26 Janar	3,243,126	3,243,126		
	3	Milano 9-11 SHKURT	3,003,741	2,993,717		
	4	Izrael 11-12 SHKURT	3,444,085	3,444,085		
	5	Vienë 19 Janar	1,799,367	1,768,911		
			13,284,766	13,244,286	24%	100%
		TOTALI: I + II + III + IV	56,507,039	5,4159,530 (zbritur kthimi valutës 732,052)		

Burimi: AKT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga tabela e mësipërme rezulton se, peshën kryesore të shpenzimeve operative të planifikuara e zënë botimet dhe promocionet (56%), më pas shpenzime për panaiet (24%), të përgjithshme (20%) dhe aktivitete të ndryshme me media, gazetar të huaj, që në thelb, kanë si qëllim promovimin (0.3%).

Nga grupet e mësipërme, të klasifikuara nga grupi auditues, rezulton se performancën më të mirë të realizimit të fondeve e kanë panaiet (100%) dhe botimet e materialeve informuese (100%). **Këtë vit rezulton se nga AKT, është ekzekutuar fondi buxhetor për hartimin, prodhimin dhe botimin e materialeve me karakter promociional, informues apo statistikor.**

-Në krahasim me vitin 2019, buxheti i vitit 2020 është reduktuar me rreth 40%, pra rreth ½, për arsye se nga Pandemia Covid-19, disa prej panaiereve si dhe aktivitete të ndryshme (udhëtime familjarizuese), që kanë si qëllim promovimin, u anuluan.



-Sa më sipër, duke u bazuar në të dhënat financiare si dhe numrin e aktiviteteve, grupi i auditimit shyrtoi në mënyrë rastësore disa nga praktikatat e panairëve 2019-2020, me qëllim vlerësimin e procedurës së ndjekur, identifikimin e mangësirave që mund të ndikojnë negativisht në mbarëvajtjen e kësaj procedure, si dhe vlerësimin e mundësive, nëse mund të kursehen fondet buxhetore, në këtë veprimtari publike, por pa cenuar cilësinë e tij. Me qëllim pasqyrimin e plotë dhe kuptimin e këtij aktiviteti, grupi i auditimit ka bërë një përshkrim, të hapave, në të cilat kalon procedura e panairit.

Mbi procedurën e pjesëmarrjes në panairët ndërkombëtare, me qëllim promovimin e turizmit:

- Në muajin Korrik të vitit buxhetor, Titullari i AKT, me shkresë përcjellëse, dërgon pranë MTM, listën e panairëve për vitin pasardhës, në të cilat synon të marrë pjesë, shoqëruar me një arsyetim të thjeshtë, për secilin panair; Në këto panairë, AKT merrë me qera një sipërfaqe të caktuar, ku vendoset stenda, karriget, tavolinat, si dhe materialet e tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e panairit; Në këto panairë, AKT shoqërohet edhe nga subjektet private që operojnë në fushën e turizmit, operatorë/agjenci turistike;
- Ministri përgjegjës për turizmin, në periudhën Tetor-Nëntor të vitit buxhetor, shpreh miratimin e tij për pjesëmarrjen e AKT në panairët e vitit pasardhës;
- Më pas për çdo panair, Titullari i AKT, me shkresë përcjellëse dërgon pranë MTM, listën me emrat e punonjësve të saj, të cilët do të përfaqësojnë institucionin në panairët përkatëse (2-4 persona);
- Për këtë listë, Ministri i MTM shpreh miratimin e tij;
- AKT nëpërmjet AKSHI-t, në portalin e-albania, publikon panairin/et që do të zhvillohen, ku ftohen agjencitë/operatorët turistik, që të aplikojnë për të marrë pjesë (brenda një afati prej 5 ditësh nga dita e publikimit); Gjithashtu publikohet edhe lista me kriteret fituese, si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzojë aplikanti, të cilat janë:

a) Kriteret

- Të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të ketë të specifikuar në fushën e veprimtarisë që ofron shërbime turistike;
- Të vetëdeklarojë që ushtron veprimtari turistike;
- Të vërtetojë nëpërmjet mjeteve të marketingut që përdor (ëeb faqe, rrjete sociale, broshura, fletëpalosje), në shqip dhe anglisht prodhimin e paketave turistike, që synojnë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, (turizmi kulturor, turizmi natyror, turizmi shëndetësor etj), si edhe të dorëzojë kopje të materialeve promovionale të mësipërme;
- Të ketë të paktën 2 punonjës në listëpagesa;
- Të ketë shlyer detyrimet tatimore deri në periudhën e aplikimit;
- Të ngarkojë logo të kompanisë në format vektorial;
- Të vërtetojë nga Dega e Tatim-Taksave xhiron e realizuar gjatë 3 viteve të fundit.

b) Dokumentet:

- Certifikatë dhe licencë si operator turistik;
- Vërtetim për pagim detyrimesh;
- Kopje të materialeve promovionale të prodhuara nga Operatori Turistik;
- Ekstrakt historik i Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- Listëpagesat e 6 muajve të fundit të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, shoqëruar me Formularin E-SIG 025/a;
- Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë 3 viteve të fundit;
- Logo të kompanisë në format vektorial.

Më pas, Titullari i AKT me urdhër të brendshëm ngre një grup pune, i cili ka si detyrë:



-Hartimi i procesverbalit në përfundim të përzgjedhjes së subjekteve fituese, njoftimin e tyre për lidhjen e akt-marrëveshjes me AKT dhe hedhjen e shorteut për pozicionin/vendin që do të kenë ato në stendën e Shqipërisë;

-Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës dhe specifikimeve, mbi organizimin e panairit;

-Monitorimin e zbatimit të kontratës me organizatorin e panairit dhe mbajtjen e procesverbalit përmbledhës për ecurinë dhe realizimin e panairit;

-Dorëzimin pranë Drejtorisë së Financës të dokumentacionit përkatës (faturat financiare), për kryerjen e likuidimeve.

- Më pas nga grupi i punës bëhet verifikimi dhe vlerësimi i aplikimit, si dhe njoftohet aplikanti që kualifikohet/s'kualifikohet brenda 10-ditësh, nga përfundimi i aplikimeve;
- Me aplikantët fitues lidhet një akt-marrëveshje, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë panairit si dhe pas përfundimit të tij;
- Aplikantët fitues ftohen të marrin pjesë në shorteun që zhvillohet pranë zyrave të AKT-së, për të caktuar pozicionet, që do të kenë ata, në stendën e AKT-së;
- Pasi është përcaktuar pozicioni i tyre, nga AKT bëhet shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës së dhënë nga organizatori dhe specifikimeve (kosto e sipërfaqes, çfarë përfshihet brenda kësaj kostoje, kosto e regjistrimit në panair), të cilat nënshkruhen nga Titullari i AKT-së, dhe që do të shërbejnë si dokumente justifikuese për kryerjen e likuidimeve;
- Pasi këto dokumente nënshkruhen, nga organizatori lëshohet fatura tatimore, e cila parapaguhet nga AKT;
- Prihen biletat e udhëtimit për stafin e AKT, që do të marri pjesë në panair;
- Në fillim të panairit, stafi i AKT, që është pjesëmarrës, duhet të mbajë një procesverbal, ku merret në dorëzim hapësira, stenda dhe të gjitha materialet e tjera të kontraktuara;
- Një nga detyrat e tjera të stafit, është që përgjatë gjithë zhvillimit të panairit, të monitorojë sjelljen e operatorëve/agjencive turistike (qëndrimi në stendë, sjellja, komunikimi, etj);
- Pasi ka përfunduar panairi, nga Drejtoria e Financës së AKT, bëhet likuidimi i faturave të hotelit dhe dietave, për stafin e institucionit;
- Gjithashtu stafi i AKT, që morri pjesë në panair, përgatit për titullarin, një raport përmbledhës mbi gjithë ecurinë e panairit, dhe ky raport i përcillet Ministrit përgjegjës për turizmin;
- Sipas detyrimit të përcaktuar në akt-marrëveshje, në përfundim të panairit, operatori/agjencia turistike, që ka marrë pjesë në panair, duhet të përcjelli pranë AKT, raportin mbi ecurinë e aktivitetit (numrin e vizitorëve, kontratave të lidhura, etj).

Gjetje:

13) Në VKM nr.298, datë 20.04.2016³⁹, nuk përcaktohet si mjet promovues, pjesëmarrja në panairët ndërkombëtare, por AKT e përdorë këtë mënyrë promovimi, bazuar në eksperiencat e mëparshme institucionale;

14) Edhe pse ka rreth 10 vite që ky institucion merr pjesë në panairët ndërkombëtare, nuk ka një Urdhër të Ministrit përgjegjës për turizmin, për mënyrën e organizimit dhe zbatimit të procedurës, ku përgjatë vitit 2019, panairët janë zhvilluar pa u mbështetur në një procedurë ligjore. Theksojmë se në muajin Mars të vitit 2020, Titullari i AKT-së, ka nxjerrë Udhëzimin nr.01, datë 17.03.2020 me qëllim përcaktimin e rregullave për zhvillimin e procedurës së panairit;

15) AKT nuk ka indikatorë/tregues të miratuar, mbi të cilët të bëjë vlerësimin e dobishmërisë/efektit në turizëm, të fondeve të shpenzuara për një panair. Pra nëse për një panair të caktuar janë shpenzuar mesatarisht rreth 4,381,818 lekë (48,200,000 lekë / 11 panairë për 2019) për promovimin e turizmit shqiptar, nga AKT nuk arrihet të matet, se cili është kontributi i këtyre fondeve në turizmin vendas (ritje e numrit të turistëve nga shteti ku u krye panairi, ritje e numrit të kontratave të lidhura ndërmjet operatorëve/agjencive turistike shqiptare, në krahasim me vitin e mëparshëm, për të njëjtin panair, ritjen e numrit të vizitorëve në stendën e AKT-së, në krahasim

³⁹ Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së



me numrin e vizitorëve në vitin e mëparshëm, rritjen e të ardhurave të operatorit/agjencisë turistike që ka marrë pjesë në këtë panair, nga kontratat e lidhura, në krahasim me të ardhurat e gjeneruara nga ky subjekt, nga kontratat e lidhura në panairin e vitit të kaluar, e cila makroekonomikisht, përkthehet në rritje të të ardhurave në turizëm, rritjen e numrit të të punësuarëve në këto subjekte, etj); Theksojmë se nga AKT administrohet një formular vlerësimi, i cili i'u dërgohet operatorëve/agjencive turistike që marrin pjesë në panair, me qëllim plotësimin nga ana e tyre (me informacion cilësor dhe sasior), por që faktikisht, në pjesën më të madhe të rasteve (rreth 80% të tyre), ky formular nuk plotësohet;

16) AKT nuk ka studim për monitorimin e tregut, mbi prirjet dhe preferencat e konsumatorëve, se çfarë ata kërkojnë nga turizmi në tërësi dhe ai malor në veçanti, me qëllim pjesëmarrjen në panair sipas tematikës së tyre, (pra nëse gjatë vitit 2019 është rritur kërkesa për turizmin malor në krahasim me vitin 2018, ilustruar për disa zona, ku rezulton një rritje të numrit të turistëve me rreth 92,113 turistë më tepër), atëherë edhe AKT duhet të rritë pjesëmarrjen e saj në ato panair, që janë të orientuara në turizmin malor, me qëllim rritjen e efektivitetit të promovimit, si dhe qëndrueshmërinë e turizmit malor;

Tabela nr.12 Numri i turistëve sipas destinacionit turistik (2018-2019)

Qarku	Destinacioni Turistik	Viti		Diferenca
		2018	2019	
Shkodër	Theth	91,950	98,950	7,000
Korce	Bredhi i Drenovës	950	2,250	1,300
Durrës	Qafe Shtam	39,500	79,500	40,000
Tiranë	Mali i Dajtit	123,475	130,268	6,793
Vlorë	PKD Karaburun-Sazan	67,372	78,560	11,188
Vlorë	PK Llogora	200,910	199,014	(1,896)
Elbasan	Shebenik -Jabllanicë	26,187	55,003	28,816
Berat	Mali Tomorrit	173,684	172,596	(1,088)
Total		724,028	816,141	+ 92,113

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

17) Për vendosjen e kriterëve fituese për panairin e vitit 2019, që janë publikuar në portalin e-albania, nuk ka një analizë, mbi mënyrën e përcaktimit të tyre, por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se ato janë produkt i disa takimeve të AKT me subjekte private (operator dhe agjenci turistike);

18) Nuk ka një afat të përcaktuar, se sa ditë para zhvillimit të panairit, duhet të bëhet publikimi në portalin e-albania për konkurrim;

19) Kriteri i përcaktuar për numrin e pjesëmarrësve (operator/agjenci turistike) në panair, nuk është respektuar, për shëmbull, për sipërfaqen 20-40 m² lejohet të marrin pjesë 5-8 subjekte, ndërkohë kanë marrë pjesë 10 subjekte, ose për sipërfaqen mbi 100 m² lejohet të marrin pjesë deri 23 subjekte, por që faktikisht kanë marrë pjesë 26 subjekte (operator dhe shoqata e kulinarisë). Gjithashtu nuk ka një analizë, për mënyrën e përcaktimit të kriterëve mbi numrin e pjesëmarrësve, pasi kjo shoqërohet me rritje të kostos financiare të panairit, (pasi për një numër të lartë pjesëmarrësish, llogjikisht duhet një hapësirë më e madhe, më tepër tavolina, karrike, materiale promovionale, kostoja e regjistrimit, pra nuk janë të njëjta shpenzimet për 10 subjekte me shpenzimet për 13 subjekte);

20) Nga AKT nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të posaçme, për organizimin e punës, për sigurimin e hoteleve me kosto sa më të ulët, duke sjellë që në të njëjtin panair, punonjës të kategorisë së 7 – hotele me 3 yje, të paguajnë tarifa të ndryshme të hotelit⁴⁰;

21) Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet AKT dhe subjektit privat, nuk përcaktohet afati konkret, se kur duhet të dorëzohet subjekti, informacionin e kërkuar mbi panairin e zhvilluar, megjithëse ky afat është përcaktuar në Udhëzimin e nxjerrë nga Titullari i AKT-së;

⁴⁰ VKM nr.870, datë 14.02.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".



22) E gjithë procedura e mësipërme, përjashtuar shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit të agjencive/operatorëve turistik, që kanë marrë pjesë në panair, mbulohet nga fondet buxhetore të AKT-së, **detyrim ky që nuk është i përcaktuar në asnjë akt ligjor apo nëligjor, pra që me fondet e buxhetit të shtetit**, të përballohen shpenzimet e subjekteve private në panairët ndërkombëtare. Pra subjektet private **nuk paguajnë asnjë lekë**, për shpenzimet e hapësirës me qera, stendës, dizenjimit, regjistrimit në panair, materialeve promocionale që reklamohen në stendë. Theksojmë se nga takimet e AKT me subjektet private, është diskutuar mundësia e mbulimit të shpenzimeve nga të dyja palët, të cilat janë shprehur dakort, që kostot e panairit, mos të mbulohen vetëm nga fondet buxhetore të AKT, por që këto diskutime, kanë mbetur në letër, dhe nuk janë formalizuar në ndryshime të akteve nëligjore, me qëllim vënien në zbatim të tyre;

23) **Për vitin 2019** nga AKT, për pjesëmarrjen e saj dhe të agjencive/operatorëve turistik në panairë ndërkombëtare, janë shpenzuar (hapësira me qera, ndërtimi dhe dizenjimi i stendës, kostot e regjistrimit, **pa përfshirë shpenzimet e udhëtimit, dietave, hotelit të stafit të AKT-së**), rreth **44,514,645 lekë për 10** panairë ndërkombëtare, ose **rreth 60% e fondeve buxhetore** (paga, investime, shpenzime të ndryshme operative) të shpenzuara në total, për këtë vit;

24) Nëse do t'i referoheshim **Shtetit të Sllovenisë**⁴¹, për mënyrën se si vepron në organizimin dhe mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në panairët ndërkombëtare, ku **60% të shpenzimeve** mbulohen nga fondi buxhetor dhe **40%** nga buxheti i subjekteve private, për vitin 2019 në rastin e AKT, do të kishim **26,708,787 lekë**, që do të shpenzoheshin nga AKT dhe 17,808,858 lekë nga subjektet private që kanë marrë pjesë në panair, ose e thënë ndryshe **AKT do të kursente 17,808,858 lekë**, të cilat mund t'i shpenzonte në mënyra/mjete të tjera, për rritjen e efektivitetit të promovimit të turizmit shqiptar;

25) Në muajin Dhjetor të vitit **2019** janë kryer shpenzime në vlerën **3,507,438 lekë**, për llogari të 3 panairëve që zhvillohen në vitin **2020** (Madrid, Holland dhe Vienë), ndërkohë që për vitin 2019, këta 3 panairë nuk kanë qenë të miratuar nga Ministri përgjegjës për turizmin, si dhe nuk ka patur planifikim të fondeve buxhetore, pra nga AKT është bërë rishpërndarje e fondeve përtej datës 15 Nëntor, në mungesë të një arsytimi, si dhe pa marrë miratimin e Nëpunësit Autorizues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit⁴².

-Grupi i auditimit përzgjedhi në mënyrë rastësore disa procedura panairi, për vitin 2019⁴³, në të cilat rezultuan disa mangësi të së njëjtës natyrë, që janë pasqyruar në mënyrë të grupuar, si më poshtë vijon:

Gjetje të përbashkëta për 4 procedurat e mësipërme:

26) Nuk administrohen njoftimet e subjekteve fituese;

27) Nuk administrohen procesverbalet e shpalljes së fituesve;

28) Nuk administrohen deklaratat e ekzistencës/mosekzistencës së konfliktit të interesit, të anëtarëve të grupit, që ka bërë vlerësimi e aplikimeve deri në shpalljen e fituesve;⁴⁴

29) Nuk administrohen dokumentet e dorëzuara nga subjektet që kanë marrë pjesë (kryesisht mungojnë Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë 3 viteve të fundit, Kopje të materialeve promocionale të prodhuara nga Operatori Turistik, Listëpagesat e 6 muajve të fundit të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, shoqëruar me Formularin E-SIG 025/a);

30) Nga stafi i AKT-së, i cili ka marrë pjesë në panair, nuk është mbajtur procesverbali, mbi marrjen në dorëzim të stendës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara;

31) Nga operatorët/agjencitë turistike që kanë marrë pjesë në panair, nuk është respektuar detyrimi i akt-marrëveshjes, për dorëzimin e raportit përmbledhës të panairit pranë AKT, raport, i cili ka

⁴¹ https://www.slovenia.info/uploads/dokumenti/program_dela_sto_2018-2019-en_tabele_s_prevodi_slik.pdf - Programi i punës për turizmin 2018-2019.

⁴² Udhëzim nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

⁴³ Miratuar me shkresat nr.9741/1 datë 06.12.2018 dhe nr.4739/1 datë 06.06.2019, ku janë miratuar 17 panairë, dhe është marrë pjesë në 11 panairë.

⁴⁴ Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".



informacion mbi numrin e kontratave që ka lidhur në panair, numrin e turistëve që kanë blerë paketë turistike nga ky panair, të ardhurat e realizuara, etj;

32) Nuk administrohet raporti i monitorimit të operatorëve/agjencive turistike, mbi sjelljen, komunikimin dhe qëndrimin e tyre;

33) Vlerësimi i aplikimeve nuk është bërë në grup, i cili të dali me një vendim përfundimtar, për çdo aplikim, por bëhet në mënyrë individuale; Pra në një shpallje për panair, në të cilin mund të konkurrojnë 15 subjekte, secili prej anëtarëve të grupit, merrë një numër të caktuar aplikimesh dhe i shqyrton deri në fund, duke vendosur për kualifikimin ose jo tyre, çka ndikon në transparencën e këtij procesi, duke krijuar mundësinë edhe për favorizime të subjekteve.

Trajtimi i 4 procedurave, si vijon:

Panairi në Madrid (datat 23.01.2019-27.01.2019):

-Nga AKT morrën pjesë 3 punonjës;

-Nga agjencitë dhe operatorët turistik morrën pjesë: A.T, S.T, E.T, S.T, A.T, P.J, T.B, H.T, si dhe A.O, pra 10 subjekte;

-Shpenzimet për këtë panair ishin:

1,341,864 lekë (10,720 euro) për marrjen me qera të stendës në sipërfaqen 36 m²;

66,870 lekë (550 euro) dieta për 3 punonjës;

463,750 lekë (3,710 euro) hotel për 3 punonjës;

36,500 lekë (292 euro) 2 taksi për 3 punonjës (aeroport-hotel dhe e anasjellta);

30,250 lekë (242 euro) shpenzime siguracioni dhe regjistrimi në panair (stafi i AKT + subjektet private);

Gjithsej = **1,939,234 lekë** (15,515 euro) total.

Nga shqyrtimi i procedurës së mësipërme rezulton se:

Gjetje:

34) Subjekti S.T, është shpallur fitues, por nuk merrë pjesë në panair, dhe për këtë nuk administrohet njoftimi i subjektit për mospjesëmarrjen, si dhe theksojmë që vendin e tij, e ka zënë subjekti P.J, i cili nuk ka qenë pjesë e konkurrimit;

35) Për kryerjen e transaksioneve në valutë të huaj (euro) është marrë ofertë vetëm nga një Bankë, e cila ka dhënë kursin e këmbimit valutor 125, pra për të blerë 1 euro AKT ka paguar 125 lekë, ku nëse do t'i referoheshim kursit të këmbimit të publikuar në Bankën e Shqipërisë në datën 12.02.2019, rezulton se për të blerë 1 euro AKT do të paguante 124.2 lekë, dhe nga ky kurs, duke marrë në konsideratë vlerën prej 1,345,760 lekë të konvertuar në euro, do të kursente 110 euro ose 13,750 lekë;

36) Në shpenzimet për taksi, rezulton se nga grupi prej 3 punonjësish, të cilët në aeroportin e Madridit kanë zbritur në të njëjtën kohë, janë marrë 2 taksi, shërbim i cili ka kushtuar 292 euro, ose 36,500 lekë, ndërkohë që për rrugën e përshkruar nga aeroporti në hotel, mund të ishte përdorur vetëm 1 taksi, dhe në këtë mënyrë do të ishin kursyer rreth 70 euro, ose 8,750 lekë;

37) Gjithashtu grupi i auditimit, me qëllim vlerësimin me përafërsi të mundësisë, për reduktimin e shpenzimeve për hotel, në këtë panair, i'u referua listës së hoteleve të publikuara në faqen zyrtare të organizimit të panairit⁴⁵, ku zgjodhi 5 hotele (C, A.H, G, H.M, I.A), me çmimet, respektivisht 310 euro për 4 netë, 298 euro, 253 euro, 345 euro dhe 295 euro, dhe çmimi mesatar/1 natë është rreth 75 euro, ndërkohë që nga punonjësit e AKT është paguar rreth 230 euro/1 natë, ose 155 euro më tepër.

38) Në mënyrë të përmbledhur rezulton se janë përdorur pa ekonomikitet (kursi i këmbimit, taksi dhe hotel) **rreth 340,000 lekë ose 2,800 euro.**

⁴⁵ <https://www.ifema.es/en/fitur/passport/hotels>



Panairi në Milano (datat 09.02.2019-13.02.2019):

-Nga AKT morrën pjesë 2 punonjës;

-Nga agjencitë dhe operatorët turistik morrën pjesë: E.T, A.E, B.H, S.T, A.F, G.A, A.T, A.T, T.A, X.A, G.T, A.T, pra 12 subjekte;

-Shpenzimet për këtë panair ishin:

1,214,778 lekë (9,650 euro) për marrjen me qera të stendës në sipërfaqen 50 m² (shtrimi me moket i sipërfaqes, struktura e ngritur, shiritat, nyjet lidhëse, llampat, paneli elektrik, 10 tavolina recepsioni, 4 tavolina xhami, 12 karrige, 1 dollap dhe varrëse rrobash, impianti audio, grafika); **1,650,909 lekë** (13,100 euro) stenda me 3 krahët e hapur, kuota e regjistrimit, shërbimet e sigurimeve;

44,553 lekë (330 euro) shtimi i 11 karrigeve dhe tavolinave, 14,433 lekë (90 euro) shtimi i një tavoline;

40,480 lekë (295 euro) regjistrimi dhe siguracioni për 13 subjektet;

50,200 lekë (400 euro) dieta për dy punonjësit e AKT;

205,820 lekë (1,640 euro) shpenzime për hotelin për 2 punonjës;

32,504 (250 euro) shpenzime për taksë (hotel aeroport dhe e anasjellta);

Gjithsej = 3,253,677 lekë ose 25,755 euro

Nga shqyrtimi i procedurës së mësipërme rezulton se:

Gjetje:

39) Sipas informacionit të pasqyruar në raportin përmbledhës të AKT, dërguar në MTM, 1 subjekt A.T, nuk ka aplikuar, si dhe nuk administrohet asnjë dokumentacion për këtë subjekt;

40) Sipas shortit të hedhur për pozicionin e subjekteve në stendë dhe raportit përmbledhës, rezulton se në short janë 10 subjekte, në raport janë 12 subjekte, pra 2 subjekte më tepër. Gjithashtu një subjekt L.T, është shpallur fitues, por nuk ka marrë pjesë në panair, dhe për këtë nuk administrohet njoftimi, që është tërhequr nga pjesëmarrja. Subjekti G.T nuk ka qenë pjesë e konkurrimit si dhe e shortit të hedhur, ndërkohë merrë pjesë në panair, po kështu edhe subjekti X.A;

41) Një subjekt, A.T, në periudhën e aplikimit dhe shpalljes fitues, nuk ka qenë i pajisur me licencën për ushtrimin e aktivitetit si operator/agjenci turistike (kategoria XI.2⁴⁶), dhe nuk duhej të shpallej fitues;

42) Një subjekt, A.F, nuk ka qenë i licencuar për ushtrimin e aktivitetit si agjenci/operator turistik, por si agjenci transporti udhëtarësh/mallrash, dhe për këtë nuk duhej të shpallej fitues;

43) Në këtë panair është autorizuar për të marrë pjesë 1 punonjës, i cili nuk ka qenë pjesë e Drejtorisë së Marketingut dhe Promocionit, por ka qenë pjesë e Drejtorisë së Projekteve, ç'ka tregon mungesë efektiviteti dhe efience të përdorimit të burimeve financiare dhe njerëzore⁴⁷;

44) Për kryerjen e transaksioneve në valutë të huaj (euro) është marrë ofertë vetëm nga një Bankë, e cila ka dhënë kursin e këmbimit valutor 125.5, pra për të blerë 1 euro AKT ka paguar 125.5 lekë, ku nëse do t'i referoheshim kursit të këmbimit të publikuar në Bankën e Shqipërisë në datën 12.02.2019, rezulton se për të blerë 1 euro AKT do të paguante 124.2 lekë, dhe nga ky kurs, duke marrë në konsideratë vlerën prej 2,865,687 lekë të konvertuar në 22,800 euro, **do të kursente 235 euro ose 29,492 lekë**;

45) Me urdhër shpenzimin nr.24, datë 07.02.2019, nga AKT është paguar fatura (invoice) nr.888, datë 15.01.2019 në vlerën **1,650,909 lekë** ose 13,100 euro, lëshuar nga organizatori i panairit, për të cilën në dosjen e këtij panairi, nuk administrohet oferta dhe specifikimet e nënshkuara nga Titullari i AKT-së, si dhe arsyetimi për të bërë një shpenzim të tillë, ndërkohë që është paguar një faturë në vlerën 1,214,778 lekë ose 9,650 euro (për marrjen me qera të stendës, ku përfshihen edhe shtrimi me moket i sipërfaqes, struktura e ngritur, shiritat, nyjet lidhëse, llampat, paneli elektrik, 10

⁴⁶ VKM nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

⁴⁷ Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.22, datë 10.07.2013 "Mbi zbatimin e VKM nr.870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".



tavolina recepsioni, 4 tavolina xhami, 12 karrige, 1 dollap dhe varrëse rrobash, impianti audio, grafika);

46) Me urdhër shpenzimin nr.25, datë 07.02.2019, janë paguar **44,553 lekë** ose 330 euro, shtimi i 11 karrigeve dhe tavolinave, ndërkohë që në shpenzimin për stendën kanë qenë të përfshira 10 tavolina recepsioni, 4 tavolina xhami, 12 karrige, si dhe nuk administrohet arsyetimi për të bërë një shpenzim të tillë;

47) Me urdhër shpenzimin nr.26, datë 07.02.2019 është paguar vlera **14,433 lekë** ose 90 euro, për shtimin edhe të 1 tavoline, ku përsëri nuk administrohet arsyetimi për të bërë një shpenzim të tillë;

48) Gjithashtu sipas faturës tatimore 820 euro/person për 4 netë qëndrimi, ose 205 euro/1 natë qëndrimi për person, të lëshuar nga hoteli, ku ka qendruar stafi i AKT-së, rezulton se të dy punonjësit kanë qendruar në të njëjtën dhomë, dhe padrejtësisht janë paguar shpenzimet për hotel, për të dy punonjësit (820 euro + 820 euro = 1,640 euro ose 205,820 lekë), ndërkohë duhej paguar vetëm 820 euro ose 102,910 lekë, pra shpenzimet për 1 dhomë/4 netë qëndrimi.

-Në mënyrë të përmbledhur rezulton se janë përdorur pa ekonomikitet (kursi i këmbimit, taksi dhe hotel) **rreth 1,842,297 lekë** ose **14,500 euro**.

Panairi në Izrael (datat 12.02.2019-13.02.2019):

-Nga AKT morrën pjesë 2 punonjës;

-Nga agjencitë dhe operatorët turistik morrën pjesë: A.E, B.P, X.A, G.T, T.B, pra 5 subjekte;

-Shpenzimet për këtë panair ishin:

834,750 lekë (6,625 euro) për marrjen me qera të sipërfaqes 12 m²;

255,150 lekë (2025 euro) arredimi dhe dizenjimi;

181,125 lekë (1117.5 dollar hotel për dy punonjësit për 3 netë + 320 dollar dieta për dy punonjësit për 4 ditë = 1437.5 dollar)

Gjithsej = **1,271,025 lekë** ose **8,650 euro** dhe **1,437.5 dollar**

Gjetje:

49) Për kryerjen e transaksioneve në valutë të huaj (euro) është marrë ofertë vetëm nga një Bankë, e cila ka dhënë kursin e këmbimit valutor 126, pra për të blerë 1 euro AKT ka paguar 126 lekë, ku nëse do t'i referoheshim kursit të këmbimit të publikuar në Bankën e Shqipërisë në datën e kryerjes së veprimit, rezulton se për të blerë 1 euro AKT do të paguante 124.6 lekë, dhe nga ky kurs, duke marrë në konsideratë vlerën prej 1,089,900 lekë të konvertuar në 8,650 euro, **do të kursente 95 euro**;

50) Sipas autorizimit të titullarit nr.11/1, datë 05.02.2019, janë autorizuar dy punonjësit që të shkojnë me shërbim, nisja më datë 11.02.2019 dhe kthimi 13.02.2019, pra 2 netë e 3 ditë, ndërkohë që punonjësit kanë qendruar 3 netë dhe 4 ditë, veprim i cili është shoqëruar me efekte financiare 186.26 dollar (1 natë qëndrimi më tepër) + 40 dollar (1 ditë dietë më tepër) = 24,840 lekë * 2 persona = **49,680 lekë** ose **452.5 dollar gjithsej**;

51) Përsëri të dy personat sipas faturës tatimore, 560 dollar (61,480 lekë)/person për 3 netë qëndrimi, ose 186.26 dollar/për 1 natë qëndrim për 1 person, të lëshuar nga hoteli, ku ka qendruar stafi i AKT-së, rezulton se të dy punonjësit kanë qendruar në të njëjtën dhomë dhe padrejtësisht janë paguar shpenzimet për hotel, për secilin prej tyre, ndërkohë duhej paguar vetëm **560 dollar** ose **61,480 lekë**, pra shpenzimet për 1 dhomë/3 netë qëndrimi;

-Në mënyrë të përmbledhur rezulton se janë përdorur pa ekonomikitet **111,160 lekë** ose **1,012.5 dollar**.

Panairi në Berlin (datat 06.03.2019-10.03.2019):

-Nga AKT morrën pjesë 3 punonjës;

-Nga agjencitë dhe operatorët turistik morrën pjesë 24 subjekte: A.T, X.A, E.T, S.T, A.F, G.T, A.E, A.T, A.T, S.T, A.H, I.A, H.T, T.B, S.T, A.H, S.T, V.A, A.A, V.S, E.T, P.J, A.T dhe J.T, pra 24 subjekte;

-Shpenzimet për këtë panair ishin:

8,056,242 lekë (64,193 euro) ndërtimi dhe arredimi i stendës në sipërfaqen e marrë 122 m²;



4,786,236 lekë (38,912 euro) për marrjen me qera të stendës në sipërfaqen 122 m² dhe interneti;
335,713 lekë (2,675 euro) për kartat elektronike (badges) 53 cop gjithësej;
73,000 lekë (584 euro) dieta për tre punonjësit e AKT;
460,250 lekë (3,674 euro) shpenzime për hotelin për tre punonjës;
77,125 lekë (617 euro) shpenzime për taksì (hotel aeroport dhe e anasjellta);
146,032 lekë (1,170 euro) shpenzime për bileta avioni.
Gjithsej = **13,934,598 lekë ose 111,825 euro**

Nga shqyrtimi i procedurës së mësipërme rezulton se:

Gjetje:

52) Për këtë procedurë, pranë AKT është administruar shkresa kthim përgjigje nr.196 prot., datë 28.02.2019, ndaj ankesës së bërë nga subjekti privat B.P, për s'kualifikimin nga pjesëmarrja në panairin e Berlinit. Në përgjigjen e dhënë nga AKT, pasqyrohet informacioni se ky subjekt është s'kualifikuar për arsye se nuk ka qenë i licencuar si operator turistik, ndërkohë nga shqyrtimi i subjekteve fituese në këtë panair, rezulton se janë dy subjekte, të cilët nuk kanë qenë të pajisur me licencën e ushtrimit të aktivitetit si operator turistik, për më tepër, njëri prej tyre është i licencuar për transport të njërzëve/mallrave;

53) Mungon arsyetimi për numrin e lartë të pjesëmarrjes së subjekteve, pasi kjo përkthehet në kosto më të larta për AKT;

54) Për kryerjen e veprimeve në valutë të huaj (euro) është marrë ofertë vetëm nga një Bankë, e cila ka dhënë kursin e këmbimit valutor 125.5, pra për të blerë 1 euro AKT ka paguar 125.5 lekë, ku nëse do t'i referoheshim kursit të këmbimit të publikuar në Bankën e Shqipërisë në datën 16.05.2019, rezulton se për të blerë 1 euro AKT do të paguante 123 lekë, dhe nga ky kurs, duke marrë në konsideratë vlerën prej 8,056,242 lekë të konvertuar në 64,193 euro, **do të kursente 1,257 euro**; Po kështu edhe për veprimin tjetër në valutë të huaj (euro), ku janë këmbyer 4,786,236 lekë në 38,912 euro me kursin e këmbimit 123 lekë, ndërkohë që nëse do t'i referoheshim kursit të këmbimit të publikuar në Bankën e Shqipërisë në datën 13.06.2019, 121.9, do të kurseheshin **325 euro**. Pra gjithsej **1,582 euro ose 197,370 lekë**, humbje nga veprimet në valutë të huaj.

55) Me urdhër shpenzimin nr.102, datë 15.05.2019, nga AKT është paguar fatura (invoice) nr.1080713R191201, datë 11.03.2019 në vlerën **8,056,242 lekë** ose 64,193 euro, lëshuar nga subjekti që ka kryer ndërtimin dhe arredimin e stendës, për të cilën nuk administrohet komunikimi zyrtar i AKT-së me subjektin, oferta dhe specifikimet e nënshkruara nga Titullari i AKT-së.

56) Shpenzimet për kartat elektronike (badge), ku sipas MEMO nr.234, datë 21.03.2019, drejtuar Drejtorit të Financës, pasqyrohet informacioni, për pagesën e 53 kartave elektronike (3 për stafin e Ministrisë së Turizmit, 3 për stafin e AKT, 1 për Ambasadën Shqiptare në Berlin, si dhe 46 cop për 23 subjektet private ku secili ka dy përfaqësues) gjithsej 335,713 lekë (2,675 euro) paguar me Urdhër Shpenzimin nr.67, datë 03.04.2019, ndërkohë janë paguar edhe 14 karta elektronike të tjera (që nuk dihet se për cilët persona) me Urdhër Shpenzimin nr.120, datë 12.06.2019, sipas faturës (invoice) nr.5254132R191201 në të cilin është likujduar edhe qiraja e hapësirës, ku është vendosur stenda. Pra gjithësej janë paguar 67 karta elektronike, por raportohet për 53 karta. Nga këto 67 karta elektronike, të cilat e kanë çmimin 50 euro/cop, 3 janë për stafin e AKT, 3 për stafin e MTM, 1 për përfaqësuesin e Ambasadës Shqiptare në Berlin, 46 cop për 23 subjektet private që kanë marrë pjesë në panair⁴⁸, si dhe 14 cop që nuk dihet se nga cilët persona janë përdorur, gjithsej **3,200 euro ose 400,000 lekë**;

57) Fatura (invoice) për qeranë e stendës është kopje dhe jo origjinale, dhe nuk duhej pranuar nga Drejtoria e Financës.

58) Në shpenzimet për taksì, rezulton se nga grupi prej 3 punonjësish, 2 prej të cilëve në aeroport (Berlin) kanë zbritur në të njëjtën kohë, po kështu edhe për kthimin në Shqipëri, ku nisja nga Berlini ka qenë në të njëjtën kohë, janë marrë 2 taksì, shërbim i cili ka kushtuar 422 euro, ose

⁴⁸ Pika 1 e Udhëzimit nr.22, datë 10.07.2013 të Ministrisë së Financave, mbi zbatimin e VKM nr.870, date 14.12.2011 "për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".



52,750 lekë, ndërkohë që për rrugën e përshkruar nga aeroporti në hotel dhe anasjelltas, mund të ishte përdorur vetëm 1 taksi, dhe në këtë mënyrë do të ishin kursyer rreth 193 euro, ose 24,125 lekë.

-Në mënyrë të përmbledhur rezulton se janë përdorur pa ekonomikitet **rreth 621,495 lekë ose 4,975 euro.**

Panairi në Madrid (datat 22.01.2020-26.01.2020)⁴⁹:

-Nga AKT morrën pjesë 4 punonjës;

-Nga agjencitë dhe operatorët turistik morrën pjesë: A.T, A.D, A.T, F.B, T.B, A.T, A.T, H.T, E.T, A.E, T.A, E.T, pra 12 subjekte;

-Shpenzimet për këtë panair ishin:

2,251,023 lekë (18,301 euro) ndërtimi dhe arredimi i stendës në sipërfaqen e marrë 51 m²;

995,391 lekë (8,092 euro) për marrjen me qera të stendës në sipërfaqen 51 m²;

88,560 lekë (720 euro) dieta për 4 punonjësit e AKT;

271,953 lekë (2,211 euro) shpenzime për hotelin për 4 punonjës;

64,698 lekë (526 euro) shpenzime për taksi (hotel aeroport dhe e anasjellta);

Gjithsej = **3,671,625 lekë ose 29,850 euro**

Nga shqyrtimi i procedurës së mësipërme rezulton se:

Gjetje:

59) Për kryerjen e transaksioneve në valutë të huaj (euro) është marrë ofertë vetëm nga një Bankë, e cila ka dhënë kursin e këmbimit valutor 123, pra për të blerë 1 euro AKT ka paguar 123 lekë, ku nëse do t'i referoheshim kursit të këmbimit të publikuar në Bankën e Shqipërisë në datat (15.01 dhe 20.02.2020) e kryerjes së dy veprimeve, rezulton se për të blerë 1 euro AKT do të paguante 122 lekë, dhe nga ky kurs, duke marrë në konsideratë vlerën prej 3,246,414 lekë të konvertuar në euro, do të kursente 98 euro ose **12,055 lekë;**

60) Në shpenzimet për taksi, rezulton se nga grupi prej 4 punonjësish, 3 prej tyre në aeroportin e Madridit kanë zbritur në të njëjtën kohë, ndërkohë janë marrë 2 taksi për transportin në hotel, shërbim i cili ka kushtuar 160 euro, ose 19,680 lekë, dhe në këtë rast mund të ishte përdorur vetëm 1 taksi, duke kursyer në këtë mënyrë 75 euro ose **9,225 lekë;**

61) Në panairin e Madrid 2020, krahasuar me panairin e Madrid 2019, rezulton **rritje** e shpenzimeve me **1,915,326 lekë** ose 15,701 euro (shpenzime për stendën), ndërkohë që në krahasim me panairin e parë ka ndryshuar vetëm hapësira e sipërfaqes së marrë me qera, **15 m² më tepër**, por që nuk justifikon rritjen e kostos, si më sipër, si dhe specifikimet sipas aplikimit të nënshkruar nga AKT janë të njëjta, konkretisht:

Nr	Madrid 2019	Kosto	Madrid 2020	Kosto	Rritja
1	Hapësira me qera dhe struktura e stendës për 36 m ²	7,425 euro ose 931,837 lekë	Vetëm hapësira me qera për 51 m ²	8,092 euro ose 995,391 lekë	63,554 lekë ose 667 euro
2	Arredimi i stendës për 36 m ²	399,251 lekë ose 3,181 euro	Arredimi i stendës për 51 m ²	2,251,023 lekë ose 18,301 euro	1,851,772 lekë ose 15,120 euro
				Total (63,554 lekë + 1,851,772 lekë)	1,915,326 lekë ose 15,787 euro
	Çmimi për m ² =188 euro		Çmimi për m ² =143 euro		

62) Për shpenzimet e mësipërme për ndërtimin e stendës në panairin Madrid 2020 nuk administrohet oferta dhe specifikimet e nënshkruara nga AKT, arsyetimi për të bërë një shpenzim të tillë, si dhe referuar 3 faturave (invoice) për për ndërtimin dhe arredimin e stendës në vlerën 2,251,023 lekë ose 18,301 euro, rezulton se i njëjti element shpenzimi me të njëjtin kod (6RM02004) për 1 m², njëher faturohet me çmimin 160 euro dhe herën tjetër 17,313 euro, për të cilat nuk administrohet oferta, specifikimet e dakordësuara midis AKT dhe organizatorit.

⁴⁹ Miratuar me shkresën nr.8609/1, datë 11.12.2019, ku janë miratuar 17 panaiere, dhe për shkak të Pandemis Covid-19, është marrë pjesë në 5 panaiere.



-Në mënyrë të përmbledhur rezulton se janë përdorur pa ekonomikitet rreth **1,936,606 lekë ose 15,875 euro**.

Lidhur me **strukturën e AKT**, për periudhën 2019-2020, nuk ka pasur ndryshime në rritje apo pakësim të numrit të punonjësve.

-Nisur nga misioni dhe funksionet kryesore të AKT, grupi i auditimit gjykon se, në strukturën e këtij institucioni (përfshirë shërbimet mbështetëse), **peshën kryesore sipas llojit të arsimit**, duhet ta ketë arsimimi në **marketing, menaxhimi i turizmit kulturor, menaxhimi i turizmit arkeologjik, menaxhimi i hoteleri turizëm, administrim biznesi, marrëdhënie ndërkombëtare** (meqënëse, ky institucion merrë pjesë në disa panairë ndërkombëtare). Në vijim kemi pasqyruar për disa prej llojeve të arsimit, se çfarë aftësish përfiton dhe ku mund të punësohet një punonjës⁵⁰ i arsimuar në degët e mësipërme:

1. Marketing - ofron si njohuri bazë për studentët, ashtu edhe njohuri të veçanta, profesionale. Arsimimi në marketing krijon një sërë mundësish për të bërë karrierë në fushën profesionale dhe akademike. Njëkohësisht, mundëson punësimin në sektorin privat dhe publik, pasi programi krijon njohuri të plotë mbi fushën e marketingut të biznesit/institucionit dhe zgjidh problematikat dhe zhvillimet e tyre. Në përfundim të programit, studenti përfiton njohuri dhe aftësinë e zhvillimit të fushatave marketing, si dhe mund të punësohet si: menaxher marketingu apo drejtues në sektorin privat dhe publik, specialist në menaxhimin e shitjeve, specialist në menaxhim marketing, specialist në komunikim, specialist në menaxhimin e mediave, specialist pranë zyrave të marrëdhënieve me publikun, menaxher produkti, mundësi për të zhvilluar studime të avancuara në këtë fushë, etj;

2. Menaxhimi i turizmit kulturor – ka si qëllim transferimin e koncepteve kryesore teorike për organizimin e bizneseve të turizmit nga pikëpamja ekonomike-financiare e strukturore. Nëpërmjet këtij programi fitohen njohuri të gjera mbi konceptet bashkëkohore të Turizmit Kulturor dhe menaxhimit të tij, për të transmetuar tek studentët dijet dhe t'i pajisë ata me njohuritë bazë mbi vlerat, rëndësinë, ruajtjen dhe format e mundshme të përdorimit të përshtatshëm, menaxhimin e elementeve, ndërtesave dhe monumenteve të Trashëgimisë Kulturore, si dhe i aftëson për të luajtur rol ndërveprues dhe aktiv në vendimmarrje të caktuara në planifikimin turistik. Nëpërmjet këtyre njohurive një person i arsimuar në menaxhimin e turizmit kulturor, mund të punësohet në agjencitë e udhëtimeve, guida turistike, administratë shtetërore dhe joshtetërore të interesuara në sektorin e turizmit kulturor, etj.

3. Administrim biznesi – ofron njohuri të plotë mbi sistemin e menaxhimit të biznesit/institucionit dhe zgjidh problematikat dhe zhvillimet e tyre. Gjithashtu zhvillohen njohuritë mbi modelin ekonomik, metodat statistikore dhe sasiore, si dhe aftësia për të realizuar studime mbi konsumatorët, firmat, tregjet dhe studime mbi organizatën, operacionet, cilësinë, projektet, etj. Nëpërmjet këtyre njohurive një person i arsimuar në administrim biznesi, mund të punësohet si drejtues në sektorin privat dhe publik, specialist në menaxhimin e prodhimit, specialist në menaxhimin e burimeve njerëzore, specialist në projekte, specialist në komunikim, etj.

-Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi strukturën dhe burimet njerëzore (duke u fokusuar në Drejtorinë e Marketingut dhe Promocionit, si dhe Drejtorinë e Projekteve dhe Zonave me Përparësi Zhvillimin e Turizmit (16 pozicione pune, ose 67% e organikës), si dhe informacionit të pasqyruar në tabelën e mësipërme, rezulton se:

Gjetje:

63) Përshkrimet për pozicionet e punës (konkretisht për llojin e arsimit) në Drejtoritë e mësipërme, **nuk janë** sipas përcaktimeve ligjore të bëra në Udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike nr.01, datë 31.05.2017 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil", pra kërkesat e arsimit për pozicionet e punës, si dhe në gjykimin e grupit auditues, **nuk janë në përputhje me funksionet** dhe natyrën e punës që kryhet në këto pozicione

⁵⁰ <https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programet-bachelor/>



(për shëmbull në pozicionin e specialistit të marketingut mund të punësohet një person i cili është diplomuar për gjuhë të huaj, arte të bukura, ose në pozicionin e specialistit të promocionit të punësohet një person, i cili është i diplomuar për dizanj, pikturë, etj), dhe kjo ka sjellë që në këto dy Drejtori, vetëm **4 punonjës nga 15 të punësuar efektivisht**, ose 27%, të kenë formimin arsimor, në përputhje me llojin dhe natyrën e funksionit që kryhen.

64) Nëse do të fokusoheshim akoma më tepër, pra vetëm në Drejtorinë e Marketingut dhe Promocionit, rezulton se vetëm **7 punonjës** nga 10 në këtë Drejtori, ose 70%, nuk kanë formimin arsimor, në përputhje me llojin dhe natyrën e funksionit që kryhen.

65) Sa më sipër krijohet bindja e arsyeshme se, Drejtorisë së Marketingut dhe Promocionit i është dhënë prioritet në numër (42% të strukturës së institucionit), por jo edhe në formimin arsimor.

66) Gjithashtu rezulton se, për rreth **1.5 vite**, pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Projekteve dhe Zonat me Prioritet Zhvillimin e Turizmit, është vakant, si dhe 3 pozicione të tjera të specialistëve të AKT;

67) Theksojmë se fenomeni, ku nuk përputhet lloji i funksionit me llojin e arsimit, për më tepër edhe me kërkesat e përshkrimit të punës, rezulton edhe për:

- **Pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**, pra Nëpunësit Zbatues të Institucionit, i cili duhet të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë ekuivalente me të⁵¹, me përvojë menaxheriale dhe i specializuar në fushën e menaxhimit financiar ose të financave publike⁵² jo më pak se pesë vjet pune në profesion, por që faktikisht është diplomuar për drejtim të fermave dhe agrobiznesit;
- **Pozicionin e specialistit në Sektorin e Qerasë dhe Zonave me Prioritet Zhvillimin e Turizmit**, ku sipas kërkesave të përshkrimit të punës, personi i punësuar, duhet të jetë i diplomuar në Master Profesional në shkencat ekonomike/juridike, por që faktikisht rezulton të ketë përfunduar studimet Bachelor (3 vite studime).

68) Sa i përket trajnimeve, për periudhën 2019-2020, rezulton një numër tepër i ulët ditësh trajnimi, por edhe punonjësish, ku për dy vite janë trajnuar vetëm 4 punonjës ose 17 % e strukturës, si dhe janë kryer 17 ditë trajnime gjithsej, ose 8.5 ditë trajnim në vit.

69) Referuar planeve vjetore të punës së AKT për periudhën 2019-2020, nga ky institucion, nuk janë përgatitur materiale audiovizive me qëllim promovimin e turizmit malor;

70) Referuar VKM nr.298, datë 20.4.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit", AKT përgjatë periudhës 2019-2020, nëpërmjet kanaleve sociale on-line (www.albania.al), është fokusuar më tepër në promovimin e ecjes në natyrë, si një sport që zhvillohet kryesisht në zonat malore në Shqipëri, ndërkohë që për sporte të tjera si, hedhja me parashutë, çiklizmi malor, trekking, ngjitjet alpinistike dhe shëtitje me kuaj, nuk ka patur promovime;

71) Referuar planit vjetor të punës së AKT, për vitin 2019, nga ky institucion nuk është kryer asnjë aktivitet që të ketë patur fokus zhvillimin e turizmit natyror/malor, por në muajin Tetor të vitit 2020, AKT ka ofruar mbështetjen e saj (shpërndarjes së materialeve promovuese në pjesmarrësit, si dhe publikimin e këtij aktiviteti në rrjetin social www.albania.al), në zhvillimin e aktivitetit "Festa e Ullirit", në Bashkinë Roskovec;

72) Referuar Urdhrit nr.65, datë 01.04.2019 të Kryeministrit, "Për planin e masave për sezonin turistik, viti 2019", nga AKT:

- Nuk është përgatitur programi për vendosjen e sinjalistikës informuese dhe promovuese në destinacionet turistike më të frekuentuara;
- Nuk janë organizuar dhe mbështetur veprimtari argëtuese në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, shoqata apo subjekte private, me qëllim promovimin e turizmit;
- Nuk është marrë asnjë masë për pajisjen me materiale informuese të stendave promovuese, që janë ngritur pranë pikave kufitare dhe në përfaqësitë diplomatike shqiptare jashtë vendit, me

⁵¹Udhëzim nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

⁵²Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".



qëllim informimin e vizitorëve dhe zhvillimin e produkteve të ndryshme turistike (detar, malor, historik, kulturor, etj);

- Nuk ka asnjë komunikim dhe bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore për hapjen dhe vënien në funksion të zyrave të informimit të turistëve;
 - Databasa me destinacionet turistike që administrohet nga AKT, e cila në zbatim të Urdhrit të mësipërm i është vënë në dispozicion Autoritetit të Rugor Shqiptar, me qëllim që këto destinacione të pajisen me sinjalistikën informuese dhe promovuese, nuk është e plotë, për arsye se ka mangësi në numër destinacionesh, në krahasim me regjistrin e burimeve turistike që administrohet nga MTM, por edhe me ato që administrohen në qendrat e vizitorëve/zyrave të informacionit për turistët.
- Mangësitë mbi funksionimin e AKT-së, janë evidentuar edhe në përgjigjet e pyetësorit, drejtuar agjencive/operatorëve turistik, pasqyruar nw Kapitullin "Aneksë".

Komitetet Rajonale të Zhvillimit të Turizmit (KRZHT):

Grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit, me qëllim grumbullimin evidencës audituese përkatëse, pra të aktivitetit të KRZHT, zhvilloi takime me Prefektin e Qarkut Vlorë, Korçë dhe Shkodër, të cilët njëkohësisht kanë edhe pozicionin e Kryetarit të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, mbi mbledhjet e kryera nga këto Komitete.

Sa më sipër, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga **KRZHT Qarku Vlorë**, rezultoi se,

Gjetje:

73) Në këtë Qark, për periudhën 2019-2020, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit nuk ka funksionuar⁵³;

74) Nuk administrohen procesverbalet e mbledhjeve që ka zhvilluar KRZHT, si dhe rekomandimet e përcjella zyrtarisht në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit⁵⁴;

75) Nuk administrohet informacioni i raportuar në MTM dhe AKT, për çështje që lidhen me turizmin sipas territorit administrativ përkatës⁵⁵;

76) Theksojmë se dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, i përket mbledhjeve të task-forcës ndërinstitucionale, si dhe planit të masave të task-forcës për menaxhimin e sezonit turistik veror për vitin 2019 dhe vitin 2020, ku rezulton se Agjencia Kombëtare e Turizmit (institucion qendror për promovimin e turizmit) nuk është pjesë e realizimit të tyre;

77) Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, më konkretisht Urdhërit të Prefektit nr.49, datë 11.06.2019 "Për ngritjen e grupit të punës ndërinstitucional për monitorimin dhe kontrollin e detyrimeve ligjore në kuadër të sezonit turistik veror 2019", ku AKT është pjesë e këtij grupi pune, rezulton se detyrat e përcaktuara në këtë Urdhër për AKT, nuk kanë aspak lidhje me detyrat funksionale të Agjencisë Kombëtare të Turizmit (monitorimin dhe kontrollin).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga **KRZHT Qarku Korçë**, rezultoi se,

Gjetje:

78) Për Qarkun Korçë, për periudhën 2019-2020, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, është ngritur si strukturë, por nuk ka funksionuar sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin e Ministrisë për turizmin nr.8502, datë 24.10.2016, sepse përfaqësuesit e Komitetit⁵⁶, nuk janë sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin e mësipërm, konkretisht nuk ka përfaqësues të shoqatave që operojnë në sektorin e turizmit (të cilët janë burimi kryesor i identifikimit të problematikave të ndryshme që ka sektori i turizmit në Qarkun e Korçës), ose janë përcaktuar si anëtarë të këtij Komiteti, institucione të cilat nuk parashikohen në Udhëzimin e mësipërm;

79) Procesverbalet e mbledhjeve (2 mbledhje gjithësej për periudhën 2019-2020), nuk kanë nënshkrimin e pjesëmarrësve që duhet të marrin pjesë në mbledhje, për më tepër, sipas këtij

⁵³Neni 20 i Ligjit nr.93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar.

⁵⁴Udhëzim i Ministrisë për turizmin nr.8502, datë 24.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit".

⁵⁵ Ligji nr.93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, neni 20;

⁵⁶ Rregullore për funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, nr.420 prot., datë 08.03.2019.



procesverbali, rezulton se nuk kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e Komitetit (përfaqësuesit e Bashkive të Qarkut Korçë, Zonave të Mbrojtura, Inspektoratit të Turizmit, Drejtorisë së Kulturës, etj);

80) Nuk administrohen njoftimet e sekretarisë teknike, drejtuar përfaqësuesve, për mbledhjen dhe diskutimet që do të kryhen;

81) Në procesverbalet e dy mbledhjeve, nuk pasqyrohen rekomandimet për problematikat e diskutuara (siguria në plazhe, vendosjen e kullave të vrojtimit, rojeve të plazhit, higjiena dhe qetësia, për sigurimin e jetës së pushuesve, vazhdimin e restaurimit të monumenteve të kulturës si objekte kryesore të tërheqjes turistike si dhe vendosjen e ciceronëve në këto objekte, mungesa e bashkëpunimit të institucioneve me operatorët turistik, mungesa e paketave të përbashkëta për ture turistike për të gjitha bashkitë e Qarkut të Korçës), të cilat i përcillen MTM, për marrjen e masave të nevojshme, për zgjidhjen e tyre;

82) Nga informacioni i pasqyruar në procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit, rezulton se nuk ka asnjë diskutim për turizmin malor, por kryesisht diskutimet janë të fokusuar në menaxhimin e sezonit turistik veror, sigurinë në plazhe;

83) Nuk administrohet informacioni i raportuar në AKT, për çështje që lidhen me turizmin sipas territorit administrativ përkatës⁵⁷.

KRZHT Qarku Shkodër nuk i'u përgjigj kërkesës së grupit të auditimit për dokumentacion.

▪ Mangësitë mbi funksionimin e Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit, u evidentuan edhe në përgjigjet e pyetësorit drejtuar agjencive dhe operatorëve turistik, pasqyruar në Kapitullin "Aneksë".

Konkluzione:

1. Mungesa e marrjes së masave nga MTM dhe AKT për plotësimin e pozicioneve vakant të punës (Drejtorit të Përgjithshëm të Turizmit, Drejtorit të Drejtorisë së Projekteve dhe Kryetar të Degëve Territoriale në MTM, Drejtorit të Drejtorisë së Projekteve dhe Zonave me Prioritet Zhvillimin e Turizmit në AKT, etj), për rreth 1.5-2 vite, si dhe ngritjes dhe funksionimit të grupit tematik, me detyrë monitorimin e zbatimit të SKT 2019-2023, ka sjell dobësimin e kontrollit dhe monitorimit në të gjithë hierarkinë institucionale, ngarkesë të shtuar për punonjësit aktual, rritjen e riskut për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektivave, si dhe në gjykimin e grupit të auditimit, kjo situatë e krijuar, ka ndikuar negativisht në funksionimin me eficiencë të strukturave të dy institucioneve të mësipërme.

2. Hartimi i përshkrimeve të pozicioneve të punës për punonjësit e MTM dhe AKT, jo sipas përcaktimeve ligjore të bëra në Udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike nr.01, datë 31.05.2017⁵⁸, konkretisht të arsimit të kërkuar me funksionet dhe natyrën e punës që kryhet në pozicionin e punës, ka sjell rekrutime të burimeve njerëzore jo me formimin e duhur arsimor (për shëmbull Drejtori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit, është i diplomuar për gjeologji-naftë, Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AKT, pra Nëpunësi Zbatues, është i diplomuar për drejtim të fermave dhe agrobiznesit, etj), ç'ka në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht në cilësinë dhe saktësinë e detyrave institucionale.

3. Kryerja e një numri të ulët ditësh trajnimi, 7-8 ditë trajnimi/punonjës për secilin institucion, MTM dhe AKT, por edhe të përfshirjes së stafit në trajnime, rreth 17% - 20% të punonjësve janë trajnuar, tregon mungesë të theksuar të politikave dhe masave të marra, për zhvillimin dhe forcimin e njohurive të burimeve njerëzore, ç'ka në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht në eficiencën dhe efektivitetin e cilësisë së aktivitetit institucional.

4. Pësia e ulët në numër por edhe në vlerë financimi (**3 projekte në vlerën 9,649,925 lekë, ose 17% të fondeve gjithsej**), të projekteve me fokus turizmin malor, në krahasim me peshën në numër dhe në vlerë të projekteve me fokus turizmin historiko-kulturor (**6 projekte në vlerën**

⁵⁷ Ligji nr.93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, neni 20;

⁵⁸ "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".



22,310,210 lekë ose 39% të fondeve gjithsej), financuar nga MTM përgjatë periudhës 2019-2020, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon se, zhvillimi i turizmit malor, nuk është prioritet për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

5. Gjithashtu, nga alokimi i fondeve **më tepër** për realizimin e objektivit strategjik **"Promovimi i turizmit"**, në vlerën 704,200 mijë lekë ose **38% e kostos** gjithsej të SKT 2019-2023, në krahasim me fondet e alokuara në vlerën 219,450 mijë lekë ose **12% totalit**, për realizimin e objektivit **"Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike"**, pjesë e të cilit është zhvillimi për programin e turizmit natyror, ku përfshihet edhe **turizmi malor** (i cili zë **2% të kostos totale** të financimit të SKT 2019-2023), grupi i auditimit krijon bindjen e arsyeshme, se MTM, i ka kushtuar **më tepër rëndësi promovimit të turizmit**, se sa krijimit dhe zhvillimit të produkteve turistike në tërësi dhe atij malor në veçanti.

6. Mungesa e hartimit dhe miratimit të Planit Kombëtar të Turizmit, si dhe planeve të zhvillimit dhe veprimit për disa nga zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si ajo e Malit të Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshatë-Krastë; Vargmalit të Moravës; Parkut Kombëtar të Llogarasë, tregon dobësi në realizimin e detyrimeve ligjore, si dhe në gjykimin e grupit të auditimit, është bërë faktor pengues në identifikimin, vlerësimin, klasifikimin dhe zhvillimin e burimeve turistike të disponueshme në këto zona, si dhe zhvillimin e infrastrukturës së përgjithshme turistike dhe të shërbimeve publike (energji, ujësjellës, internet, etj).

7. Mosfunksionimi i Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit, sipas përcaktimeve ligjore të bëra në nenin 7 të Ligjit nr.90/2012⁵⁹ dhe në Urdhrin nr.8657, datë 28.10.2016⁶⁰, pra mospozicionimi i tyre në çdo Qark të RSH-së, si dhe mungesa e kryerjes së disa funksioneve, si organizimi i seminareve, konferencave, këshillimeve të sipërmarrjeve turistike me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit turistik të ofruar, si dhe koordinimit të politikave të zhvillimit të turizmit ndërmjet MTM-së dhe institucioneve të qeverisjes vendore, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon eficiencë të ulët në kryerjen e detyrave, dhe cenon realizimin e misionit/qëllimit, për të cilin janë krijuar Degët Territoriale (të shërbyerit si ndërmjetës të bashkëpunimit, koordinimit midis nivelit qendror-vendor, për politikën e zhvillimit të turizmit).

8. Edhe pse kanë kaluar 5 vite nga miratimi i Ligjit, ende nuk është publikuar dhe finalizuar regjistri qendror i turizmit, i cili duhet të listojë në mënyrë të konsoliduar veprimtaritë në fushën e turizmit, ç'ka do të thotë se, MTM nuk ka një shifër të saktë të numrit të strukturave akomoduese, numrit të shtretërve për turist, e për pasojë edhe objektivat cilësor dhe sasior të vendosur për formalizimin e sektorit, kategorizimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese, në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë real dhe mund të ndikojnë negativisht në masat e marra për realizimin e tyre.

9. Ecja me ritme të ngadalta e procesit të kategorizimit të strukturave akomoduese, për të vijuar më pas me klasifikimin e tyre, në gjykimin e grupit të auditimit ka krijuar një situatë të çrregullt në treg, sidomos për hotelet, pasi disa struktura të akomodimit përdorin shenja dalluese (yje) të klasifikimit, të cilat nuk përputhen me standardet reale të strukturës apo nivelit të shërbimit, që ato ofrojnë. Gjithashtu mungesa e klasifikimit të strukturave të akomodimit, krijon konfuzion/hapësirë për abuzim, në praktikë për "taksën e fjetjes në hotel", e cila përcaktohet sipas shenjave dalluese (yjeve) dhe kategorisë së bashkisë⁶¹. Pra hotelet me 4 dhe 5 yje në Tiranë dhe Durrës e kanë taksën 350 lekë natë-fjetje/person, ndërsa për pjesën tjetër të strukturave të akomodimit është 140 lekë, si dhe duke marrë në konsideratë që kategorizimi dhe klasifikimi i strukturave akomoduese s'ka përfunduar në masë të madhe, zbatimi në praktikë i taksës vendore mund të vendoset në mënyrë preferenciale nga autoritetet lokale.

10. Mungesa e raportimit të statistikave me të dhënat e turistëve, shtetësinë, destinacionet e vizituara, rezidencën, gjininë, moshën, ditët/netët e qëndrimit, nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë, dhe strukturat akomoduese, si dhe mosmarrja e masave ndëshkuese ndaj tyre, nga MTM

⁵⁹ Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore.

⁶⁰ Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit.

⁶¹ Ligji nr.9632, datë 30.10.2016 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar).



përgjatë periudhës 2019-2020, tregon moszbatim të Ligjit të Turizmit, mungesë kontrolli, dhe në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar në saktësinë dhe plotësinë e statistikave në turizëm.

11. Marrja pjesë në Paniret Ndërkombëtare/Kombëtare të Turizmit, në kushtet kur kjo mënyrë promovimi nuk është e përcaktuar në VKM nr.298, datë 20.04.2016⁶², si dhe zhvillimi i tyre në mungesë të një procedure ligjore të miratuar nga Ministri përgjegjës për turizmin, në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht në economicitetin e fondeve buxhetore, eficiencën e promovimit dhe efektivitetin e tij, pasi:

- Janë rritur kostot financiare të AKT, e cila veç shpenzimeve për stafin e saj, ka mbuluar edhe shpenzimet e pjesëmarrjes së subjekteve private në këto panire, **57,758,931 lekë** shpenzuar gjithsej, ose 45% të shpenzimeve operative për 2019-2020, **detyrim ky që nuk është i përcaktuar në asnjë akt ligjor apo nëligjor, pra që me fondet e buxhetit të shtetit**, të përballohen shpenzimet e subjekteve private në paniret ndërkombëtare, ndërkohë që në shtete të tjera si Kroacia apo Sllovenia, shpenzimet për pjesëmarrjen në panire, përballohen nga të dyja palët në raportin 60% me 40%, ose 50% me 50%;
- Nuk janë përcaktuar indikatorët/treguesit, mbi të cilët vlerësohet dobishmëria/efekti në turizmin shqiptar, i fondeve të shpenzuara për një panair (rritje e numrit të turistëve nga shteti ku u krye panairi, të kontratave të lidhura ndërmjet operatorëve/agjencive turistike shqiptare, të vizitorëve në stendën e AKT-së, etj);
- Për përcaktimin e kriterëve kualifikuese për pjesëmarrjen në panair, nuk ka patur një analizë të detajuar ndërmjet AKT dhe MTM, por ato kanë qenë produkt i disa takimeve të AKT me subjektet private (operator dhe agjenci turistike).

12. Gjithashtu moskryerja e një studimi për monitorimin e tregut, mbi prirjet dhe preferencat e konsumatorëve, se çfarë ata kërkojnë nga turizmi në tërësi dhe ai malor në veçanti (pra nëse turizmi detar pëlqehet më tepër se ai malor, atëherë edhe burimet e institucionit duhen angazhuar drejt turizmit malor, me qëllim që edhe ky të zhvillohet), ka sjellë që AKT të marrë pjesë në panire të përgjithshme të turizmit, dhe jo sipas tematikës së tyre, ç'ka në gjykimin e grupit të auditimit ka ndikuar negativisht në eficiencën dhe efektivitetin e burimeve njerëzore dhe financiare të përdorura, si dhe në promovimin e turizmit malor.

13. Përdorimi pa economicitetin e rreth **4,851,558 lekë** shpenzime (stenda, transport, hotel, kursi i këmbimit, etj) në 4 Panire Ndërkombëtare të Turizmit, mosadministrimit në disa raste të:

- Procesverbaleve të shpalljes së fituesve dhe njoftimeve të tyre;
- Deklaratave të ekzistencës/mosekzistencës së konfliktit të interesit, të anëtarëve të grupit, që ka bërë vlerësimin e aplikimeve deri në shpalljen e fituesve⁶³;
- Dokumenteve të dorëzuara nga subjektet që kanë aplikuar për të marrë pjesë në panair (vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë 3 viteve të fundit, kopje të materialeve promocionale të prodhuara nga operatori turistik, listëpagesat e 6 muajve të fundit);
- Procesverbaleve mbi marrjen në dorëzim të stendës sipas specifikimeve të kontraktuara;
- Raporteve të monitorimit të operatorëve/agjencive turistike, mbi sjelljen, komunikimin dhe qëndrimin e tyre në panair;
- Akt-marrëveshjeve të lidhura AKT-subjekt pjesëmarrës në panair;
- Komunikimeve zyrtare të AKT-së me arreduesin e stendës, ofertës dhe specifikimeve të nënshkruara nga Titullari i institucionit;
- Raporteve përmbledhës të subjekteve pjesëmarrës në panair (mbi numrin e kontratave që ka lidhur në panair, numrin e turistëve që kanë blerë paketë turistike nga ky panair, të ardhurat e realizuara), si dhe mungesa e nxjerrjes së urdhrave të brendshëm, për sigurimin e hoteleve me kosto sa më të ulët⁶⁴, e respektimit të kriterit të përcaktuar për numrin e pjesëmarrësve (operator/agjenci turistike) sipas sipërfaqes së marrë me qera në panair dhe shpallja fitues e disa subjekteve, që nuk kanë qenë të licencuar si agjenci/operator turistik, në gjykimin e grupit të

⁶² Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së.

⁶³ Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

⁶⁴ VKM nr.870, datë 14.02.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".



auditimit, tregon mungesë efieciencë në ushtrimin e detyrave institucionale, duke ndikuar negativisht në funksionin e promovimit.

14. Mangësitë në databasën e destinacioneve turistike (mbi numrin e tyre) të administruar nga AKT, si dhe mungesa e kryrjes së aktiviteteve, përgatitjes dhe zbatimit të programit, për vendosjen e materialeve/sinjalistikës informuese dhe promovuese, në destinacionet turistike malore, si dhe pranë pikave kufitare dhe përfaqësive diplomatike shqiptare, në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht në informimin e turistëve, promovimin dhe zhvillimin e turizmit malor përgjatë sezonit turistik 2019⁶⁵.

15. Funksionimi i KRZHT Vlorë dhe Korçë përgjatë periudhës 2019-2020, si një grup Task-Force për menaxhimin e sezonit turistik, pra jo i plotë dhe sipas përcaktimeve ligjore të bëra në Udhëzimin nr.8502, datë 24.10.2016⁶⁶, në gjykimin e grupit të auditimit, mund të ndikojë negativisht në bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe njësisive të qeverisjes vendore, për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave që krijohen nga zbatimi i politikës kombëtare të turizmit, si dhe të problematikave që lidhen apo krijohen nga veprimtaritë turistike.

Rekomandime:

13) MTM dhe AKT të marrin masat e nevojshme për plotësimin e pozicioneve vakant të punës, për përcaktimin e kërkesave specifike të arsimit të kërkuar (grupi i auditimit sugjeron që mbi 50% e strukturës të jetë arsimuar në Marketing, Administrim Biznes, Turizëm) duke siguruar përpunjen me natyrën dhe llojin e funksionit që kryhet në pozicionin përkatës, si dhe ngritjen dhe funksionimin e grupit tematik për monitorimin e zbatimit të SKT 2019-2023. Gjithashtu për çdo vit të përgatitet programi i trajnimit të burimeve njerëzore, duke vendosur një numër ditësh maksimum për çdo punonjës.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

14) MTM të marrë masat e nevojshme që fondi i planifikuar për financimin e projekteve në masën 50% të vlerës së tyre, të ndahet në mënyrë të barabartë për të tre llojet e turizmit bregdetar, natyror dhe tematik. Gjithashtu të rishikohet fondi i planifikuar për realizimin e objektivit strategjik **"Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike"** dhe objektivit **"Përmirësimi i Shërbimeve Turistike"**, të cilët duhet të zënë peshën kryesore të financimit, për të vijuar më pas me objektivin **"Promovimi i turizmit"**.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

15) MTM të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Turizmit, si dhe planeve të zhvillimit dhe veprimit për disa nga zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si ajo e Malit të Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshatamë-Krastë; Vargmalit të Moravës, etj.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

16) MTM të marrë masat e nevojshme që Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit, të pozicionohen me zyra pranë prefekturave, si dhe të sigurojë funksionimin e plotë të tyre për organizimin e seminareve, konferencave, këshillimeve të sipërmarrjeve turistike me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit turistik të ofruar.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

17) MTM të marrë masat e nevojshme për përgatitjen dhe publikimin e regjistrit qendror të turizmit, me informacion të përditësuar. Gjithashtu të ngrejë një grup pune me Inspektoratin që mbulon fushën e turizmit, për të evidentuar të gjitha strukturat akomoduese, që nuk janë pajisur me certifikatën e kategorizimit, me qëllim plotësimin e këtij detyrimi ligjor brenda një afati të caktuar dhe për të vijuar më pas me klasifikimin e tyre.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

⁶⁵ Urdhrit nr.65, datë 01.04.2019 të Kryeministrit, "Për planin e masave për sezonin turistik, viti 2019".

⁶⁶ Udhëzim i Ministrit përgjegjës për turizmin nr.8502, datë 24.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit".



18) MTM të marrë masat e nevojshme për të identifikuar të gjitha agjencitë dhe operatorët turistik, si dhe strukturat akomoduese, të cilat nuk kanë respektuar detyrimin ligjor, të raportimit të të dhënave statistikore për periudhën 2019-2020, duke i njoftuar për dorëzimin e tyre, si dhe ndëshkimin në rast të refuzimit të zbatimit të ligjit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

19) MTM në bashkëpunim me AKT, të marrin masat e nevojshme për përcaktimin në VKM nr.298, datë 20.04.2016⁶⁷, të pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare dhe kombëtare si një mjet promovimi. Gjithashtu në vijim të këtij përcaktimi, Ministri përgjegjës për turizmin nëpërmjet një akti nënligjor, të miratojë procedurën e organizimit të panairëve (nga faza e planifikimit të panairëve ku do të merret pjesë deri në zhvillimin e tij), duke përcaktuar detyrimet për të dyja palët (AKT dhe subjektet pjesëmarrës në panair) për financimin, sjelljen dhe raportimin e të dhënave statistikore, si dhe të përcaktohet si kriter s'kualifikues për të marrë pjesë në panairin e rradhës, rasti kur subjekti nuk respekton detyrimet e përbashkëta.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

20) AKT të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e një studimi, me qëllim vlerësimin e prirjeve dhe preferencave të turistëve të huaj, për llojin e turizmit në Shqipëri, përgjatë 5-vjeçarit të kaluar, si një mënyrë që të shërbejë për pjesëmarrjen në panairë tematike të turizmit. Ky studim të pasurohet çdo vit me të dhënat statistikore, me qëllim që ai të shërbejë edhe si një mjet vlerësimi, i aktiviteteve të AKT-së për promovimin e turizmit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

21) AKT të parashikojë në planet vjetore të punës, kryerjen e aktiviteteve me fokus turizmin malor, në bashkëpunim me institucione publike dhe jopublike, me qëllim promovimin e këtij turizmi.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

22) AKT të ngrejë një grup pune, me qëllim plotësimin dhe përditësimin me destinacione turistike (malore, historike, kulturore, detare dhe bregdetare), të databazës përkatëse, si dhe të materialeve, fletë-palosjeve dhe broshurave që japin informacion për këto destinacione, duke bashkëpunuar me subjektet publike dhe jopublike, që kanë në administrim destinacione turistike. Në rast të refuzimit të mbështetjes nga subjektet e mësipërme, AKT të njoftojë institucionin epror të saj, si dhe atje ku është e mundur, njoftimin e institucionit epror të subjekteve përkatëse.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

23) AKT të nxjerrë një urdhër të brendshëm, për përcaktimin e procedurave, për veprimet në valutë të huaj, sigurimin e hoteleve me kosto të ulët, si dhe reduktimin e shpenzimeve të panevojshme për transportin e stafit të saj, gjatë pjesëmarrjes në panairët dhe trajnimet jashtë vendit, me qëllim eliminimin e përdorimit pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve buxhetore, alokuar për këto aktivitete, alokuar për këto aktivitete.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

24) MTM në bashkëpunim me Prefektet e 12 Qarqeve në RSH, në rolin e Kryetarëve të Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit, të marrin masat e nevojshme për funksionimin e plotë të kësaj strukture dhe sipas qëllimit për të cilin janë krijuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1.4. A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstytucional, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

Nga dokumentacioni paraprak i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nga MTM, si dhe AKT me shkresën nr.265/1, datë 27.05.2021, përgjatë periudhës 2019-2020, nga Ministria përgjegjëse për turizmin si dhe Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit, rezulton se:

⁶⁷ Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së.



Gjetje:

Ka munguar bashkëpunimi me:

- 25) Federata/shoqata të ndryshme sportive, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e veprimtarive sportive që zhvillohen në natyrë, kryesisht në zonat malore (hedhje me parashutë, çiklizmi malor, etj), me qëllim tërheqjen e turistëve në zonat malore;
- 26) Federatën Shqiptare të Alpinizmit, me qëllim identifikimin e vendndodhjeve për zhvillimin e alpinizmit, si një objektiv strategjik i përcaktuar, për zhvillimin e turizmit të natyrës;
- 27) AKT për hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare e Marketingut për sektorin e turizmit;
- 28) Gjithashtu midis këtyre dy institucioneve, ka munguar bashkëpunimi për ngritjen e portalit shqiptar të turizmit “e-turizëm”, i cili lidhet me aplikacione që ofrojnë informacion mbi destinacionet e atraksionet turistike;
- 29) Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për përgatitjen e planit të masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore, krijimin e skuadrave të shpëtimit;
- 30) Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për krijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore, me qëllim rritjen e sezonit turistik;
- 31) NJVQV-të, me qëllim përgatitjen dhe zbatimin e një programi trajnimi të burimeve njerëzore që janë të angazhuara në sektorin e turizmit;
- 32) NJVQV-të, si dhe me aktorë të tjerë që kanë në administrim burime turistike, me qëllim përditësimin e regjistrit të burimeve turistike, ku theksojmë se në këtë regjistër, nuk ka asnjë shteg malor të pasqyruar, megjithëse është edhe objektiv strategjik ndërtimi, shënjimi dhe dixhitalizimi i tyre; Vetëm nga informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nga Prefektura Vlorë, janë rreth 17 shtigje malore, të cilat nuk pasqyrohen si destinacione turistike në regjistrin e burimeve turistike;
- 33) NJVQV-të për raportimin e të dhënave statistikore të turizmit;
- 34) Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për përgatitjen e një plan-veprimi, me qëllim përcaktimin e masave konkrete, afateve, strukturave përgjegjëse, për reduktimin e nivelit të informalitetit në sektorin e turizmit;
- 35) Ministrinë e Infrastrukturës për krijimin e stacioneve të transportit turistik, i cili është detyrim ligjor dhe strategjik njëkohësisht;
- 36) Degët Teritoriale të Shërbimit të Turizmit nuk kanë patur bashkëpunime me:
 - Autoritetet vendore, për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e turistit në destinacion;
 - Bizneset turistike, për evidentimin dhe vlerësimin e nevojave për trajnime;
 - Komitetet Rajonale të Zhvillimit të Turizmit, për zbatimin e politikës për zhvillimin e produktit turistik malor;
- 37) Theksojmë se bashkëpunimi ndërinstitucional i AKT-së, përgjatë periudhës 2019-2020, në kuadër të zbatimit edhe të Urdhrave të Kryeministrit, për menaxhimin e sezonit turistik 2019 dhe 2020, kryesisht ka qenë vetëm në shkëmbimin e informacionit mbi mbarëvajtjen e sezonit turistik. AKT përgjatë kësaj periudhe ka dërguar disa shkresa për bashkëpunim, drejtuar Bashkive, Ministrisë së Kulturës, Autoritetit Rrugor, Ministrisë së Jashtme, por që kanë ngelur në letër, pa u konkretizuar me veprime konkrete, me përjashtim të rasteve sporadike. Nga ky komunikim shkresor, **vihet re një nivel i ulët bashkëpunimi**, ku mjafton të përmendim, komunikimin e AKT me 61 Bashkitë, në fillim të sezonit turistik të vitit 2019 (me qëllim zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, ose promovimin e festave lokale), ku kësaj shkrese i janë përgjigjur vetëm 5 Bashki (Korça, Pogradeci, Devolli, Roskoveci, Puka).
- 38) Gjithashtu për vitin 2020, në kuadër të Urdhërit të Kryeministrit nr.158, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, nga informacioni që kanë raportuar në AKT, 10 Bashki (Tropoja, Shkodra, Mati, Lezha, Kruja, Pogradeci, Fieri, Dropulli dhe Saranda), mbi problematikat përgjatë sezonit turistik 2020, **(përcjellë nga kjo e fundit në Ministrinë e Turizmit, e cila nuk ka marrë masa për zgjidhjen e tyre)**, vlenë të përmenden disa, si vijon:
Bashkia Lezhë – Informaliteti vijon të mbetet shqetësim dhe krijon konkurrencë të pandershme



(Hotelet janë të regjistruar dhe i paguajnë detyrimet fiskale, por është një numër i lartë apartamentesh, që ofrojnë akomodim për turistët, të cilat nuk paguajnë asnjë detyrim);

-Mungesa e tabelave informuese për destinacionet turistike dhe largësinë e tyre;

Bashkia Shkodër – Punimet në rrugën për në Theth, kanë krijuar vonesa dhe anulimin e udhëtimeve;

-Mungesa e mbështetjes financiare përgjatë periudhës së Pandemis, për subjektet që operojnë në sektorin e turizmit;

Bashkia Mat – Mungesa e investimeve në përmirësimin e sinjalistikës turistike për monumente të kulturës dhe destinacione të natyrës, zonave të mbrojtura;

-Mungesë e investimeve në krijimin e hapësirave për kampingje verore dhe dimërore, hapjen e shtigjeve malore;

-Mungesë e materialeve informuese për turizmin në zyrën e informacionit turistik.

Bashkia Krujë – Infrastruktura rrugore;

-Amortizimi i rrugës Krujë-Qafshtamë, i cili pengoi zhvillimin e turizmit dimëror;

-Mungesa e zyrës së informacionit turistik.

Konkluzione:

1.Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional (horizontalisht dhe vertikalisht) ndërmjet MTM-së dhe Institucioneve të tjera (MASR, MFE, MEI, MSHMS, AKT, NJVQV), si dhe grupeve të interesit (Federata/shoqata të ndryshme sportive, si Alpinizmi, Aeronautika, Çiklizmi, etj), për:

- Përgatitjen e planit të masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore;
- Lrijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore;
- Krijimin e stacioneve të transportit turistik;
- Përgatitjen dhe zbatimin e një programi trajnimi të burimeve njerëzore që janë të angazhuara në sektorin e turizmit;
- Përditësimin e regjistrit të burimeve turistike dhe të dhënave statistikore në sektorin e turizmit;
- Identifikimin, mbështetjen dhe zhvillimin e veprimtarive sportive (alpinizmi, hedhja me parashutë, çiklizmi malor), që zhvillohen në natyrë, kryesisht në zonat malore;
- Hapjen dhe vënien në funksion të zyrave të informimit të turistëve, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon për dobësi në realizimin e detyrimeve ligjore dhe strategjike dhe mungesë koordinimi, si dhe për pasojë sjell infrastrukturë mbështetëse të dobët për ofruesit dhe përfituesit e shërbimit turistik, mungesë të alternativave argëtuese në turizmin malor, ndikon negativisht në promovimin e produkteve turistike, në hartimin e planeve dhe përcaktimin e objektivave real për zhvillimin e produktit turistik dhe në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të turizmit malor.

▪ Ky konkluzion mbështetet edhe nga përgjigjet e dhëna në pyetësorin drejtuar operatorëve/agjencive turistike, mbi mbështetjen e dhënë për përbashkëtimin e humbjeve dhe shpenzimeve financiare si pasojë e Pandemisë COVID-19, pasqyruar në Kapitullin "Aneksë".

Rekomandime:

1.MTM dhe AKT të fuqizojnë nivelin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke ndërmarrë dhe konkretizuar aktivitete të përbashkëta, që të kenë si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor.

Në vijimësi

1.2.A ka ndikuar veprimtaria e FSHALT në zhvillimin e turizmit malor?

Për të vlerësuar nëse veprimtaria e FSHALT, përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2020, ka patur ndikim në zhvillimin e turizmit malor, grupi i auditimit përdori kritere audituese, të cilat burimin e tyre kishin nga dokumente rregullatore dhe operacionale.

Sa më sipër, nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga FSHALT, grupi i auditimit, **arriti në konkluzionin e përgjithshëm**, se:

“Veprimtaria e FSHALT, përgjatë periudhës nën auditim 2019-2020, nuk ka patur ndikim në zhvillimin e turizmit malor, për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve buxhetore të akorduara për



FSHALT, ç'ka në gjykimin e grupit të auditimit, jo vetëm që nuk ka siguruar kushtet minimale për funksionimin e plotë të Federatës, por ka ndikuar negativisht edhe në aktivitetin në tërësi të kësaj Federate, pasi është ulur numri i aktiviteteve vjetore, numri i sportistëve që marrin pjesë në aktivitete, për shkak të pamundësisë së pagesës së trajtimit ushqimor, nuk është marrë pjesë në asnjë aktivitet ndërkombëtar, nuk është krijuar mundësia në hapjen e shtigjeve malore apo të shtigjeve për kacaverje, si dhe të mungesës së bashkëpunimit për promovimin e aktiviteteve të kryera".

1.2.1.A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga Federata Shqiptare e Turizmit dhe Alpinizmit Malor dhe a janë përdorur siç duhet ato?

Zhvillimi i turizmit malor në Shqipëri përgjatë viteve të fundit, në gjykimin e grupit të auditimit është i lidhur pazgjidhmërisht me zhvillimin e sporteve malore, për arsye se një pjesë e mirë e këtyre sporteve që zhvillohen në zona malore, shërbejnë për të promovuar peisazhet e bukura të Shqipërisë, si dhe njëkohësisht tërheqjen e sa më shumë vizitorëve dhe sportistëve profesionist apo amator.

Menjëherë pas viteve 90 u krijua një kaos përsa i përket zhvillimit shoqëror e ekonomik të shoqërisë shqiptare dhe si rrjedhojë dhe zhvillimit kulturor e sportiv. Pak sporte mbijetuan mes shumë vështirësive ekonomike e përshtatjeve ligjore. Sportet e tjera filluan të riorganizohen për afro 10 vite, por në vitet 2000 arritën të rikuperoheshin mjaft sporte të grupuara në shoqëri sportive, klube dhe të futura ose jo në ombrellat e Federatave respektive. Një ndër sportet që arriti të mbijetojë dhe të rigrupohet ishte dhe Alpinizmi, i cili ishte përfshirë në Federatën Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor. Ky sport, i cili është pjesë e turizmit malor, ka disa disiplina, si ngjitja dimërore, ecja turistike, ecja malore dhe kacavjerje (në shkëmbinj/mure artificialë). Aktualisht Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor ka 21 anëtar (shoqata dhe klube sportive), të përqendruara kryesisht në Tiranë (9 prej tyre), Vlorë (1), Elbasan (1), Peshkopi (1), Krujë (1), Kukës (1), Pukë (1), Shkodër (1), Gjirokastrë (1), Bajram Curri (1), Berat (1) dhe Përmet (1), si dhe 100 sportist (alpinist) të licencuar.

Që ky sport të ushtrohet në kushte optimale dhe që të shërbejë për promovimin e turizmit malor, ka nevojë për pajisje (veshje, mjete të ndryshme, si kazma alpine, kthetra), por mbi të gjitha infrastrukturë, si shtigje malore, shtigje për kacavjerje, si dhe bashkëpunim me institucionet publike, pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, etj. Që të gjitha sa përmendëm më sipër kanë nevojë për mbështetje financiare, por kjo nuk duhet kuptuar vetëm fonde nga buxheti i shtetit, por edhe vetë Federata të aplikojë në projekte të ndryshme, për të siguruar fonde financiare.

Aktualisht në Shqipëri ka më shumë se 80 rrugë për alpinizëm, me mundësi për shumë të tjera shtesë. Megjithatë, krijimi i rrugëve të reja ka qenë disi i kufizuar, kjo për arsyen kryesore të mungesës së fondeve.

Sipas informacionit të vënë në dispozicion, rezulton se për të krijuar një rrugë të re për alpinizëm, duhen materiale si bulona dhe spiranca prej çeliku (inoks) dhe pajisje sigurie, vlera e të cilave shkon rreth 150 euro. Gjithashtu që një alpinist të ushtrojë sportin në nivele optimale, i nevojitet litar, çantë, helmet, këpucë, kthetra, kazëm alpine, etj. Nga vlerësimi që bëri grupi i auditimit (pasqyruar në tabelat e mëposhtme), rezulton se kosto mesatare për një sportist që të ketë pajisjet e nevojshme, është 200,000 lekë, dhe për 100 sportist të licencuar do të duheshin 20,000,000 lekë.

Tabela nr.14 Kosto e pajisjeve sportive për një alpinist

Nr	Pajisje për ngjitje shkëmbore	Kosto (Lekë)
1	Litar	20,000
2	Çelsa dysh (10 cope)	20,000
3	Këpucë për ngjitje	10,000
4	Pajisje për sigurimin Gri Gri	10,000
5	Çantë për ngjitje	10,000
6	Helmet	5,000
7	Shalurë	5,000



8	Çelsa të thjeshta (2 cope)	5,000
Total		85,000

Nr	Pajisje për ngjitje dimërore	Kosto (Lekë)
1	Këpucë dëbore	25,000
2	Litar	20,000
3	Çantë shpine	15,000
4	Kthetra	10,000
5	Kazëm alpine	10,000
6	Xhup dëbore	10,000
7	Pantallona dëbore	5,000
8	Helmet	5,000
9	Kambale	5,000
10	Syze dëbore	5,000
11	Shalurë	5,000
Total		115,000

Burimi: FSHALT, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

-Ndërkohë që fondi-grand vjetor i akorduar nga buxheti i shtetit (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë - MASR) Federatës, është **700,000 lekë**, pra për të pajisur një alpinist, FSHALT-së i duhet rreth 30% e fondit të buxhetit, ose me këtë fond mund të sigurohen pajisjet për 3 sportist në vit. Nëse do merrnim në konsideratë që kjo Federatë ka rreth 100 sportist të licencuar, si dhe me këtë fond të akorduar, do të duheshin rreth 30 vite për pajisjen e tyre me materialet sportive.

Për vitin **2019** FSHALT me shkresën nr.141, datë 28.09.2018, drejtuar MASR, me qëllim zhvillimin normal të aktivitetit të saj, **ka kërkuar mbështetje financiare** në vlerën 3,661,000 lekë, **ndërkohë që i janë akorduar** vetëm 700,000 lekë, ose 80% më pak se sa fond ka kërkuar. Po kështu rezultoi edhe për vitin **2020**, ku FSHALT, **ka kërkuar mbështetje financiare** në vlerën 3,370,480 lekë **dhe i janë akorduar përsëri** 700,000 lekë. Theksojmë se fondi i akorduar kësaj Federatë ka ardhur në rënie të konsiderueshme nga viti 2017-2020 (2,200,000 lekë për vitin 2017 në 700,000 lekë për vitin 2020, ose 1,500,000 lekë më pak), pasqyruar si më poshtë, vetëm për zërat më të rëndësishëm:

Tabela nr.15 Buxheti i FSHALT 2017-2020

Buxheti 2017		Buxheti 2018		Buxheti 2019		Buxheti 2020	
2,200,000		2,000,000		699,947		700,000	
<i>I cili ndahet në</i>		<i>I cili ndahet në</i>		<i>I cili ndahet në</i>		<i>I cili ndahet në</i>	
Paga	783,504	Paga	792,576	Paga	236,344	Paga	287,028
Mirëmbajtje e faqes zyrtare	36,000	Dieta brenda vendit	613,146	Dieta brenda vendit	41,220	Faqe interneti	25,000
Dieta jashtë vendit	80,500	Mirëmbajtje e faqes zyrtare	36,000	Biletë avioni	29,984	Dieta brenda vendit	25,960
Dieta brenda vendit	716,246	Dieta jashtë vendit	57,730				
Bileta avioni	89,419	Bileta avioni	68,640				
Kupa fituese	20,800						

Burimi: FSHALT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga tabela e mësipërme, rezultoi se fondi për pagat është reduktuar më tepër se 1/2 në krahasim me vitin 2017;

-Po kështu edhe dietat/trajtimi ushqimor për aktivitetet brenda vendit, ç'ka tregon ulje të numrit të aktiviteteve si dhe të sportistëve pjesëmarrës njëkohësisht;

FSHALT në dy kërkesat për mbështetjen financiare, ka bërë edhe preventivin për çdo shpenzim të saj, ku më të rëndësishmit janë aktivitetet vjetore të saj:

-Ngjitja dimërore në Valbonë – Trajtim ushqimor për 70 alpinistë * 3 ditë * 2,000 lekë + Dieta për dy punonjës të Federatës * 3 ditë * 2,500 lekë = 435,000 lekë;

-Ngjitja në murin alpin – (Trajtim ushqimor për 40 alpinistë * 2 ditë * 2,000 lekë) + (Blerje Kupash 5 cope * 2,500 lekë) + (Diploma/certifikata 20 cope * 100 lekë) + (Banderolë për aktivitetin 6,000 lekë) + (Poster 20 cope * 200 lekë) = 184,500 lekë;



-Takimi i Unionit Ballkanik në Llogara, ku organizatore e këtij aktiviteti është Shqipëria dhe të ftuar janë nga Kosova, Maqedonia, Greqia, Bullgaria, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Serbia, Sllovenia, Turqia dhe përfaqësues të Bashkimit Ndërkombëtar të Shoqërive Alpinistike (UIAA)⁶⁸ – Akomodim, Çanta me logon e Federatës dhe Ministrisë, Stilolapsa, Flamuj, Bluze me logon e Federatës, Botime të posterave dhe broshurave me aktivitete të alpinizmit dhe turizmit malor, si dhe shpenzime për udhëtim = 1,300,000 lekë;

-Ngjitje të kualifikuara shkëmbore gjatë stinës së verës – 208,000 lekë;

-Pjesëmarrja në Asambleenë Botërore të Federatave Alpinistike – Dietë, akomodim dhe udhëtim për 1 punonjës = 163,150 lekë;

-Pjesëmarrja në Konferencën e Unionit European Alpinistik – Dieta, akomodim dhe udhëtim për 2 punonjës = 149,500 lekë;

-Pra gjithësej për **6 aktivitete përgjatë vitit 2019**, pa përfshirë pagat për Sekretarin e Përgjithshëm (1,148,196 lekë) + Taksa vendore (15,000 lekë) + Internet (35,000 lekë) + Kancelari (25,000 lekë), FSHALT i janë dashur rreth **2,440,150 lekë**, ndërkohë që i akordohen vetëm **700,000 lekë**, të cilat **nuk mjaftojnë as për pagën e 1 punonjësi, dhe jo për më tepër.**

-Theksojmë se kjo situatë, është përsëritur edhe në vitin 2020, ndërkohë që në Shqipëri ka Federata të tjera sportive, të cilat janë krijuar më vonë se FSHALT, kanë disa herë më pak aktivitet, dhe që për më tepër, nuk kanë asnjë faqe zyrtare (ku të japin informacion), **por marrin më shumë fonde nga buxheti i shtetit**, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.16 Grandi i shpërndarë nga MASR për Federatat në Shqipëri

Viti 2020			
Nr	Federata	Fondi-Grand	Pesha %
1	Basketbolli	13,000,000	13%
2	Atletika	11,500,000	12%
3	Volejbolli	11,000,000	11%
4	Peshëngritja	11,000,000	11%
5	Çiklizimi	10,000,000	10%
6	Boksi	7,000,000	7%
7	Mundja	7,000,000	7%
8	Noti	4,000,000	4%
9	Judo	3,500,000	4%
10	Taekwendo	3,000,000	3%
11	Sporti Universitar	3,000,000	3%
12	Shahu	2,500,000	3%
13	Gjymnastika	2,500,000	3%
14	Karate	2,000,000	2%
15	Qitja	1,500,000	2%
16	Ping Pongu	1,500,000	2%
17	Sporti Shkollor	1,000,000	1%
18	Motoçiklizmi	1,000,000	1%
19	Alpinizmi dhe Turizmi Malor	700,000	1%
20	Skitë	500,000	1%
TOTAL		97,200,000	

Burimi: FSHALT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër rezulton se në fondin-grand të akorduar 20 Federatave sportive për vitin 2019, **FSHALT është e renditur e 19 për nga pesha**, ose 1% të totalit të këtij fondi.

Konkluzione:

1. Pamjaftueshmëria e fondeve buxhetore të akorduara për FSHALT, në gjykimin e grupit të auditimit, jo vetëm që nuk ka siguruar pajisjen me materiale sportive, por ka ndikuar negativisht

⁶⁸ Union Internationale des Association d'Alpinisme.



edhe në aktivitetin në tërësi të kësaj Federate, pasi përgjatë periudhës 2019-2020, në krahasim me 2 vite më parë:

-Është ulur numri i aktiviteteve vjetore, ku nga 6 aktivitete në vit, janë zhvilluar vetëm 2 aktivitete në dy vjet, por në vitin 2020 ka ndikuar Pandemia COVID-19, ku një aktivitet përgjatë vitit 2020, nuk u zhvillua;

-Është ulur numri i sportistëve që marrin pjesë në aktivitete, për shkak të pamundësisë së pagesës së trajtimit ushqimor, ku nga 100 sportist që merrnin pjesë në aktivitet, për vitin 2019 dhe 2020 kanë marrë pjesë rreth 40 sportist/1 aktivitet;

-Nuk është marrë pjesë në asnjë aktivitet ndërkombëtar;

-Nuk është krijuar mundësia në hapjen e shtigjeve malore apo të shtigjeve për kacaverje.

Rekomandime:

1. FSHALT gjatë planifikimit të kërkesës për fonde, të përfshijë edhe vlerën e donacioneve dhe sponsorizimeve nga të tretët, duke rritur transparencën, si dhe ofruar mundësinë MASR-së, që të vlerësoj më mirë mundësitë financiare të Federatës, dhe në këtë mënyrë, fondi i akorduar prej saj, do të jetë më tepër efektiv.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

2. FSHALT të hartojë dhe miratojë një program strategjik 3-5 vjeçar, duke përcaktuar objektivat që synon të arrijë, kostot dhe afatet e realizimit të tyre, identifikuar fuqitë, shanset dhe kërcënimet që rrezikojnë realizimin e tyre, si dhe një vlerësim mbi kontributin që mund të ofrojë Sporti i Alpinizmit në zhvillimin e turizmit malor, dhe t'ia përcjelli MASR-së dhe MTM-së për njohje, duke u bërë më konkrete në aktivitetin e saj dhe rritjen e besueshmërisë së këtij sporti, që edhe ai mund të jetë pjesë e zhvillimit të turizmit malor.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

3. FSHALT të aplikojë në projektet, që financohen në masën 50% nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të cilat kanë fokus turizmin malor, si identifikimi, projektimi dhe ndërtimi i shtigjeve malore, i zonave që shërbejnë për Alpinizëm, etj.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

1.2.2.A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?

Nga informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se:

Gjetje:

1. Përgjatë periudhës 2019-2020 FSHALT ka kryer vetëm 2 aktivitete, në të cilat kanë marrë pjesë respektivisht 20 dhe 13 sportistë, por që FSHALT nuk ka arritur të bëjë një vlerësim, nëse këto aktivitete mund të kenë patur ndikim në promovimin e turizmit malor⁶⁹;

2. Midis FSHALT si dhe Ministrisë së Turizmit apo Agjencisë Kombëtare të Turizmit, nuk ka patur asnjë aktivitet të përbashkët, me qëllim promovimin e aktiviteteve sportive në zonat malore. Theksojmë se një aktivitet i tillë (Panairi i Turizmit Malor) ndërmjet FSHALT dhe AKT, për herë të fundit, është zhvilluar në muajin Dhjetor të vitit 2013, në të cilin kanë qenë të pranishëm rreth 400 persona si dhe media ndërkombëtare.

Konkluzione:

1. Kryerja e një numri të ulët të aktiviteteve, shoqëruar nga një numër i ulët pjesëmarrësish, kryesisht sportistë të FSHALT, por jo edhe të ftuar të tjerë, duke marrë në konsideratë pamundësinë financiare për më tepër aktivitete/rritjen e numrit të pjesëmarrësve, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikon negativisht në aktivitetin e FSHALT, si dhe nuk sjell asnjë ndikim pozitiv në promovimin/zhvillimin e turizmit malor.

Rekomandime:

⁶⁹ Neni 8 i Statutit të FSHALT



1. FSHALT në bashkëpunim me MASR dhe MTM, të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin e mundësisë për krijimin e kurseve dhe trajnimin e personave që bëjnë guida alpinistike, që sot shihet si domosdoshmëri për të gjithë ata që shoqërojnë grupe turistësh në zonat malore.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

2. FSHALT të marrë masat e nevojshme, për botimin çdo 6-mujor, të një reviste/broshure dhe publikimin e saj në median elektronike dhe atë të shkruar, për prezantuar aktivitetet e saj, vendet turistike ku kryehen këto aktivitete, duke shërbyer në promovimin e turizmit malor.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

3. FSHALT të organizojë aktivitete në ditët e veçanta të njohura si dita olimpike, dita ndërkombëtare e malit etj, ku të kërkojë bashkëpunim nga Agjencia Kombëtare e Turizmit (për promovimin e tyre), si dhe nga institucionet e qeverisjes vendore, për të ofruar mbështetje financiare, në ndihmë të realizimit të këtyre aktiviteteve.

Në vijimësi

5. PËRMBLEDHJA

Auditimi i Performancës me temë "Zhvillimi i Turizmit Malor", është kryer në bazë të Programit të Auditimit nr.199/4, datë 15.04.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH-së. Nisur nga rëndësia dhe zhvillimet e sektorit të turizmit në tërësi dhe atij malor në veçanti, ku natyra shqiptare, e ka kthyer në qendër të vëmendjes turizmin malor, si për turistët vendas, por edhe të huaj, KLSH e gjykoj të nevojshme kryerjen e një auditimi performance pranë institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e turizmit malor.

Sa më sipër, subjektet që u përfshin në këtë auditim ishin, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në rolin e institucionit politikbërës në sektorin e turizmit, Agjencia Kombëtare e Turizmit, në rolin e zbatuesit të politikave shtetërore, si dhe Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor, për të bërë edhe një ndërthurje të sportit që zhvillohet kryesisht në zonat malore me turizmin e këtij lloji.

Gjatë fazës studimore, me qëllim identifikimin sa më qartë të funksioneve dhe veprimeve, të secilit prej subjekteve të mësipërme, për zhvillimin e turizmit malor, grupi i auditimit zhvilloi bashkëbisedime me punonjës të nivelit të ndryshëm në hierarkinë institucionale, si dhe bëri kërkesa për dokumentacion, të nivelit strategjik, ligjor dhe operacional. Në përfundim të kësaj faze, pas konsultimit të dokumentacionit, mbi veprimtarinë e secilit prej subjekteve, u arrit në përgatitjen e programit të auditimit. Në programin auditues, u ndërtua piramida e pyetjeve të auditimit, e cila pati si fokus, nëse kanë rezultuar efektive masat e marra nga institucionet përgjegjëse publike, për zhvillimin e turizmit malor, përgjatë periudhës 2019-2020. Me qëllim dhënien e përgjigjes pyetjes kryesore, grupi i auditimit, e detajoi atë në disa nënpyetje, të cilat u fokusuan në realizimin e objektivave strategjik të këtij sektori, plotësimin dhe përafrimin me praktikat më të mira të kuadrit rregullator, mbështetjen financiare të turizmit malor, bashkëpunimin ndërinstitucional, funksionimin e strukturave përgjegjëse, etj. Përgjatë fazës së terrenit të auditimit, për grumbullimin e dokumentacionit u hartuan disa intervista drejtuar Ministrisë përgjegjëse për turizmin, Agjencisë Kombëtare të Turizmit, si dhe Federatës Shqiptare të Alpinizmit.

Gjithashtu për përthithjen e opinionit të palëve të interesit të këtij sektori, kryesisht operatorëve dhe agjencive turistike, mbi mbështetjen e ofruar ndaj tyre nga institucionet shtetërore të këtij sektori, u përgatit pyetësori me pyetje të hapura dhe të mbyllura.

Sa më sipër, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjektet nën auditim, si dhe atij të publikuar në faqet zyrtare, opinionit të palëve të interesit, nga grupi i auditimit **në lidhje me pyetjen kryesore,**

"A kanë rezultuar efektive masat e marra nga institucionet përgjegjëse publike për zhvillimin e turizmit malor, përgjatë periudhës 2019-2020?", u arrit në këtë **mesazh auditimi:**

Masat e marra nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Turizmit si dhe Federata Shqiptare e Alpinizmit, përgjatë periudhës 2019-2020, për zhvillimin e turizmit malor, **nuk kanë rezultuar mjaftueshëm efektive,** pasi edhe pse nëpërmjet tyre janë siguruar kushtet



minimale për zhvillimin e tij, nga ana tjetër ato janë të pamjaftueshme për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor në periudhë afat-gjatë. Institucionet përgjegjëse për turizmin, vuajnë nga një **mungesë efieience dhe efektiviteti**, në ushtrimin e detyrave dhe realizimin e objektivave strategjike, me qëllim zhvillimin e turizmit malor në Shqipëri. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit malor, ka nevojë për kuadër rregullator të plotë dhe të zbatueshëm, rritje të nivelit të financimit, strategji marketingu dhe promovimi, menaxhim të destinacioneve të tij, infrastrukturë dhe aktivitete mbështetëse, komunikim dhe bashkëpunim të ngushtë me sektorin publik dhe privat.

Gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme, janë si më poshtë vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

A.1. Për pyetjen 1.1.1: A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?

1.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi plotësimin e bazës ligjore, rezultoi se:

-Referuar nenit 71 të Ligjit nr.93/2015 "Për turizmin", si dhe nenit 10 pika 2 të Urdhrit nr.267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", në Ligjin e turizmit nuk ka asnjë masë administrative të parashikuar, për strukturat akomoduese, që nuk kanë certifikatën e kategorizimit;

-Në Ligjin nr.93/2015 "Për turizmin" dhe VKM nr.730, datë 20.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", duke marrë në konsideratë praktikën e mira të vendeve të rajonit⁷⁰, nuk parashikohen në procesin e kategorizimit dhe klasifikimit edhe dhomat/apartamentet/vilat, të cilat ofrojnë akomodim për turistët. Mungesa e parashikimit në kuadrin ligjor, të këtyre ambjenteve, që ofrojnë shërbimin e akomodimit, në gjykimin e grupit të auditimit, sjell rritjen e numrit të tyre e për pasojë mund të ndikojë negativisht në informalitetin e sektorit të turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për propozimin e ndryshimeve të nevojshme në Ligjin nr.93/2015 "Për turizmin", me qëllim përfshirjen e dhomave/apartamenteve/vilave, që ofrojnë shërbimin e akomodimit, në procesin e kategorizimit dhe klasifikimit të tyre, si dhe të nenit 71, me qëllim përfshirjen e masës administrative, për strukturat akomoduese të cilat nuk kanë certifikatën e kategorizimit.

Brenda 6 muajorit të parë të vitit 2022

2.1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i VKM nr.162, datë 2.3.2016 "Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit", si dhe VKM nr.298, datë 20.04.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit", rezultoi se përcaktimi ligjor i bërë në pikën 3 të Kreut V, të VKM nr.162, datë 2.3.2016, krijon mbivendosje të detyrave funksionale me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 8.12 të Kreut I të VKM nr.298, datë 20.04.2016, pasi kompetenca e monitorimit të kontratave për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me subjektin investues, sipas VKM-së nr.162, i jepet MTM-së, ndërkohë sipas VKM-së nr.298, i jepet AKT-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, duke propozuar në Këshillin e Ministrave, ndryshimin e përcaktimit ligjor të bërë në pikën 3 të Kreut V, të VKM nr.162, datë 2.3.2016⁷¹ me përcaktimin ligjor në pikën 8.12 të Kreut I të VKM nr.298, datë

⁷⁰ Ligjit i Shtetit të Greqisë për Turizmin nr.4276/2014; Ligji i Turizmit në Shtetin e Malit të Zi-The Law on Tourism and Hospitality (official gazette of Montenegro 2/18, 04/18, 13/18 and 25/19).

⁷¹Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi



20.04.2016⁷², ku të ndahet qartë (duke shmangur mbivendosjen) kompetenca e monitorimit të kontratave të lidhura me subjektin investues, për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

A.2. Për pyetjen 1.1.3: A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM-së, KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

3.1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i procedurës së pjesëmarrjes së AKT në panairët ndërkombëtare përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-E gjithë procedura e pjesëmarrjes në panair të agjencive/operatorëve turistik, përjashtuar shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, mbulohet nga fondet buxhetore të AKT-së, detyrim ky që, **nuk është i përcaktuar në asnjë akt ligjor apo nëligjor, pra që me fondet e buxhetit të shtetit**, të përballohen shpenzimet e subjekteve private në panairët ndërkombëtare. Theksojmë se vetëm **për vitin 2019** nga AKT, për pjesëmarrjen e saj dhe të agjencive/operatorëve turistik në panairë ndërkombëtare, janë shpenzuar (hapësira me qera, ndërtimi dhe dizajnimi i stendës, kostot e regjistrimit, **pa përfshirë shpenzimet e udhëtimit, dietave, hotelit të stafit të AKT-së**), rreth **44,514,645 lekë për 10** panairë ndërkombëtare, ose **rreth 60% e fondeve buxhetore** (paga, investime, shpenzime të ndryshme operative). Nëse do t'i referoheshim **Shtetit të Sllovenisë**⁷³, për mënyrën se si vepron në organizimin dhe mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në panairët ndërkombëtare, ku **60% të shpenzimeve** mbulohen nga fondi buxhetor dhe **40%** nga buxheti i subjekteve private, për vitin 2019 në rastin e AKT, do të kishim **26,708,787 lekë**, që do të shpenzoheshin nga AKT dhe **17,808,858 lekë** nga subjektet private që kanë marrë pjesë në panair, ose e thënë ndryshe **AKT do të kursente 17,808,858 lekë**, të cilat mund t'i shpenzonte në mënyra/mjete të tjera, për rritjen e efektivitetit të promovimit të turizmit shqiptar;

-Në VKM nr.298, datë 20.04.2016⁷⁴, nuk përcaktohet si mjet promovues, pjesëmarrja në panairët ndërkombëtare, por AKT e përdorë këtë mënyrë promovimi, bazuar në eksperiencat e mëparshme institucionale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit, të marrin masat e nevojshme për propozimin në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në VKM nr.298, datë 20.04.2016⁷⁵, me qëllim përcaktimin e pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare dhe kombëtare si një mjet promovimi.

3.2. Rekomandimi: Në vijim të rekomandimit të mësipërm, Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, që nëpërmjet një akti nënligjor, të miratojë procedurën e organizimit të panairëve (nga faza e planifikimit të panairëve ku do të merret pjesë deri në zhvillimin e tij), duke përcaktuar detyrimet për të dyja palët (AKT dhe subjektet pjesëmarrës në panair) për financimin, sjelljen dhe raportimin e të dhënave statistikore, si dhe të përcaktohet si kriter s'kualifikues për të marrë pjesë në panairin e rradhës, rasti kur subjekti nuk respekton detyrimet e përbashkëta.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

B.1. Për pyetjen 1.1.1: A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?

zhvillimin e turizmit".

⁷² Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit".

⁷³ https://www.slovenia.info/uploads/dokumenti/program_dela_sto_2018-2019-en_tabele_s_prevodi_slik.pdf - Programi i punës për turizmin 2018-2019.

⁷⁴ Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së

⁷⁵ Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së.



1.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi plotësimin e bazës ligjore, rezultoi se:

- Nuk ka dalë Urdhri i Ministrit për miratimin e rregullore së funksionimit të saj, në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”;
- Nuk është miratuar Urdhri i Ministrit të Turizmit për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjeve të Projekteve në Turizëm;
- Nuk ka dalë urdhri për përcaktimin e kriterëve të funksionimit të zyrave e informuese turistike;
- Kudri rregullator për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimi i burimeve njerëzore të angazhuara në sektor ende nuk është i plotë⁷⁶;
- Nuk janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore, me qëllim realizimin e objektivit strategjik “Mbështetje për zhvillimin e modelit të menaxhimit të destinacioneve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit marrë masa që të hartojë dhe miratojë aktet nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Këshillimor i Sipërmarrjeve të Turistike, Zyrave të informacionit turistik, Organizatave për menaxhimin e destinacionit turistik, zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimin e burimeve njerëzore të angazhuara në sektor e turizmit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

2.1. Gjetje nga auditimi: Referuar pikës 4 të nenit 5 të VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullore për kushtet, kriteret, tarifet, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar, rezulton se, nga Ministri i Turizmit nuk është miratuar Udhëzimi për manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit të strukturave akomoduese. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa që të hartojë dhe miratojë Udhëzimin për manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit të strukturave akomoduese.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

3.1. Gjetje nga auditimi: Referuar SKT 2019-2023, si dhe Progres-Raportit për vitin 2020, të BE-së, ku thuhet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave (pasqyrohet si problematikë, transmetimi i tyre në EUROSTAT) në përputhje me acquis-në e BE-së, ende nga MTM nuk është përgatitur sistemi i ri i statistikave në fushën e turizmit, hartimi i metodologjisë në përputhje me Rregulloren e BE-së për statistikën në fushën e turizmit (informacion i besueshëm dhe i krahasueshëm, të dhëna mbi turizmin e brendshëm, burimet e të dhënave dhe mënyrat për sigurimin e informacionit)⁷⁷. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe miratojë metodologjinë për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, si dhe të vendosë në funksion sistemin e ri të statistikave, në përputhje me acquis-në e BE-së, por edhe me praktikën e mira të vendeve të rajonit⁷⁸.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

4.1. Gjetje nga auditimi: Referuar pikës 8.11 të VKM nr.298, datë 20.04.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, ende nuk është hartuar dhe miratuar Udhëzimi i përbashkët (MTM-MFE) për mënyrën e grumbullimit dhe përdorimit të të ardhurave nga marrëveshjet e qerasë, për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit, të lidhura

⁷⁶ Udhëzimet e përbashkëta me MASR për akreditimin e kurseve të trajnimit profesional për sektorin e turizmit.

⁷⁷ Regulation (Eu) no 692/2011 of the European Parliament and of the Council of 6 July 2011 Concerning European Statistics on Tourism - Rregullore e Bashkimit Europian nr.692/2011, në lidhje me Statistikat Evropiane mbi Turizmin;

⁷⁸ Statistikat e turizmit në Kroaci, treguesit që përdoren nga Kroacia dhe burimet e informacionit, https://www.dzs.hr/Hrv_Eng/publication/2017/SI-1594.pdf.



me subjektet “person i stimuluar”, si dhe prej një periudhe më tepër se 10-vjeçare, këto të ardhura nuk janë mbledhur. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, si dhe Agjencinë Kombëtare të Turizmit, të ngrejë një grup pune të përbashkët, me qëllim vlerësimin vlerës së detyrimit që kanë subjektet “person i stimuluar” për sipërfaqet e marra me qera, si dhe të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e tyre (duke lidhur marrëveshje të pagesës me këste/shërbimit të përbarimit). Pas kësaj, MTM në bashkëpunim me MFE të hartojë dhe miratojë udhëzimin për mënyrën e arkëtimit, me qëllim që në të ardhmen, mos të krijohen detyrime të prapambetura ndaj buxhetit të shtetit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

B.2. Për pyetjen 1.1.3: A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM-së, KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

5.1. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 30 të Ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit”, ende nuk janë përgatitur planet e zhvillimit dhe të veprimit për të gjitha zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, ku nga këto zona citojmë: Mali i Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshamë-Krastë; Vargmali i Moravës; Alpet; dhe Parku Kombëtar i Llogarasë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Turizmit, si dhe planeve të zhvillimit dhe veprimit për disa nga zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si ajo e Malit të Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshamë-Krastë Vargmalit të Moravës.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

6.1. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 4 të Ligjit të Turizmit, edhe pse kanë kaluar 5 vite nga miratimi i ligjit, ende nuk është publikuar dhe as nuk është finalizuar regjistri qendror i turizmit, i cili duhet të listojë në mënyrë të konsoliduar veprimtaritë në fushën e turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për publikimin e regjistrit qendror të turizmit, si dhe përditësimin e informacionit të tij.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

7.1. Gjetje nga auditimi: Ende nga MTM, nuk është miratuar Udhëzimi për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve për turistët, megjithëse ka kaluar rreth 1 vit nga hartimi i tij, kjo në kuadër edhe të objektivave të SKT 2019-2023, mbi ndërtimin e shtigjeve rajonale dhe kombëtare si dhe Ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, në të cilin parashikohet gjenerimi i të ardhurave, nga turistët, që vizitojnë destinacione turistike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për miratimin e udhëzimit për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve për turistët.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

8.1. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, ende nuk është hartuar dhe miratuar Planit Kombëtar i Turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Turizmit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi



9.1. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, MTM nuk ka një bazë të dhënash të ankesave të konsumatorëve ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

9.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për krijimin e databazës me informacionin për ankesat e konsumatorëve ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

10.1. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit, nenit 7 të Ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", si dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit", rezultoi se:

-Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit nuk funksionojnë sipas referencave ligjore të bëra më sipër, pra ato nuk janë të pozicionuara pranë Qarqeve, në mënyrë që të shërbejnë si ndërmjetës të bashkëpunimit dhe koordinimit, midis MTM dhe institucioneve të pushtetit vendor dhe subjekteve private, për zhvillimin e turizmit;

- Nga Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit nuk janë kryer këshillime, të sipërmarrjeve turistike, me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, përgjatë periudhës 2019-2020;

- Nuk ka databasë për ankesat ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike, si dhe për burimet turistike;

- Nuk janë organizuar seminare, konferenca, takime të Degëve Territoriale me sipërmarrjet turistike, për periudhën 2019-2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

10.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme që Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit, të pozicionohen me zyra pranë prefekturave, si dhe të sigurojë funksionimin e plotë të tyre për organizimin e seminareve, konferencave, këshillimeve të sipërmarrjeve turistike me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit turistik të ofruar.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

11.1. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 18 dhe 45 të Ligjit të Turizmit, si dhe VKM nr.730, datë 20.20.2016, rezulton se:

-MTM nuk e ka bërë ende kategorizimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese megjithëse është shtytur 3 herë afati për aplikimin për kategorizim e tyre (hotel, bujtinë, motel, hostel, resort), dhe nga MTM në bashkëpunim me Inspektoratin që mbulon fushën e turizmit, nuk është marrë asnjë masë për ndëshkrimin e atyre subjekteve që nuk janë të pajisur me certifikatën e kategorizimit;

-Portali elektronik për të lehtësuar këtë regjistrim dhe klasifikim nuk është ende aktiv. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

11.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për përshpejtimin e procesit të kategorizimit dhe klasifikimit të strukturave akomoduese, si dhe për çdo subjekt që nuk është i pajisur me certifikatën e kategorizimit, të vendosë masa administrative ndaj tyre.

11.2. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për aktivizimin e portalit elektronik për procesin e regjistrimit dhe klasifikimit të strukturave akomoduese.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

12.1. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 53 dhe nenit 66 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8707, datë 31.10.2016 "Për miratimin e formatit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe strukturat akomoduese", rezulton se përgjatë periudhës 2019-2020, agjencitë, operatorët dhe strukturat akomoduese nuk kanë raportuar çdo muaj



statistikat e turizmit, pranë MTM-së, dhe nga kjo e fundit nuk është marrë asnjë masë⁷⁹, për moszbatimin e ligjit nga subjektet private. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

12.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Inspektoratin përgjegjës për turizmin, të marrë masat e nevojshme për identifikimin e subjekteve që nuk kanë respektuar detyrimin ligjor për raportimin e të dhënave statistikore, si dhe paralajmërimin e tyre për respektimin e këtij detyrimi ligjor.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

13.1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i procedurës së pjesëmarrjes së Agjencisë Kombëtare të Turizmit në panairët ndërkombëtarë, përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-AKT nuk ka indikatorë/tregues të miratuar, mbi të cilët të bëjë vlerësimin e dobishmërisë/efektit në turizëm, të fondeve të shpenzuara për një panair;

-AKT nuk ka studim për monitorimin e tregut, mbi prirjet dhe preferencat e konsumatorëve, se çfarë ata kërkojnë nga turizmi në tërësi dhe ai malor në veçanti, me qëllim pjesëmarrjen në panairë sipas tematikës së tyre, me qëllim rritjen e efektivitetit të promovimit, si dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit të turizmit malor;

-Për vendosjen e kriterëve fituese për panairët e vitit 2019, që janë publikuar në portalin e-albania, nuk ka një analizë, mbi mënyrën e përcaktimit të tyre;

-Nuk ka një afat të përcaktuar, se sa ditë para zhvillimit të panairit, duhet të bëhet publikimi në portalin e-albania për konkurrim;

-Kriteri i përcaktuar për numrin e pjesëmarrësve (operator/agjenci turistike) në panair, nuk është respektuar, për shëmbull, për sipërfaqen 20-40 m² lejohet të marrin pjesë 5-8 subjekte, ndërkohë kanë marrë pjesë 10 subjekte, ose për sipërfaqen mbi 100 m² lejohet të marrin pjesë deri 23 subjekte, por që faktikisht kanë marrë pjesë 26 subjekte. Gjithashtu nuk ka një analizë, për mënyrën e përcaktimit të kriterëve mbi numrin e pjesëmarrësve, pasi kjo shoqërohet me rritje të kostos financiare të panairit, (pasi për një numër të lartë pjesëmarrësish, duhet një hapësirë më e madhe, më tepër tavolina, karrike, materiale promocionale, kostoja e regjistrimit);

-Në muajin Dhjetor të vitit **2019** janë kryer shpenzime në vlerën **3,507,438 lekë**, për llogari të 3 panairëve që zhvillohen në vitin **2020** (Madrid, Holland dhe Vienë), ndërkohë që për vitin 2019, këta 3 panairë nuk kanë qenë të miratuar nga Ministri përgjegjës për turizmin, si dhe nuk ka patur planifikim të fondeve buxhetore, pra nga AKT është bërë rishpërndarje e fondeve përtej datës 15 Nëntor, në mungesë të një arsytimi, si dhe pa marrë miratimin e Nëpunësit Autorizues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit⁸⁰.

-Nuk administrohen njoftimet e subjekteve fituese, procesverbalet e shpalljes së fituesve;

-Nuk administrohen deklaratat e ekzistencës/mosekzistencës së konfliktit të interesit, të anëtarëve të grupit, që ka bërë vlerësimi e aplikimeve deri në shpalljen e fituesve;⁸¹

-Nuk administrohen dokumentet e dorëzuara nga subjektet që kanë marrë pjesë (kryesisht mungojnë Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë 3 viteve të fundit, Kopje të materialeve promocionale të prodhuara nga Operatori Turistik, Listëpagesat e 6 muajve të fundit të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, shoqëruar me Formularin E-SIG 025/a);

-Nga stafi i AKT-së, i cili ka marrë pjesë në panair, nuk është mbajtur procesverbali, mbi marrjen në dorëzim të stendës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara;

-Nga operatorët/agjencitë turistike që kanë marrë pjesë në panair, nuk është respektuar detyrimi i akt-marrëveshjes, për dorëzimin e raportit përmbledhës të panairit pranë AKT, raport, i cili ka informacion mbi numrin e kontratave që ka lidhur në panair, numrin e turistëve që kanë blerë paketë turistike nga ky panair, të ardhurat e realizuara, etj;

-Vlerësimi i aplikimeve nuk është bërë në grup, i cili të dali me një vendim përfundimtar, për çdo

⁷⁹ Neni 71, pika 1, shkronja d, në Ligjin nr.93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar.

⁸⁰ Udhëzim nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

⁸¹ Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".



aplikim, por bëhet në mënyrë individuale;

-Kanë marrë pjesë subjekte të ndryshme të cilat nuk kanë qenë të licencuar për ushtrimin e aktivitetit si operator/agjenci turistike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

13.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrë masa, që në rregulloren e procedurës së pjesëmarrjes në panair të përcaktojë afatin e publikimit të njoftimit, hartimin e deklaratave të ekzistencës/mosekzistencës së konfliktit të interesit nga grupi i vlerësimit, si dhe në çdo rast, stafi pjesëmarrës në panair, të mbajë procesverbalin mbi marrjen në dorëzim të stendës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara .

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

14.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Turizmit pranë MTM, si dhe Agjencisë Kombëtare të Turizmit, rezultoi se:

-Për periudhën 2019-2020, disa prej pozicioneve më kryesore, si ai i Drejtorit të Përgjithshëm të Turizmit, Drejtorit të Drejtorisë së Projekteve, Përgjegjësit të sektorit të projekteve për marketimin e turizmit, Kryetarit të Degës Territoriale, janë vakante, për plotësimin e të cilave, MTM dhe AKT nuk ka marrë asnjë masë;

-Përshkrimet për pozicionet e punës (konkretisht për arsimin e kërkuar), nuk janë sipas përcaktimeve ligjore të bëra në Udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike nr.01, datë 31.05.2017 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".

-Sa i përket trajnimeve, për periudhën 2019-2020, rezulton një numër i ulët ditësh trajnimi, por edhe punonjësish, ku për dy vite janë trajnuar vetëm 5 punonjës (vetëm të një prej tre drejtorive) ose 20 % e strukturës (efektive), si dhe janë kryer 14 ditë trajnime gjithsej, ose 7-8 ditë trajnim në vit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

14.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit të hartojë dhe miratojë Strategjinë Kombëtare të Marketingut, si dhe ngritjen e strukturave promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

15.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit (KRZHT), Qarku Vlorë, Korçë dhe Shkodër, rezultoi se:

-Në Qarkun Vlorë, për periudhën 2019-2020, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit nuk ka funksionuar⁸²;

-Për KRZHT Korçë, për periudhën 2019-2020, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, është ngritur si strukturë, por nuk ka funksionuar sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin e Ministrit përgjegjës për turizmin nr.8502, datë 24.10.2016, sepse përfaqësuesit e Komitetit⁸³, nuk janë sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin e mësipërm, konkretisht nuk ka përfaqësues të shoqatave që operojnë në sektorin e turizmit (të cilët janë burimi kryesor i identifikimit të problematikave të ndryshme që ka sektori i turizmit në Qarkun e Korçës), ose janë përcaktuar si anëtarë të këtij Komiteti, institucione të cilat nuk parashikohen në Udhëzimin e mësipërm;

-Për KRZHT Korçë, rezulton se nuk është bërë asnjë diskutim për turizmin malor, por kryesisht diskutimet janë të fokusuar në menaxhimin e sezonit turistik veror, sigurinë në plazhe;

-Nuk administrohet informacioni i raportuar në AKT, për çështje që lidhen me turizmin sipas territorit administrativ përkatës⁸⁴.*(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

15.1. Rekomandimi: MTM në bashkëpunim me Prefektet e 12 Qarqeve në RSH, në rolin e Kryetarëve të Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit, të marrin masat e nevojshme për funksionimin e plotë të kësaj strukture dhe sipas qëllimit për të cilin janë krijuar.

⁸²Neni 20 i Ligjit nr.93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar.

⁸³ Rregullore për funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, nr.420 prot., datë 08.03.2019.

⁸⁴ Ligji nr.93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, neni 20;



Menjëherë dhe në vijimësi

16.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së AKT përgjatë periudhës 2019-2020, si dhe zbatimit të Urdhrit nr.65, datë 01.04.2019 të Kryeministrit, "Për planin e masave për sezonin turistik, viti 2019", rezultoi se:

- Referuar planeve vjetore të punës së AKT për periudhën 2019-2020, nga ky institucion, nuk janë përgatitur materiale audiovizive me qëllim promovimin e turizmit malor, si dhe nuk është kryer asnjë aktivitet që të ketë patur fokus zhvillimin e turizmit natyror/malor;
- Referuar VKM nr.298, datë 20.4.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit", AKT përgjatë periudhës 2019-2020, nëpërmjet kanaleve sociale on-line (www.albania.al), është fokusuar më tepër në promovimin e ecjes në natyrë, si një sport që zhvillohet kryesisht në zonat malore në Shqipëri, ndërkohë që për sporte të tjera si, hedhja me parashutë, çiklizmi malor, trekking, ngjitjet alpinistike dhe shëtitje me kuaj, nuk ka patur promovime;
- Nuk është përgatitur programi për vendosjen e sinjalistikës informuese dhe promovuese në destinacionet turistike më të frekuentuara;
- Nuk janë organizuar dhe mbështetur veprimtari argëtuese në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, shoqata apo subjekte private, me qëllim promovimin e turizmit;
- Nuk është marrë asnjë masë për pajisjen me materiale informuese të stendave promovuese, që janë ngritur pranë pikave kufitare dhe në përfaqësitë diplomatike shqiptare jashtë vendit, me qëllim informimin e vizitorëve dhe zhvillimin e produkteve të ndryshme turistike (detar, **malor**, historik, kulturor, etj);
- Nuk ka asnjë komunikim dhe bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore për hapjen dhe vënien në funksion të zyrave të informimit të turistëve;
- Databasa me destinacionet turistike që administrohet nga AKT, e cila në zbatim të Urdhrit nr.65, datë 01.04.2019, i është vënë në dispozicion Autoritetit të Rrugor Shqiptar, me qëllim që këto destinacione të pajisen me sinjalistikën informuese dhe promovuese, nuk është e plotë, për arsye se ka mangësi në numër destinacionesh, në krahasim me regjistrin e burimeve turistike që administrohet nga MTM, por edhe me ato që administrohen në qendrat e vizitorëve/zyrave të informacionit për turistët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrë masa për përgatitjen e materialeve audiovizive për turizmin malor, kryerjen e aktiviteteve në bashkëpunim me institucioneve të pushtetit vendor/shoqata, si dhe promovimin e sporteve që zhvillohen në zonat malore (hedhja me parashutë, çiklizmi malor, trekking, ngjitjet alpinistike dhe shëtitje me kuaj) me qëllim promovimin e turizmit malor.

Në vijimësi

B.3. Për pyetjen 1.1.2: A janë realizuar objektivat strategjike për turizmin malor nga MTM dhe AKT?

17.1. Gjetje nga auditimi: Referuar SKT 2019-2023, Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar 2030 (PINS 2030) dhe PKST Alpe 2030 nga MTM dhe AKT:

- nuk janë identifikuar, shënjuar dhe dixhitalizuar 5 shtigje të reja rajonale dhe 2 shtigje ndërkufitare të ecjes;
- nuk janë ndërtuar tre shtigjet rajonale dhe dy shtigje kombëtare të çiklizmit;
- nuk ka studim dhe masa të marra për identifikimin, vlerësimin, ndërtimin e pistave të skijimit, me qëllim zhvillimin e këtij sporti, si dhe sporteve të tjera në zonat malore;
- ende nuk janë identifikuar vendndodhjet për zhvillimin e alpinizmit, si dhe për realizimin e këtij objekti, nuk është parashikuar asnjë institucion/organizatë publike/private, ku në këtë rast përmendim Federatën Shqiptare të Alpinizmit, e cila mund të ftohej për bashkëpunim;



- nuk janë marrë masa për përfshirjen e Shqipërisë në guidat ndërkombëtare të ecjes dhe çiklizmit;
- nuk ka një studim për vlerësimin e kërkesës së tregut mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit (dixhitalizimi i shtigjeve malore) dhe alternativat që mund të adaptohen në turizmin vendas;
- nuk është ofruar mbështetje për veprimtaritë sportive që zhvillohen në natyrë, kryesisht në zonat malore (hedhje me parashutë, çiklizmi malor, ngjitjet alpinistike), si dhe aktualisht nuk disponohet një inventar të zonave, në të cilat ushtrohet/mund të ushtrohet sporti i hedhjes me parashutë apo çiklizmi malor;
- nuk është hartuar dhe miratuar Strategjia Kombëtare e Marketingut për sektorin e turizmit;
- nuk janë ngritur qendrat e vizitorëve për çdo Park Kombëtar, konkretisht nuk janë ngritur në PK Mali i Tomorrit, Bredhi i Drenovës, Bredhi i Hotovës-Dangëlli, Valbonë, Lurë, Butrint, Zall Gjocaj, si dhe qendrat e vizitorëve në Prespë nuk janë funksionale;
- nuk është përgatitur plani i masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore;
- nuk disponohet informacion për zonat e thella malore, në të cilat nuk arrihet të mbulohet me shërbim të telefonisë celulare/internet, ku theksojmë se nga vizitat në terren në zona të ndryshme të Parkut Kombëtar të Llogarasë, Prespë, në zonën e Bogës, si dhe komunikimit të grupit të auditimit me Specialistët e Zonave të Mbrojtura Vlorë dhe Korçë, mungesa e mbulimit me shërbim të telefonisë celulare/internet, është një nga problemet kryesore, të humbjes së turistëve (kryesisht atyre të huaj) gjatë vizitave turistike në shtigje malore;
- nuk është marrë asnjë masë për krijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore, me qëllim rritjen e sezonit turistik, ose e thënë ndryshme shmangien e sezonalitetit;
- nuk është marrë masë, për të ngritur platformën online të bashkëpunimit, për shoqëruesit/udhërrëfyesit e udhëtimeve, me qëllim koordinimin, bashkëpunimin, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar, gjatë shoqërimeve të grupeve të turistëve;
- nuk është përgatitur programi i trajnimit dhe nuk është marrë asnjë masë për trajnimin e burimeve njerëzore që janë të angazhuara në sektorin e turizmit;
- nuk është krijuar struktura menaxhuese për zbatimin e Planit Kombëtar Sektorial Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare;
- nuk është ngritur portali shqiptar i turizmit "e-turizëm", i lidhur me aplikacione që ofrojnë informacion mbi destinacionet e atraksionet turistike;
- nuk janë marrë masa për përmirësimin e zyrave/pikave të informacionit turistik, si dhe nuk është hartuar dhe miratuar rregullorja për pikat e informacionit turistik, por theksojmë se AKT ka vënë në dispozicion të 27 Bashkive, 60 infopoint (tabela informacioni për destinacione turistike). Gjithashtu nga 60 tabelat informuese, të cilat janë bërë kalim kapital nga AKT drejt Bashkive, 21 prej tyre ose 35%, janë të dëmtuara/kanë humbur, pra nuk i shërbejnë qëllimit të tyre;
- nuk janë ngritur strukturat promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë;
- nuk ka një analizë/studim se sa është numri i strukturave akomoduese, që nuk janë të regjistruara/që operojnë në mënyrë informale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.2) faqe (26-32) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, për identifikimin, shënjimin dhe dixhitalizimin e 7 shtigjeve malore të ecjes dhe 4 shtigje të çiklizimit, si dhe përfshirjen e tyre në guidat ndërkombëtare të ecjes.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

17.2.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të bëjë një studim, me qëllim vlerësimin e mundësive dhe më pas ndërtimin e pistave të skijimit dhe të zonave të zhvillimit të alpinizmit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

17.3.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të sporteve malore, dhe rrjedhimisht tërheqjen e turistëve në këto zona, të ftojë çdo vit Federatën e Alpinizmit, Aeronautikës, dhe të sporteve të tjera që zhvillohen në zonat malore, me qëllim



aplikimin në projektet që financohen prej saj, të cilat fokusohen në turizmin malor.

Në vijimësi

17.4.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e planit të masave për sigurinë e turistëve në zonat malore, duke krijuar Skuadrat e Kërkim-Shpëtimit, si dhe përgatitjen e rregullore së ndërhyrjes në mënyrë që çdo pjesëtar i këtyre skuadrave të jetë i qartë për funksionin që do të kryejë, duke shmangur kështu kaosin dhe duke shkurtuar kohën e dhënies së ndihmës të aksidentuarit. Gjithashtu të vlerësohet mundësia, që këto skuadra të kenë edhe mjekë të urgjencës, të cilët të trajnohen për ndërhyrjen në terren dhe mjekimin e të aksidentuarit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

17.5.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, të përgatisë një program pune, me qëllim realizimin e objektivit strategjik "Regjistrimin e 80% të strukturave akomoduese të vogla familjare", duke ndërmarrë masa konkrete, fushatë të koordinuar midis DPT-së dhe MTM-së, përcaktuar afate, si dhe burimet njerëzore dhe financiare që do të angazhohen.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

17.6.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit të hartojë dhe miratojë Strategjinë Kombëtare të Marketingut, si dhe ngritjen e strukturave promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

B.4. Për pyetjen 1.1.4: A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstitucional, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

18.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi bashkëpunimin ndërinstitucional të MTM dhe AKT me institucionet të tjera publike/jo publike, me qëllim marrjen e masave për zhvillimin e turizmit malor, rezultoi se, përgjatë periudhës 2019-2020, ka munguar bashkëpunimi i MTM dhe AKT:

-Me federata/shoqata të ndryshme sportive, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e veprimtarive sportive që zhvillohen në natyrë, kryesisht në zonat malore (hedhje me parashutë, çiklizmi malor, etj), me qëllim tërheqjen e turistëve në zonat malore;

-Me Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për përgatitjen e planit të masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore, krijimin e skuadrave të shpëtimit;

-Me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për krijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore, me qëllim rritjen e sezonit turistik;

-Me NJVQV-të, si dhe me aktorë të tjerë që kanë në administrim burime turistike, me qëllim përditësimin e regjistrit të burimeve turistike, ku theksojmë se në këtë regjistër, nuk ka asnjë shteg malor të pasqyruar, megjithëse është edhe objektiv strategjik ndërtimi, shënjimi dhe dixhitalizimi i tyre;

-Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për përgatitjen e një plan-veprimi, me qëllim përcaktimin e masave konkrete, afateve, strukturave përgjegjëse, për reduktimin e nivelit të informalitetit në sektorin e turizmit;

-Ministrinë e Infrastrukturës për krijimin e stacioneve të transportit turistik, i cili është detyrim ligjor dhe strategjik njëkohësisht. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.4) faqe (56-58) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrin masa që të fuqizojnë nivelin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke ndërmarrë dhe konkretizuar aktivitete të përbashkëta, që të kenë si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor.

Në vijimësi



B.5. Për pyetjen 1.2.1: A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga Federata Shqiptare e Turizmit dhe Alpinizmit Malor dhe a janë përdorur siç duhet ato?, si dhe C.6. Për pyetjen 1.2.2: A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?

19.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor (FSHALT), për ndikimin e saj në zhvillimin e turizmit malor përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-Pamjaftueshmëria e fondeve buxhetore të akorduara për FSHALT, në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht edhe në aktivitetin e kësaj Federate, pasi është ulur, numri i aktiviteteve vjetore, ku nga 6 aktivitete në vit, janë zhvilluar vetëm 2 aktivitete në dy vjet, numri i sportistëve që marrin pjesë në aktivitete, për shkak të pamundësisë së pagesës së trajtimit ushqimor, ku nga 100 sportist që merrnin pjesë në 1 aktivitet, për vitin 2019 dhe 2020 kanë marrë pjesë rreth 40 sportist në 1 aktivitet, nuk është marrë pjesë në asnjë aktivitet ndërkombëtar, si dhe nuk është krijuar mundësia në hapjen e shtigjeve malore apo të shtigjeve për kacaverje, etj.

-Midis FSHALT si dhe Ministrisë së Turizmit apo Agjencisë Kombëtare të Turizmit, nuk ka patur asnjë aktivitet të përbashkët, me qëllim promovimin e aktiviteteve sportive në zonat malore. Theksojmë se një aktivitet i tillë (Panairi i Turizmit Malor) ndërmjet FSHALT dhe AKT, për herë të fundit, është zhvilluar në muajin Dhjetor të vitit 2013, në të cilin kanë qenë të pranishëm rreth 400 persona si dhe media ndërkombëtare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.2.1 dhe 1.2.2) faqe (58-61 dhe 61-63) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1. Rekomandimi: Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor të hartojë dhe miratojë një program strategjik 3-5 vjeçar, duke përcaktuar objektivat që synon të arrijë, kostot dhe afatet e realizimit të tyre, identifikuar fuqitë, shanset dhe kërcënimet që rrezikojnë realizimin e tyre, si dhe një vlerësim mbi kontributin që mund të ofrojë Sporti i Alpinizmit në zhvillimin e turizmit malor, dhe t'ia përcjelli MASR-së dhe MTM-së për njohje, duke u bërë më konkrete në aktivitetin e saj dhe rritjen e besueshmërisë së këtij sporti, që edhe ai mund të jetë pjesë e zhvillimit të turizmit malor.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

19.2. Rekomandimi: Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin e mundësisë për krijimin e kurseve dhe trajnimin e personave që bëjnë guida alpinistike, që sot shihet si domosdoshmëri për të gjithë ata që shoqërojnë grupe turistësh në zonat malore.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

19.3. Rekomandimi: Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor të marrë masat e nevojshme, për botimin çdo 6-mujor, të një reviste/broshure dhe publikimin e saj në median elektronike dhe atë të shkruar, për prezantuar

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

C.1. Për pyetjen 1.1.3: A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM-së, KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?

1.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të AKT për pjesëmarrjen në panairët ndërkombëtarë (transaksionet në valutë të huaj, shpenzimet e taksive dhe hotelit), përgjatë



periudhës 2019-2020, rezultoi se janë përdorur pa ekonomikitet rreth 38,150 euro ose 4,740,395 lekë. Theksojmë se kjo situatë është krijuar edhe për arsye se nga AKT nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të posaçme, për organizimin e punës dhe sigurimin e hoteleve me kosto sa më të ulët. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit

1.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrë masa që, të nxjerrë një urdhër të brendshëm, për përcaktimin e procedurave, për veprimet në valutë të huaj, sigurimin e hoteleve me kosto të ulët, si dhe reduktimin e shpenzimeve të panevojshme për transportin e stafit të saj, gjatë pjesëmarrjes në panairt dhe trajnimet jashtë vendit, me qëllim eliminimin e përdorimit pa ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve buxhetore, alokuar për këto aktivitete.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

6.SHTOJCAT/ANEKSE

Aneksi nr.1 "Observacione të subjekteve nën auditim"

Observacion: Me shkresën nr.199/7 prot., datë 12.08.2021, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, ku ka falenderuar grupin e auditimit dhe ka shprehur dakortësinë për rekomandimet e dhëna, me përjashtim të rekomandimit nr.1, nënpyetja 1.1.1, lidhur me ngritjen e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve (komision i ngritur me urdhrin nr.156, datë 16.05.2019 të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit); Rekomandimit nr.4, nënpyetja 1.1.1, ku nuk është e nevojshme rishikimi i përcaktimit të bërë në aktin nënligjor, pasi është caktuar MTM, institucioni përgjegjës për monitorimin e kontratave/marrëveshjeve për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit; Rekomandimit nr.3 të nënpyetjes 1.1.3, për Parkun Kombëtar të Llogarasë; Gjetjes së grupit të auditimit, mbi kërkesat e përcaktuara për llojin e arsimit të kërkuar në përshkrimin e punës; Mbi kursin e këmbimit valutor të përdorur nga AKT;

Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit të bërë nga MTM, sqaron se:

- Lidhur me Komisionin e përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, observacioni merret në konsideratë;
- Për hartimin e Planit Kombëtar të Turizmit, si dhe planit të zhvillimit dhe veprimit për Parkun Kombëtar të Llogarasë, merret në konsideratë;
- Lidhur me përmirësimin ligjor ndërmjet VKM nr.162, datë 02.03.2016 dhe VKM nr. 298, datë 20.4.2016, referuar përcaktimeve të bëra në pikën 3 të Kreut V të VKM nr.162, datë 02.03.2016:

3. Monitorimi bëhet nga ministria përgjegjëse për turizmin.

Si dhe në pikën 8.12 të VKM nr. 298, datë 20.4.2016:

8.12 Kontrollon zbatimin dhe plotësimin e kriterëve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe për marrëveshjet e zhvillimit, të lidhura me subjektet "person i stimuluar". Rregulla të hollësishtme për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

Arrihet në konkluzionin se të dyja këto përcaktime në thelb kanë të njëjtin qëllim pra kontrollin e marrëveshjeve/kontratave të lidhur me personat e stimuluar për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, dhe është e nevojshme që të ndahet përgjegjësia e kontrollit të tyre.

-Për gjetjen e grupit të auditimit për kërkesat e formimit arsimor në përshkrimet e punës, grupi i auditimit sqaron se, në asnjë rast nuk jemi shprehur se rekrutimet e burimeve njerëzore janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të fushës, si dhe e dimë që këto procedura realizohen nëpërmjet DAP. Gjetja e grupit të auditimit, për të cilën kemi dhënë rekomandimin përkatës, lidhet me përshkrimin e punës, më konkretisht për kërkesat e formimit arsimor, të cilat nuk janë sipas kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e DAP nr.01, datë 31.05.2017 "Për hartimin e përshkrimit



të pozicioneve të punës në shërbimin civil", dhe që këto kërkesa janë miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Pra observacioni i MTM për gjetjen e grupit të auditimit nuk merret në konsideratë.

Observacion: Me shkresën nr.199/7 prot., datë 12.08.2021, Agjencia Kombëtare e Turizmit ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, ku ka falenderuar grupin e auditimit për bashkëpunimin përgjatë procesit të auditimit, me përjashtim të gjetjeve të përbashkëta.1-8, mbi procedurat e panairëve, lidhur me Deklaratën e konfliktit të interesit; Njoftimet e subjekteve fituese; Procesverbalet e shpalljes së fituesve; Administrimin e dokumenteve të dorëzuara nga subjektet që kanë marrë pjesë (kryesisht mungojnë Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë 3 viteve të fundit, Kopje të materialeve promocionale të prodhuara nga Operatori Turistik, Listëpagesat e 6 muajve të fundit të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, shoqëruar me Formularin E-SIG 025/a); Procesverbali mbi marrjen në dorëzim të stendës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara; Nuk administrohet raporti i monitorimit të operatorëve/agjencive turistike, mbi sjelljen, komunikimin dhe qëndrimin e tyre; Vlerësimi i aplikimeve nuk është bërë në grup, i cili të dali me një vendim përfundimtar, për çdo aplikim, por bëhet në mënyrë individuale; Në VKM nr.870, datë 14.01.2020 dhe Udhëzimin nr.22, datë 01.07.2013 nuk përcaktohet tarifë fikse për akomodimin; Shpenzimet për faturat e hotelit, si dhe për standat; Mbi pikat e informacionit turistik.

Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit të bërë nga AKT, sqaron se:

-Për deklaratën e konfliktit të interesit, i jemi referuar ligjit të fushës, dhe kjo nuk do të thotë se nëse një përcaktim ligjor nuk është në rregulloren e brendshme të intitucionit, nuk është detyrim për tu zbatuar nga ju;

-Në urdhërat e titullarit për organizimin e panairëve, akt-marrëveshjet që lidhen me operatorët si dhe Udhëzimin nr.01, datë 17.03.2020 me qëllim përcaktimin e rregullave për zhvillimin e procedurës së panairit, përcaktohen qartë detyrat e grupit të punës për panairët që zhvillohen nga AKT, dhe grupi i auditimit për çdo gjetje të tij i është referuar përcaktimeve të bëra në aktet administrative më sipër. Në këto akte përcaktohet që grupi mban një procesverbal në përfundim të përzgjedhjes së projekteve, (pra edhe vlerësimi në grup do kryhet, se për këtë qëllim është ngritur, për më tepër që në urdhërat e titullarit për ngritjen e grupit të punës nuk specifikohet që punonjësi përkatës do shqyrtojë aplikimet për një panair, punonjësi tjetër për panairin e tjetër, e kështu me rradhë), plotësimin e dosjes së çdo aplikanti me dokumentacionin e kërkuar (publikuar në e-albania);

-Përsa i përket procesverbalit të marrjes në dorëzim të stendës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara, është një kërkesë e cila përcaktohet në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pasi ju për mallrat e mësipërm kryheni një pagesë, e cila duhet të shoqërohet me një dokumentacion justifikues dhe vërtetues (kontrata, procesverbali për marrjen në dorëzim të mallrave të porositur prej jush, faturat tatimore, etj);

-Lidhur me shpenzimet e kryera për panairët (kryesisht të përzgjedhjes së hoteleve dhe shpenzimeve të transportit aeroport-hotel), grupi i auditimit e ka parashtruar që në krye të herës, vlerësimi të tyre, nëse është e mundur që të kursehen fondet e buxhetit të shtetit; Pikërisht edhe grupi i auditimit e ka evidentuar si mangësi që nga AKT nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të posaçme, për organizimin e punës, për sigurimin e hoteleve me kosto sa më të ulët, rregullore e cila vjen në zbatim të VKM nr.870, datë 14.12.2011 dhe Udhëzimit nr.22, datë 01.07.2013;

-Në asnjë rast nuk jemi shprehur se një punonjës i nivelit specialist, përgjegjës sektori, drejtor drejtorie, është akomoduar në një strukturë akomoduese, jo sipas kategorisë së përcaktuar;

-Përsa i përket kursit të këmbimit nga grupi i auditimit është evidentuar si mangësi që ai është marrë vetëm në një bankë të nivelit të dytë, për arsye se nuk sigurohet konkurrenca efektive në



marrëdhëniet e AKT me subjektet private⁸⁵;

-Lidhur me shpenzimet për hotelin në panairin Milano, sqarojmë se një institucion publik që të ardhurat e tij vijnë nga buxheti i shtetit, ka si qëllim përdorimin e me ekonomikitet të fondeve buxhetore, që do të thotë, që për një shërbim të caktuar të synohet reduktimi i kostove sa më shumë që të jetë i mundur dhe pa cenuar cilësinë e tij⁸⁶. Pra në rastin konkret AKT ka përfituar vetëm një shërbim, një dhomë hoteli, e cila është përdorur nga dy punonjësit e saj, pra jo dy shërbime, dhe në këto kushte duke patur në konsideratë përdorimin me ekonomikitet të fondeve publike, duhet të paguhej vetëm një shërbim⁸⁷, pra një dhomë hoteli.

-Për shpenzimet e standës, ku sipas observacionit të bërë nga AKT, se për shkak të gabimit të organizatorit, stenda e AKT, nuk ishte sipas specifikimeve të kërkuara dhe kontraktuara prej saj, atëherë në këto kushte AKT ndaj organizatorit duhet të kishte kërkuar penalitetet për moszbatimin e kontratës. Për më tepër që për kryerjen e këtij shpenzimi, të paplanifikuar, nga AKT duhej të kërkohej miratimi nga Nëpunësi Autorizues i MTM, për rialokim të fondit.

-AKT nuk e ka detyrë funksionale ngritjen e zyrave/pikave të informacionit turistik, por e ka objektiv strategjik, përcaktuar në planin e veprimit të SKT 2019-2023.

Aneksi nr.2 "Intervistat për MTM dhe AKT".

Intervistë për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Tiranë, më 04.05.2021

Lënda: Vjelje të dhënash dhe përgjigjesh zyrtare për auditimin e performancës "Zhvillimi i Turizmit Malor"

1.Referuar nenit 30 të Ligjit nr.93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit", a janë përgatitur planet e zhvillimit dhe të veprimit për zonën: Mali i Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshatë-Krastë; Vargmali i Moravës; Alpet; dhe Parku Kombëtar i Llogarasë.

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion planet e mësipërme.

2.Referuar Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 (në vijim SKT 2019-2023), çfarë nënkupton modeli i menaxhimit të destinacionit?

- A ka MTM një studim, me qëllim zbatimin e këtij modeli në Shqipëri?

- A është vënë në zbatim ky model, në sektorin e turizmit?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion studimin përkatës.

- Cilat janë aktet nënligjore që janë miratuar për realizimin e këtij objekti strategjik?

- Lutemi pasqyroni specifikisht aktin nënligjor.

- Cilat janë aktet nënligjore që MTM ka parashikuar për tu miratuar në vijimësi?

- Cilat janë Organizatat e Menaxhimit të Destinacionit?

- A janë funksionale ato?

- A i ka mbështetur financiarisht MTM këto organizata?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion dokumentacionin justifikues.

- A janë monitoruar këto organizata përgjatë periudhës 2019-2023?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion raportet e monitorimit.

3.Referuar SKT 2019-2023, a është kërkuar gjatë fazës së përgatitjes së Strategjisë, mendim nga institucionet e tjera qeveritare (Ministria e Arsimit, Kulturës, Infrastrukturës, etj), institucionet në

⁸⁵ Neni 4 në Ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

⁸⁶ pika 23, neni 3, ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"

⁸⁷shkronja "i", neni 10, ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Pika 1 në VKM nr.870, datë 14.12.2011.



varësi të MTM (Agjencia Kombëtare e Turizmit, Inspektorati që mbulon fushën e turizmit, etj), si dhe subjektet private që ofrojnë shërbime turistike?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion ftesën e MTM, drejtuar këtyre institucioneve dhe subjekteve.

4.Referuar SKT 2019-2023, a ka ofruar MTM, mbështetje për promovimin e turizmit, përgjatë periudhës 2019-2020?

- Nëse po, cilat kanë qenë format e mbështetjes së MTM për promovimin e turizmit?
- Lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën justifikuese.

5.Referuar SKT 2019-2023, cilat nga veprimtaritë në natyrë (hedhje me parashutë, çiklizmi malor, trekking, ngjitjet alpinistike, hiking dhe shëtitje me kuaj), ka mbështetur MTM, me qëllim zhvillimin e tyre, duke i shërbyer në këtë mënyrë zhvillimit të turizmit malor?

- Lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën justifikuese (bashkëpunim me federata të ndryshme, financim të projekteve, organizimin e takimeve të punës, krijimin e lehtësirave ligjore nëse ka patur, etj).
- A keni një inventar të zonave, në të cilat ushtrohet/mund të ushtrohet sporti i hedhjes me parashutë?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion.

6.Referuar SKT 2019-2023, si dhe Planit Kombëtar Sektorial Alpe 2030, ju shpreheni se ka probleme të infrastrukturës, mungojnë qëndrat për zhvillimin e turizmit malor dhe të aventurës;

- Sa më sipër, a keni një studim për identifikimin, vlerësimin dhe zhvillimin e sportit të skijimit, si dhe sporteve të tjera në zonat malore, dhe a është vënë në zbatim ky studim?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion studimin.

7.Referuar SKT 2019-2023, Objektivi Politik "**Përmirësimi i Shërbimeve Turistike**", për të vazhduar në Objektivin Specifik "**Krijimi i kuadrit rregullator dhe institucional për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimi i burimeve njerëzore të angazhuara në sektor**", si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ju, rezulton se deri më tani është hartuar dhe miratuar Udhëzimi i përbashkët nr.517, datë 24.01.2017 "Për akreditimin e programeve të kualifikimit të Udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim";

- Sa më sipër, cilat do të jenë aktet nënligjore që parashikohen të miratohen nga MTM (vetëm ose në bashkëpunim), për realizimin e këtij objekti?
- A është përgatitur nga MTM një program trajnimi për vitet 2019 dhe 2020, për trajnimin e burimeve njerëzore që janë të angazhuara në sektorin e turizmit?
- Nëse po, ky program ka qenë për një target grup të caktuar apo gjithëpërfshirës? Lutemi të na vendosni në dispozicion programin e trajnimit të miratuar, si dhe evidencën e realizimit të tij.
- Sa ka qenë numri i të punësuarëve direkt në sektorin e turizmit në vitin 2019 dhe për vitin 2020?
- Sa prej tyre janë trajnuar respektivisht sipas viteve?
- Përsëri referuar këtij objekti strategjik, përse për këtë objekt, në dallim nga të tjerët, në tabelën nr.10 – "Matrica e Vlerësimit të Performancës", nuk keni përcaktuar outputin e matshëm, afatin kohor dhe institucionet përgjegjëse për realizimin e tij?

8.Referuar SKT 2019-2023, a ka përgatitur MTM, programin konkret të punës, për zhvillimin e turizmit natyror?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion programin e miratuar, për zhvillimin e turizmit natyror.

9.Referuar SKT 2019-2023, Objektivi Politik "**Ri-orientim i Promovimit drejt potencialeve**", dhe më tej në Objektivin Specifik "**Mbështetja e Agjentëve Promovues të vendit në Shqipëri dhe Diasporë**";

- Cilët janë agjentët promovues?



- A ka ofruar mbështetje MTM për këta agjentë, dhe nëse po, cilat kanë qenë mënyrat që i ka mbështetur MTM, përgjatë periudhës 2019-2023?
- Lutemi të në vendosni në dispozicion evidencën justifikuese.

10.Referuar SKT 2019-2023, Objektivi Politik **“Përmirësimi i Shërbimeve Turistike”**, për të vazhduar në Objektivin Specifik **“Regjistrimi i 80% të strukturave akomoduese të vogla familjare”**, si dhe Progres-Raportit për vitin 2019 dhe 2020, të BE-së, në kapitullin 20, ku ende informaliteti, pasqyrohet si problematikë në sektorin e turizmit;

- Sa më sipër, a keni një analizë/studim të përditësuar, se sa është numri i strukturave akomoduese, që nuk janë të regjistruara?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën përkatëse.
- Çfarë masash janë parashikuar në SKT 2019-2023, për uljen e nivelit të tij?
- Cilat do të jenë institucionet, që MTM do të bashkëpunojë për reduktimin e nivelit të informalitetit?

11.Referuar SKT 2019-2023, ju shpreheni se përdorimi i IT-së në industrinë turistike është i kufizuar;

- Sa më sipër, a keni një studim për vlerësimin e kërkesës së tregut mbi përdorimin e IT-së dhe alternativat që mund të adaptohen në turizmin vendas?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion studimin.
- Përsëri referuar sa më sipër, a keni vlerësuar mundësinë e ndërtimit të një aplikacioni elektronik, ku të promovohen dhe të aksesohet më lehtë informacioni, për destinacionet turistike?
- Nëse po, lutemi të na vini në dispozicion konkluzionet dhe rekomandimet tuaja, si dhe projektin për zbatim.

12.Referuar SKT 2019-2023, a janë ngritur strukturat përkatëse promovuese, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion strukturën e miratuar, si dhe aktin rregullator për organizimin dhe funksionimin e tyre.

13.Referuar SKT 2019-2023, a është ngritur grupi tematik, i cili ka si detyrë ndjekjen e zbatimit dhe monitorimit të realizimit të strategjisë?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion raportet e monitorimit (2019-2020) të kryera nga ky grup, për ecurinë e zbatimit të SKT 2019-2023, si dhe Urdhrin e Ministrit të MTM-së, për përcaktimin e përfaqësuesve të sekretarisë teknike, që funksionon pranë grupit tematik.
- Nëse ky grup nuk është strukturuar dhe nuk ka filluar së funksionuari, lutemi të listoni arsyet përse.
- Gjithashtu nëse ky grup nuk është funksional, a është përcaktuar ndonjë strukturë tjetër pranë MTM-së, për të kryer monitorimin e zbatimit të SKT 2019-2023?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion Urdhrin e Titullarit të MTM, për përcaktimin e kësaj strukture, për realizimin e monitorimit të SKT, si dhe raportet e monitorimit.
- Referuar SKT 2019-2023, fq., nr.25, në vijim të pyetjeve të mësipërme, lutemi të na vendosni në dispozicion, planin e veprimit të miratuar, për zbatimin e SKT, për vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021.

14.Referuar SKT 2019-2023, a keni një analizë kostoje, mbi të cilën keni bërë parashikimin buxhetor për realizimin e secilit prej objektivave strategjikë, pasqyruar në tabelën nr.10, fq., nr.24?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion analizën e kostimit të secilit prej objektivave.
- Nëse jo, si e keni vlerësuar, se për realizimin e objektivit politik nr.2 **“Përmirësimi i shërbimeve turistike”**, nevojiten 545,060 mijë lekë dhe jo më pak, ose më tepër?

15.Referuar SKT 2019-2023, a janë identifikuar vendndodhjet për zhvillimin e alpinizmit?

- Nëse po, sa janë identifikuar përgjatë periudhës 2019-2020?
- Lutemi listojini ato.



- Referuar sa më sipër, a keni bashkëpunuar me aktorë të tjerë për realizimin e këtij objekti, apo ky proces është kryer vetëm nga MTM?
- Nëse keni bashkëpunuar, lutemi të na vendosni në dispozicion ftesën e MTM për bashkëpunim.
- Nëse ky proces është kryer vetë nga MTM, a keni ju specialist të fushës për identifikimin dhe vlerësimin e vendndodhjeve për alpinizëm?
- Nëse po, lutemi të na vendosni të dhënat për specialistin/ët përkatës dhe kualifikimet profesionale të tyre.

16.Referuar SKT 2019-2023, a janë identifikuar, shënjuar dhe dixhitalizuar 5 shtigje të reja rajonale dhe 2 shtigje ndërkufitare?

- Nëse po, listojini cilat janë identifikuar, shënjuar dhe dixhitalizuar deri më datë 31.12.2020.
- Cili është aplikacioni i krijuar?
- Si mund të aksesohet ai?

17.Referuar SKT 2019-2023, cilat janë 7 iteneraret historiko-kulturore (lutemi listojini ato)?

- Çfarë ka bërë MTM për zhvillimin e tyre (lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën justifikuese)?

18.Referuar SKT-2019-2023, Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar 2030 (PINS 2030), si dhe të dhënave të vendosura në dispozicion nga ju, mbi ndërtimin e 3 shtigjeve rajonale dhe 2 shtigje për çiklizmin, jeni shprehur se kanë përfunduar disa shtigje rajonale dhe janë në proces disa të tjera;

- Këto shtigje janë ndërtuar nga MTM, subjekte të tjera publike dhe private, apo në bashkëpunim?
- Nëse ky objektiv është kryer nëpërmjet bashkëpunimit, lutemi të na vendosni në dispozicion kontributin e gjithësecilit.
- Sa prej këtyre shtigjeve kanë edhe pika vrojtimi?
- Sa prej këtyre shtigjeve kanë zonë për piknik?
- Sa më sipër, lutemi listoni shtigjet rajonale për këmbësor dhe çiklizmin, të përfunduara, si dhe periudhat përkatëse kur kanë përfunduar.

20.Referuar SKT 2019-2023, si dhe Progres-Raportit për vitin 2020, të BE-së, ku thuhet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave (pasqyrohet si problematikë, trasmetimi i tyre në EUROSTAT) në përputhje me acquis-në e BE-së, cili është sistemi i ri i statistikave në fushën e turizmit?

- Çfarë përfshin ai?
- A ka filluar funksionimi i tij?
- Në cilën praktikë/a të mira jeni mbështetur për krijimin e tij?
- Lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën përkatëse.

21.Referuar PKST Alpe 2030, a është ngritur Shoqata Profesionale Kombëtare për Turizmin e Aventurës dhe Sportiv?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën përkatëse (emërtimi i shoqatës, kontributi i MTM-së në strukturimin si dhe në mbështetjen e saj, nëse ka patur).
- Nëse jo, ku parashikohet të strukturohet dhe të funksionojë kjo shoqatë?

22.Referuar nenit 63 të Ligjit të Turizmit, PKST Alpe 2030, si dhe PINS 2030, a janë krijuar stacionet e transportit turistik?

- Sa subjekte janë të licencuara për kryerjen e transportit turistik?
- Cilat janë vendndodhjet e stacioneve të mësipërme?

23.Referuar PKST Alpe, a keni informacion për zonat malore, në të cilat arrihet të mbulohet me shërbim të telefonisë celulare/internet, dhe për ato zona ku ky shërbim nuk sigurohet?

- Çfarë masash ka marrë MTM, që në zona të thella malore, ku kryhet turizëm malor, të ketë mbulim me rrjet të telefonisë celulare/internet?
- Lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën justifikuese.



24.Referuar PKST Alpe, a është krijuar paketa e aktiviteteve dimërore, me qëllim rritjen e sezonit turistik?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion paketën e aktiviteteve.

25.Referuar PKST Alpe, a është ngritur platforma online e bashkëpunimit për shoqëruesit e udhëtimeve?

- Nëse po, si emërtohet ajo dhe kush e administron?
- A ka filluar përdorimi i saj?
- Nëse ka filluar përdorimi i saj, lutemi të na mundësoni aksesimin në këtë platformë.

26.Referuar nenit 4 dhe nenit 9/n të Ligjit të Turizmit, a janë ngritur zyrat e informuese turistike?

- Nëse po, a janë përcaktuar kriteret për funksionimin e tyre?
- Sa zyra janë në territorin e Republikës së Shqipërisë?
- Lutemi të na vini në dispozicion urdhrin/udhëzimin për përcaktimin e kriterëve të funksionimit të tyre.

27.Referuar nenit 4 të Ligjit të Turizmit, a është krijuar regjistri qendror i turizmit?

- Nëse po, lutemi të na e vendosni në dispozicion.
- Nëse jo, lutemi të listoni arsyet që kanë sjellë mos krijimin e tij.

28.Referuar nenit 4 të Ligjit të Turizmit, a është krijuar regjistri kombëtar i turizmit?

- Nëse po, lutemi të na e vendosni në dispozicion.
- Për hedhjen e të dhënave në këtë regjistrë dhe administrimin e tij, ka një grup pune, sektor pranë MTM, apo secili institucion regjistron burimet turistike që ka në administrim?

29.Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, a është hartuar dhe miratuar Plani Kombëtar i Turizmit?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion Planin Kombëtar.

30.Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, a keni një databasë të ankesave të konsumatorëve ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike?

- Nëse po, lutemi të na e vendosni në dispozicion.

31.Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit, nenit 7 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”, a janë duke funksionuar Degët, sipas përcaktimeve ligjore të bëra, në referencat ligjore më sipër?

32.Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”, a janë kryer këshillime nga Degët Territoriale, të sipërmarrjeve turistike, me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, përgjatë periudhës 2019-2020?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën justifikuese, për Degën Territoriale të Qarkut Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.

33.Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”, a kanë Degët Territoriale databasë për ankesat ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion databasën, për Degën Territoriale të Qarkut Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë, si dhe shkresat përcjellëse/email zyrtar drejtuar inspektoratit përkatës, për shqyrtimin e tyre.

34.Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”, a kanë patur bashkëpunime Degët Territoriale me autoritetet vendore, për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e turistit në destinacion, përgjatë periudhës 2019-2020?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion, evidencën justifikuese.

35.Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”, a kanë patur bashkëpunime Degët Territoriale me bizneset turistike, për evidentimin dhe vlerësimin e nevojave për trajnime, përgjatë periudhës 2019-2020?



- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion, evidencën justifikuese, si dhe pyetësorët e përgatitur për këtë qëllim, për Qarkun Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.

36.Referuar nenit 3 të Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit", çfarë të dhënash grumbullojnë Degët Territoriale?

- A janë grumbulluar këto të dhëna për periudhën 2019-2020?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion informacionin përkatës, për Qarkun Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.

37.Referuar nenit 3/g të Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit", a ka një databasë sipas formatit të përcaktuar në Aneksin nr.1 të Urdhrit, për burimet turistike, të cilat ndodhen brenda territorit administrativ që mbulon Dega?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion databasën sipas formatit të miratuar, për Qarkun Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.
- Cilat janë burimet e informacionit që përdor Dega Territoriale për grumbullimin e informacionit të mësipërm?
- Lutemi të na vendosni në dispozicion komunikimet zyrtare të Degëve Territoriale për Qarkun Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë, me njësitë vendore, për sigurimin dhe përditësimin e inventarit të burimeve turistike.

38.Referuar nenit 3/gj të Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit", a ka një databasë sipas formatit të përcaktuar në Aneksin nr.2/a/b/c/d të Urdhrit, për sipërmarrjet turistike, të cilat ndodhen brenda territorit administrativ që mbulon Dega?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion databasën sipas formatit të miratuar, për Qarkun Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.

39.Referuar nenit 4/c të Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit", lutemi të na vini në dispozicion raportet periodike (3 mujore, 6 mujore dhe 1 vjeçare për periudhën 2019-2020) të Degëve Territoriale për Qarkun Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.

40.Referuar nenit 5/d të Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit", a ka patur bashkëpunim me Komitetet Rajonale të Zhvillimit të Turizmit, për periudhën 2019-2020, për zbatimin e politikës për zhvillimin e produktit turistik malor?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion bashkëpunimet e dy strukturave për Qarkun Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.

41.Referuar nenit 6/c të Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit", a janë organizuar seminare, konferenca, takime të Degëve Territoriale me sipërmarrjet turistike, për periudhën 2019-2020?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion ftesat për pjesëmarrje të sipërmarrjeve turistike, procesverbalet e takimeve/seminareve/konferencave, për Qarkun Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.

42.Referuar nenit 11 të Ligjit të Turizmit, lutemi të na vendosni në dispozicion, informacionin mbi anëtarët e Komitetit Këshillimor të Sipërmarrjeve Private Turistike (KKSPT), për periudhën 2019-2020.

43.Referuar nenit 11/2 të Ligjit të Turizmit, lutemi të na vini në dispozicion rregulloren e funksionimit të KKSPT dhe Urdhrit e miratimit të saj.

44.Referuar nenit 11/4 të Ligjit të Turizmit, lutemi të na vini në dispozicion mendimet/sugjerimet (procesverbalin/et të mbledhjes/ve) e dhëna nga KKSPT për Strategjinë e Turizmit 2019-2023.

45.Referuar nenit 11/4 të Ligjit të Turizmit, lutemi të na vini në dispozicion mendimet/sugjerimet (procesverbalin/et të mbledhjes/ve) e dhëna nga KKSPT për planifikimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit.



46.Referuar nenit 11/4 të Ligjit të Turizmit, një nga çështjet që lidhet me veprimtarinë turistike, është kategorizimi dhe klasifikimi i strukturave akomoduese;

- Sa më sipër, çfarë trajtimi ka bërë KKSPT për këtë çështje?
- Cilat kanë qenë rekomandimet e saj?
- Lutemi të na vini në dispozicion procesverbalin/et e mbledhjes/ve të KKSPT, në të cilin/ët është trajtuar kjo çështje.

47.Referuar nenit 11/4 të Ligjit të Turizmit, çfarë mendimesh ka dhënë KKSPT, për situatën e krijuar në sektorin e turizmit, nga Pandemia COVID-19?

- Lutemi të na vendosni në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së KKSPT, për këtë çështje.

48.Referuar nenit 18 të Ligjit të Turizmit dhe nenit 4 të Urdhrit nr.101, datë 06.01.2017 “Për miratimin e rregullores për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Standardizimit të Veprimtarive Turistike”, lutemi të na vendosni në dispozicion Urdhrit/at e Ministrisë të MTM-së, për caktimin nominal të përbërjes së Komisionit, për periudhën 2019-2020?

- Referuar sa më sipër, sa kërkesa për kategorizim, kanë ardhur në MTM, për vitin 2019 dhe vitin 2020, të ndarë?
- Sa prej tyre janë shqyrtuar nga Komisioni?
- Sa prej tyre janë miratuar?
- Lutemi të na vini në dispozicion praktikat e plota të miratimit të kërkesës për kategorizim.
- Sa kërkesa për klasifikim kanë ardhur në MTM, për vitin 2019 dhe vitin 2020, të ndarë?
- Sa prej tyre janë shqyrtuar nga Komisioni?
- Sa prej tyre janë miratuar?
- Lutemi të na vini në dispozicion praktikat e plota të miratimit të kërkesës për klasifikim.
- Sa licencime të Udhërrëfyesve turistik janë bërë përgjatë periudhës 2019-2020?
- Lutemi plotësoni tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Nr. - Viti 2019	Nr. - Viti 2020
Udhërrëfyes Kombëtar		
Udhërrëfyes Lokal		
<i>Sa prej Udhërrëfyesve Lokal janë për zonën e:</i>		
1.Alpeve		
2.Llogarasë		
3.Korçë		
4.Tiranë		

- Sa kërkesa kanë ardhur në Komisionin e Standardizimit, nga Inspektorati i turizmit, për marrjen e masave ndaj subjekteve që nuk kanë respektuar detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Turizmit?
- Sa prej këtyre kërkesave, kanë konkluduar me revokimin e çertifikatës së kategorizimit ose të klasifikimit?

49.Referuar pikës 4 të nenit 5 të VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar, a është miratuar Udhëzimi për manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit?

- Nëse po, lutemi të na e vendosni në dispozicion.

50.Referuar nenit 45/6 të Ligjit të Turizmit dhe nenit 7 të VKM nr.730, datë 20.10.2016, a janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi midis MTM me agjenci ndërkombëtare, për verifikimin e të dhënave dhe vlerësimin për klasifikimin e strukturave akomoduese?

- Nëse po, sa marrëveshje janë lidhur?
- Lutemi të na vendosni në dispozicion marrëveshjet e lidhura.
- Mbi cilën bazë rregullatore është mbështetur procesi i vlerësimit të agjencive/organizatave ndërkombëtare, deri në lidhjen e marrëveshjes?
- Lutemi specifikoni bazën rregullatore.
- Cilat janë kriteret që duhet të plotësojë organizata, që do të jetë pjesë e procesit të verifikimit dhe vlerësimit të strukturave akomoduese?



- Si janë identifikuar nga MTM këto organizata?
- A është zhvilluar një proces konkurimi për këto organizata?
- Nëse po, kur dhe ku është publikuar konkursi?
- Për vlerësimin e organizatave ndërkombëtare, është ngritur ndonjë komision pranë MTM-së?
- Nëse po, lutemi të na vini në dispozicion Urdhrin e Titullarit për ngritjen e komisionit.
- Nëse për kryerjen e verifikimit dhe vlerësimit nuk janë lidhur marrëveshje si më sipër, a është ngritur ndonjë grup pune nga Titullari i MTM-së, për kryerjen e këtyre funksioneve?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion Urdhrin e Titullarit për ngritjen e grupit përkatës.

51.Referuar nenit 4/c të Urdhrit nr.267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", në gjykimin tuaj, a krijohet hapësirë për subjektivizëm dhe trajtim me dy standarde, që verifikimi në terren i të dhënave të vetëdeklarimit për kategorizimin e strukturës akomoduese, të vendoset nga Komisioni dhe jo që kjo fazë të mos jetë taksative për çdo rast aplikimi?

- Lutemi të na vendosni në dispozicion Urdhrin/at e Titullarit të MTM-së, për kryerjen e verifikimit në terren të plotësisht të kërkesave, për kategorizimin e strukturave akomoduese.

52.Referuar nenit 10/2 të Urdhrit nr.267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", cilat janë masat ligjore që merren ndaj një strukture akomoduese, e cila nuk ka certifikatën e kategorizimit?

53.Referuar nenit 19/b të Ligjit të Turizmit, a kanë raportuar NJVQV-të të dhënat statistikore, çdo 6 mujor, pranë MTM?

- Nëse po, lutemi të na vini në dispozicion shkresat përcjellëse, për periudhën 2019-2020?

54.Referuar nenit 20 të Ligjit të Turizmit, si dhe pikës 2.2 dhe pikës 3.4 të Udhëzimit nr.8502, datë 24.10.2016, lutemi të na vini në dispozicion autorizimet e Titullarit të MTM-së, për përcaktimin e përfaqësuesit që kanë marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, si dhe rekomandimet e Komitetit, përcjellë me shkresë zyrtare pranë MTM.

55.Referuar nenit 31/5 të Ligjit të Turizmit, si dhe të dhënave të vendosura në dispozicion nga ju, lutemi të na vendosni në dispozicion kontratat e lidhura (kërkesë për aplikim deri tek financimi i projektit, situacionet, realizimin e aktiviteteve), për projektet:

- Shtegu i biçikletave dhe këmbësorëve, një urë lidhëse mes natyrës dhe njerëzve me dy parqet Kombëtare të Thethit dhe Valbonës", shpallur fituese Shoqata Dukagjini;
- Promovimi i 12 zonave të mbrojtura, shpallur fituese Delta Publicity;
- Evidentimi dhe promovimi i shtigjeve të hiking në Shqipëri", shpallur fituese Fatbardha Rama.
- Gjithashtu lutemi të na vendosni në dispozicion raportet e monitorimit të këtyre kontratave nga Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Turizëm.
- Raportet e auditimit të këtyre kontratave nga ekspertët e pavarur të auditimit.

56.Referuar nenit 31/7 të Ligjit të Turizmit, lutemi të na vendosni në dispozicion VKM për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjeve të Projekteve në turizëm, për vitin 2019 dhe vitin 2020.

57.Referuar nenit 32/2 të Ligjit të Turizmit, lutemi të na vendosni në dispozicion Urdhrin për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjeve të Projekteve në Turizëm.

58.Referuar të dhënave të vënë në dispozicion nga ju, për burimet njerëzore, lutemi specifikoni periudhën konkrete për vakancën e pozicionit të Drejtorit të Përgjithshëm të Turizmit pranë MTM-së, si dhe të pozicionit të Drejtorit të Konceptimit të Projekteve.

- Përgjatë periudhës 2019-2020, cilët punonjës kanë kryer detyrat e pozicioneve të mësipërme?
- Lutemi të na vendosni në dispozicion autorizimin e Titullarit për caktimin e tyre në pozicionet e mësipërme.



59.Referuar nenit 53 dhe nenit 66 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8707, datë 31.10.2016 "Për miratimin e formatit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe strukturat akomoduese", a kanë raportuar çdo muaj këto subjekte pranë MTM-së?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion raportimet e tyre për periudhat 01.01.2019-30.04.2019 dhe 01.10.2019-31.12.2019.

60.Referuar nenit 75 të Ligjit të Turizmit, a janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të:

-pikës 2, të nenit 12; të pikës 3, të nenit 16; të pikave 5, 7 e 8, të nenit 31; të pikës 4, të nenit 35; të pikës 2, të nenit 36; të pikës 2, të nenit 40; të nenit 44; të pikës 5, të nenit 45; të pikës 3, të nenit 48; të pikës 3, të nenit 51; të pikës 2, të nenit 57 dhe të pikës 2, të nenit 64; si dhe të pikës 2, të nenit 9; pikës 2, të nenit 10; të pikës 2, të nenit 11; të pikës 4, të nenit 17; të pikave 2 e 3, të nenit 18; të pikës 4, të nenit 20;të pikës 2, të nenit 32;të pikës 1, të nenit 53; të pikës 3, të nenit 62 dhe të pikës 2 të nenit 63?

-Nëse po, lutemi citoni rast pas rasti aktin nënligjor.

Intervista për Agjencinë Kombëtare të Turizmit

Tiranë, më 17.05.2021

Lënda: Vjelje të dhënash dhe përgjigjesh zyrtare për auditimin e performancës "Zhvillimi i Turizmit Malor"

1.Referuar Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 (në vijim SKT 2019-2023), a është hartuar dhe miratuar kalendari i turizmit për vitet 2019, 2020 dhe 2021?

- Nëse po, lutemi na i vendosni në dispozicion.

2. Referuar nenit 4 dhe nenit 9/n të Ligjit të Turizmit, si dhe SKT 2019-2023, a janë ngritur zyrat/pikat e informimit turistik sipas rregullores së miratuar?

- Nëse po, a janë përcaktuar kriteret për funksionimin e tyre?
- Sa zyra/pika janë në territorin e Republikës së Shqipërisë?
- Lutemi të na vini në dispozicion rregulloren e miratuar, nëse ka, të funksionimit të tyre.

3.Referuar SKT 2019-2023, a ka marrë masa AKT, për përfshirjen e Shqipërisë në guidat ndërkombëtare të ecjes dhe çiklizmit?

- Nëse po, lutemi na vendosni dokumentacionin justifikues.

4.Referuar SKT 2019-2023 dhe Planit të Punës së AKT për vitin 2019, pikat 10.7 dhe 10.8, a keni përgatitur përgjatë viteve 2019-2020, materiale publicitare audiovizive për turizmin malor?

- Nëse po, a janë publikuar ato?
- Cilët janë burimet e informacionit, që përdorni ju, për përgatitjen e këtyre materialeve?
- Lutemi të na vendosni në dispozicion dokumentacionin justifikues.

5. A keni promovuar sporte të ndryshme, që zhvillohen në zonat malore, përgjatë periudhës 2019-2020?

- Nëse po, cilat sporte keni promovuar?
- Nëpërmjet cilave forma keni bërë promovimin e tyre?
- Keni ndonjë studim/analizë se cilat nga këto sporte është më i frekuentuar?
- Nëse po, lutemi të na e vendosni në dispozicion.

6. A keni lidhur ndonjë kontratë shërbimi përgjatë periudhës 2019-2020, ose që është në zbatim, me media vendase/të huaja, me qëllim promovimin e turizmit në Shqipëri, ose monitorimin e mediave vendase, në të cilat promovohet turizmi shqiptar?

- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion kontratën.

7. A keni ju studim për monitorimin e tregut, mbi prirjet dhe preferencat e konsumatorëve, se çfarë ata kërkojnë nga turizmi malor në Shqipëri, me qëllim rritjen e efektivitetit të promovimit dhe marketingut?



- Nëse po, a është i përditësuar ky studim, pasi turizmi është një sektor që vazhdimisht zhvillohet dhe ndryshon?
 - Lutemi të na vendosni në dispozicion studimin.
8. Referuar SKT 2019-2023 dhe Planit të Punës së AKT për vitin 2019, a është krijuar portali e-turizmi?
- Nëse po, a është funksional ai?
9. Referuar Planit të Punës së AKT për vitin 2019, pika 6.1.7, cilat janë 4 Bashkitë që citohen nga Ju?
- A janë kryer trajnime sipas objektivit të vendosur?
 - Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion evidencën e trajnimeve.
10. Referuar Planit të Punës së AKT për vitin 2019, pika 7.1, a janë marrë masa për zhvillimin e programit të turizmit natyror?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion dokumentacionin justifikues.
 - Referuar përsëri sa më sipër, përgjatë periudhës 2019-2020, a janë krijuar nga AKT, produkte të reja turistike që lidhen me turizmin natyror?
 - Nëse po, në cilën/at mënyrë/a janë krijuar?
 - Lutemi listoni produktet e reja turistike që janë krijuar përgjatë periudhës 2019-2020.
11. Referuar Planit të Punës së AKT për vitin 2019, pika 8.14, a është zhvilluar aktiviteti i parashikuar, në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion dokumentacionin justifikues.
12. Referuar Rregullores së brendshme të AKT-së, Kreu III, neni 13, pika 3, a ka AKT rregullore të veçantë për procedurat e pjesmarrjes, organizimit, zhvillimit, në panairë dhe në turet familjarizuese?
- Nëse po, lutemi të na e vendosni në dispozicion.
13. A keni indikator/tregues, mbi të cilët matni kontributin/dobishmërinë e pjesëmarrjes tuaj në panairë, për promovimin e turizmit shqiptar si dhe rritjen e kërkesës për atë?
- Nëse po, si i keni përcaktuar këta indikator?
 - A dispononi informacion mbi këta indikator?
 - Nëse po, lutemi të na e vendosni në dispozicion?
 - Çfarë monitoroni ju tek subjektet pjesëmarrëse në panairë?
 - A i keni kryer këto monitorime në panairë e zhvilluara përgjatë periudhës 2019-2020?
 - Nëse po, lutemi të na i vendosni në dispozicion.
14. Referuar Urdhrit nr.65, datë 01.04.2019 të Kryeministrit, "Për planin e masave për sezonin turistik", a keni përgatitur ju, një program për vendosjen e sinjalistikës informuese dhe promovuese në destinacionet turistike më të frekuentuara/preferuara?
- Nëse po, si i keni identifikuar ju destinacionet më të frekuentuara, ndërkohë që jo për çdo destinacion turistik, disponohen statistika mbi numrin e vizitorëve (si një tregues që shërben për vlerësimin e preferencës)?
 - Cila është sinjalistika informuese?
 - Cila është sinjalistika promovuese? A është e miratuar me akt nënligjor sinjalistika promovuese?
 - Sa më sipër, lutemi të na vini në dispozicion programin për vendosjen e sinjalistikës informuese dhe promovuese, evidencën mbi përcaktimin e destinacioneve më të preferuara, si dhe evidencën për sinjalistikën informuese dhe promovuese.
15. Referuar Urdhrit nr.65, datë 01.04.2019 të Kryeministrit, "Për planin e masave për sezonin turistik", a janë organizuar veprimtari argëtuese në zonat malore, përgjatë sezonit turistik?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion dokumentacionin justifikues (Urdhri i titullarit, komunikimi me palët e tjera, ftesat e dërguara për pjesëmarrje, urdhër-shpenzimet, si dhe relacionin përfundimtar mbi aktivitetin).



16. Referuar Urdhrit nr.26, datë 10.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKT-së, "Për ngritjen e grupit të punës, në zbatim të planit të masave për sezonin turistik 2019", pika 3, shkronja "e", lutemi të na vendosni në dispozicion raportet periodike të grupit të punës.
17. Referuar shkresës nr.358, datë 23.05.2019, drejtuar Autoritetit Rrugor Shqiptar, cili/at është/janë burimi/et e informacionit për destinacionet turistike, që i keni përcjellë ARRSH?
- A janë burime zyrtare dhe të konfirmuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit?
18. Referuar shkresës nr.361, datë 24.05.2019, drejtuar Bashkive, me lëndën "kërkesë për mbështetje", sa prej tyre i janë përgjigjur kësaj shkresë?
- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ju, kemi vetëm kthim-përgjigjen e Bashkisë Roskovec;
 - Sa më sipër, Bashkitë e tjera nuk i janë përgjigjur kërkesës Tuaj?
 - Nëse po, a keni marrë masa ju për këtë mungesë bashkëpunimi?
 - Referuar shkresës "kthim-përgjigje" nga Bashkia Roskovec, a janë publikuar të gjitha aktivitetet lokale të kësaj Bashkie, në faqen zyrtare të AKT-së?
 - Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion, materialin e publikuar.
19. Referuar shkresës kthim-përgjigje të Bashkisë Roskovec, a keni organizuar Ju, ndonjë aktivitet, me qëllim promovimin e eventeve lokale të kësaj Bashkie?
- Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion, dokumentacionin justifikues.
 - Referuar sa më sipër përsëri, a keni marrë masa Ju, që destinacionet turistike të kësaj Bashkie, të pajisen me sinjalistike informuese dhe promovuese?
 - Nëse po, lutemi të na vini në dispozicion dokumentacionin justifikues.
 - Referuar sa më sipër, a keni marrë masa Ju, për mirëmenaxhimin e zyrës së informacionit, që ndodhet pranë Bashkisë Roskovec?
 - Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion dokumentacionin justifikues.
20. Sa destinacione turistike ka Bashkia Devoll?
- Sa prej tyre keni promovuar ju?
21. Sa destinacione turistike ka Bashkia Kolonj?
- Sa prej tyre keni promovuar ju?
22. Sa destinacione turistike ka Bashkia Malësi e Madhe?
- Sa prej tyre keni promovuar ju?
23. Sa destinacione turistike ka Bashkia Pustec?
- Sa prej tyre keni promovuar ju?
24. A keni ju një databasë të zonave që shërbejnë për strukturat e kampingut?
- Nëse po, cili ka qenë burimi/et i/e informacionit?
 - A keni bërë promovimin e këtyre zonave?
 - Nëse po, nëpërmjet cilave forma keni bërë promovimin?
 - Na vendosni në dispozicion, databazën e mësipërme, burimin e informacionit (email ndërmjet institucioneve ose komunikim shkresor për sigurimin e informacionit) si dhe dokumentacionin mbi promovimin e tyre.
25. Referuar Urdhrit nr.85, datë 25.06.2020, të Kryeministrit "Për planin e masave për sezonin turistik për vitin 2020", lutemi të na vendosni në dispozicion, Urdhrin përkatës, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKT-së, për ngritjen e grupit të punës, si dhe dokumentacionin justifikues në zbatim të detyrimeve të Urdhrit nr.85, datë 25.06.2020.
26. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ju (bashkëpunimin me Prefekturën e Qarkut Tiranë për vitin 2019), lutemi të na vendosni në dispozicion Urdhrin nr.62, datë 30.04.2019, për ngritjen e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, Qarku Tiranë, si dhe procesverbalet për takimet e mbajtura.
27. Lutemi të na vendosni në dispozicion Urdhrin nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë...", si dhe dokumentacionin justifikues në zbatim të këtij Urdhri nga Juve.
28. Listoni shtigjet për këmbësor dhe biçikleta, sipas tabelave të mëposhtme:



	Shteg për këmbësor	Vendndodhja	Masat e marra për promovimin e tij
	Shteg për biçikleta	Vendndodhja	Masat e marra për promovimin e tij

Aneksi nr.3 "Pyetësor për subjektet agjenci dhe/operator turistik"


PYETËSOR:

Drejtuar: Agjencie/Operatorëve të udhëtimit.

Nga: Audituesit Shtetërorë të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

1.A jeni ftuar për bashkëpunim nga AKT, për promovimin e produkteve, destinacioneve turistike që ofrohen në Qarkun tuaj?

-Për pyetjen e mësipërme, janë përgjigjur 23 subjekte, nga të cilat, 18 ose 78% janë shprehur se nuk janë ftuar për bashkëpunim, dhe 5 prej tyre ose 22% janë shprehur "Po".



2.Nëse po, kur ka qenë bashkëpunimi i fundit?


-Nga 5 subjektet që u përgjigjën se kanë qenë pjesë e bashkëpunimeve me AKT, u përgjigjën 3 prej tyre, ku u shprehën se janë ftuar për bashkëpunim në vitin 2020.

Nga të cilët	U përgjigjën	Nuk u përgjigjën	Total
	3 ose 60%	2 ose 40%	5
Përgjigjia e tyre	Në vitin 2020		

3.A jeni ftuar nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, për të dhënë mendimin, kontributin tuaj në përgatitjen e materialeve, broshurave, fletë-palosjeve për turizmin?

-Për pyetjen e mësipërme, janë përgjigjur 23 subjekte, nga të cilat, 18 ose 78% janë shprehur se nuk janë ftuar për të dhënë mendim/kontribut në përgatitjen e materialeve, broshurave, fletë-palosjeve, dhe 5 prej tyre ose 22% janë shprehur "Po".

PO – 5	JO – 18
--------	---------




4. Nëse po, kur ka qenë ftesa e fundit për bashkëpunim?

-Nga 5 subjektet që u përgjigjën se janë ftuar për të dhënë mendimin dhe kontributin e tyre në përgatitjen e materialeve, broshurave, fletë-palosjeve, rezultoi se asnjë prej tyre nuk i'u përgjigj pyetjes së mësipërme.


5.A e njihni si strukturë publike Degën Teritoriale të Shërbimit të Turizmit?

-Për pyetjen e mësipërme, janë përgjigjur 23 subjekte, nga të cilat, 16 ose 70% janë shprehur se nuk e njohin si strukturë publike, dhe 7 prej tyre ose 30% janë shprehur se e njohin.



6. Nëse po, a keni qenë pjesë e bashkëpunimit, seminareve, trajnimeve, të organizuara nga kjo strukturë?

-Për pyetjen e mësipërme, janë përgjigjur 23 subjekte, nga të cilat, 22 ose 96% janë shprehur se nuk kanë qenë pjesë e bashkëpunimit, seminareve, trajnimeve, të organizuara nga kjo strukturë, dhe vetëm 1 prej tyre ose 4% është shprehur se ka qenë pjesëmarrës në organizime të tilla.




7. Nëse po, kur ka qenë ftesa e fundit për bashkëpunim?

-Asnjë përgjigje

8.A jeni bërë pjesë ndonjëherë e takimeve që ka organizuar Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit?

-Për pyetjen e mësipërme, janë përgjigjur 23 subjekte, nga të cilat, 19 ose 83% janë shprehur se nuk kanë qenë pjesë e takimeve të kësaj strukture, dhe 4 prej tyre ose 17% janë shprehur “Po”.




9.Nëse po, kur ka qenë hera e fundit që keni marrë pjesë në takim?

-Nga 4 subjektet që u përgjigjën se kanë qenë pjesë e takimeve me KRZHT, u përgjigjën 3 prej tyre, ku u shprehën se janë ftuar në takimet e zhvilluara në vitin 2020.

Nga të cilët	U përgjigjën	Nuk u përgjigjën
	3 ose 75%	1 ose 25%
Përgjigjia e tyre	Në vitin 2020	

10.A siguron Bashkia/Qarku infrastrukturë mbështetëse për veprimtarinë e biznesit të turizmit?

Meqenëse KRZHT nëpërmjet takimeve të saj, ka si qëllim diskutimin e problematikave që përballet turizmi, nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e tyre, grupi i auditimit, në pyetësorin e përgatitur për agjencitë dhe operatorët turistik, i'u drejtoi pyetjen e mësipërme. Kësaj pyetje i'u përgjigjën 23 subjekte, nga të cilat, 18 ose 78% janë shprehur se, Bashkia/Qarku nuk siguron infrastrukturë mbështetëse për veprimtarinë e biznesit të turizmit, si dhe 5 prej tyre ose 22%, janë shprehur “Po”.



11.Nëse po, mund të listoni disa prej tyre....

Nga 5 subjektet që dhanë përgjigje se Bashkia/Qarku siguron infrastrukturë mbështetëse veprimtarinë e biznesit të turizmit, vetëm 1 prej tyre ose 20% i'u përgjigj pyetjes së mësipërme, pasqyruar si më poshtë:


Nga të cilët	U përgjigjën	Nuk u përgjigjën
	1 ose 20%	4 ose 80%



Përgjigjia e tyre	Zyra e informacionit turistik panairët kombëtare	
--------------------------	--	--


12.A ndjeni nevojën e trajnimeve, asistencës teknike ose edukimit në vazhdim për fushën e turizmit?

-Për pyetjen e mësipërme, janë përgjigjur 23 subjekte, nga të cilat, 21 ose 91% janë shprehur se e kanë të nevojshëm trajnimin dhe edukimin në vazhdim, dhe 2 prej tyre ose 9% janë shprehur se nuk e kanë të nevojshëm.



13.A janë kryer trajnime nga institucionet publike (Ministri, Bashki, etj) me fokus turizmin, ku ju të keni marrë pjesë?

-Për pyetjen e mësipërme, janë përgjigjur 23 subjekte, nga të cilat, 18 ose 78% janë shprehur se nuk janë kryer trajnime me qëllim zhvillimin e aftësive për rritjen e cilësisë së shërbimit në turizëm, si dhe 5 ose 22% janë shprehur se janë kryer trajnime të tilla.





14.Nëse po, kur ka qenë trajnimi i fundit që keni marrë pjesë?

-Për pyetjen e mësipërme, nga 5 subjekte të cilat janë shprehur se janë kryer trajnime nga institucionet publike (Ministri, Bashki, etj), asnjë prej tyre nuk ka dhënë përgjigje, se kur ka qenë hera e fundit që ka marrë pjesë.

15.A bashkëpunoni me udhërrëfyesit turistik?

-Për pyetjen e mësipërme, janë përgjigjur 23 subjekte, nga të cilat, 13 ose 57% janë shprehur se, bashkëpunojnë me udhërrëfyesit turistikë (që shërbejnë si guidë për grupet e turistëve), si dhe 10 ose 43% janë shprehur se nuk bashkëpunojnë.





16. Si e vlerësoni shërbimin e udhërrëfyesit turistik?

Nga të cilët	U përgjigjën			Nuk u përgjigjën
		9 ose 69%		
Përgjigjia e tyre	Mirë/mesatar	4 prej tyre	44%	
	Shumë mirë	1 prej tyre	11%	
	I domosdoshëm	4 prej tyre	44%	

-Për pyetjen e mësipërme, nga 13 subjekte që janë shprehur se bashkëpunojnë me udhërrëfyesit turistik, 9 prej tyre janë përgjigjur. Nga 9 subjekte që kanë dhënë një vlerësim mbi shërbimin e udhërrëfyesit, 4 prej tyre ose 44% e kanë vlerësuar mirë/mesatar, 4 të tjerë e kanë vlerësuar si të domosdoshëm bashkëpunimin me udhërrëfyesit, megjithëse nuk është kjo përgjigjia për pyetjen e mësipërme, si dhe 1 prej tyre ose 11% e ka vlerësuar shumë mirë.


17. Nga eksperiencia, cilat janë mangësitë që shoqërojnë shërbimin e udhërrëfyesit turistik?

Nga të cilët	U përgjigjën			Nuk u përgjigjën
		11 ose 85%		
Përgjigjia e tyre	Mungesa e eksperiencës/trajnimeve	7	64%	
	Mungesa e licencës	2	18%	
	Mungesë në numër	2	18%	

-Për pyetjen e mësipërme, nga 13 subjekte që janë shprehur se bashkëpunojnë me udhërrëfyesit turistik, 11 prej tyre janë përgjigjur. Nga 11 subjekte që kanë dhënë një vlerësim mbi shërbimin e udhërrëfyesit, 7 prej tyre ose 64% janë shprehur se udhërrëfyesit kanë mungesë të eksperiencës/ose trajnimeve, 2 të tjerë ose 18% janë shprehur se ka mungesë në numër, si dhe 2 subjekte ose 18% janë shprehur se udhërrëfyesit nuk janë të licencuar.

18. Çfarë mendoni për informalitetin në sektorin e shërbimeve turistike?

Gjithsej 23 pyetësor, nga të cilët 13 prej tyre i janë përgjigjur pyetjes së mësipërme dhe 10 nuk i janë përgjigjur.





KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "ZHVILLIMI I TURIZMIT MALOR"

Databaza e përgjigjeve të pyetësorit për agjencitë dhe operatorët turistik

Nr	Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23
1	A jeni të njohur me Ligjin e Turizmit nr.93/2015 dhe detyrimet ligjore të tij për aktivitetin tuaj?	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	JO	JO	PO	PO	JO	PO	PO	PO
2	A jeni të njohur me strategjitë ose planet e Bashkisë Vlorë për zhvillimin e turizmit?	JO	PO	JO	JO	PO	JO	PO	JO	PO	JO	JO	PO	PO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	PO	PO	JO	JO
3	A e njihni si institucion publik Agjencinë Kombëtare të Turizmit?	PO	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	JO	JO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO
4	A jeni ftuar për bashkëpunim nga ky institucion, për promovimin e produkteve, destinacioneve turistike që ofrohen në Qarkun e Vlorës?	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	PO	PO	JO
5	Nëse po, kur ka qenë bashkëpunimi i fundit?	2020																						
6	A jeni ftuar nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, për të dhënë mendimin, kontributin tuaj në përgatitjen e materialeve, broshurave, fletë-palosjeve për turizmin?	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	JO
7	Nëse po, kur ka qenë ftesa e fundit për bashkëpunim?																							
8	A e njihni si institucion publik Degën Teritoriale të Shërbimit të Turizmit?	PO	JO	PO	PO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	PO	PO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO
9	Nëse po, a keni qenë pjesë e bashkëpunimit, seminareve, trajnimeve, të organizuara nga kjo strukturë?	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO
10	Nëse po, kur ka qenë ftesa e fundit për bashkëpunim?																							
12	A e njihni ju Komitetin Rajonal të Zhvillimit të Turizmit?	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	PO	JO	PO
13	A jeni bërë pjesë ndonjëherë e takimeve që ka organizuar kjo strukturë?	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	PO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO
14	Nëse po, kur ka qenë hera e fundit që keni marrë pjesë në takim?	2020																						
15	A është kërkuar mendimi juaj nga Ministria e Turizmit, gjatë përgatitjes së Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit 2019-2023?	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	JO
16	Nëse po, çfarë mendimesh keni dhënë dhe a janë marrë në konsideratë mendimet tuaja?	JO	JO	JO		JO	JO	JO	JO						JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO
17	A keni patur mbështetje nga Ministria e Turizmit apo institucione të tjera, për promovimin/marketimin e produktit, destinacionit turistik?	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	PO	JO
18	Nëse po, kur është ofruar kjo mbështetje për herë të fundit?	2020																						
19	A ndjeni nevojën e trajnimeve, asistencës teknike ose edukimit në vazhdim për fushën e turizmit?	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	P O	P O	JO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO
20	A janë kryer trajnime nga institucionet publike (Ministri, Bashki, etj) me fokus turizmin, ku ju të keni marrë pjesë?	JO	JO	JO	PO		JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	PO
21	Nëse po, kur ka qenë trajnimi i fundit që keni marrë pjesë?																							
22	A siguron Bashkia, Qarku infrastrukturë mbështetëse për veprimtarinë e biznesit të turizmit?	JO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	PO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	JO	PO	JO	JO
23	Nëse po, mund të listoni disa prej tyre...	Zyra e informacionit turistik, panairët kombëtare																						
27	A bashkëpunoni me udhërrëfyesit turistik?	JO	JO	PO	PO	JO	JO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	PO	PO	PO	PO
28	Si e vlerësoni shërbimin e udhërrëfyesit turistik?	Mire; I domosdoshëm; shumë mire.																						
29	Nga eksperiencia, cilat janë mangësitë që shoqërojnë shërbimin e udhërrëfyesit turistik?	Mungesa e licencës; Punojmë vetëm me udhërrëfyes të licencuar; Mungesa e eksperiencës; Mungesa e trajnimeve; Ka mungesë në numër																						
32	Çfarë mendoni për informalitetin në sektorin e shërbimeve turistike?	Ndikon në cilësinë e shërbimit Kërkon akoma përmirësim Informaliteti deformat konkurrencën																						
33	Gjatë ushtrimit të aktivitetit nga ju, cilat janë qenë problemet që jeni ndeshur në të shumtën e rasteve (renditini shkurtimisht)?	Infrastruktura; standardizimi i shërbimit; Siguria; Pastërtia; informaliteti; Transporti publik; Mungesa e një strukture informuese dhe trajnuese; Infrastruktura e dobët në zonat malore;																						
34	A keni marrë zgjidhje nga institucionet publike për këto probleme?	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	PO	JO	PO	JO	JO	JO	
35	Nëse po, kush ka qenë institucioni që ju ka ofruar zgjidhje?																							
36	Po për Pandeminë COVID-19 çfarë mund të thoni? (mbështetja financiare nga qeveria, ecuria e aktivitetit, pritshmëritë tuaja për vazhdimësinë, etj...)	Asnjë; Vetëm 1 pagë minimale në fillim; Minimale																						

Foto gjatë vizitave në terren

Qendra e Vizitorëve në Parkun Kombëtar të Llogarasë



Foto të Shtegut Malor (Qafa e Çezarit në Parkun Kombëtar të Llogarasë)





Foto të Shtegut Malor (Maja e Çikës në Parkun Kombëtar të Llogarasë)



Foto të Shtegut Malor (Shtegu i Breshkave në Parkun Kombëtar të Prespes)





7. GRUPI I AUDITIMIT

- 1.Z. K.K, Përgjegjës i Grupit
- 2.Zj. A.T, Anëtar
- 3.Z. I.H, Anëtar